

Tiranë, më _____._____.2021

A N K I M

ANKUES: **Partia Demokratike e Shqipërisë**, me seli në adresën: Blv. Zhan d'Ark, Nr. 11, Tiranë, përfaqësuar nga Sekretari për Çështjet Zgjedhore **Ivi KASO**, me adresë email-i: ivikaso@gmail.com dhe nr.cel: (+355) 68 20 77 094.

OBJEKTI:

1. Kundërshtimi i Vendimit Nr. 343, datë 04.05.2021 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për depfutat, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.
2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Tiranë.
3. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Tiranë në periudhën më të afërt zgjedhore.

BAZA LIGJORE: Nenet 1, 18, 35, 45 dhe 64 të Kushtetutës së Shqipërisë;
Nenet 8 dhe neni 3, Protokoli 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
Pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore;
Nenet 12, pika 4; 21, pika 1; 33, gërma “ë”; 91; 92; 98, pika 4; 106, pika 1; 113, pika 1; 116, pikat 6/7; 116/1, pika 5; 117, pika 2/3/4; 118, pika 1/2; 122, pika 2/5; 123, pika 4; 123/1, pikat 1 dhe 2; 124, pikat 1 dhe 3; 143, pika 1, gërmat “ç” dhe “d”; 160, pika 1, gërma “a” dhe 2; 161, pika 1 të Kodit Zgjedhor;
Nenet 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;
Nenet 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020 të KQZ-së.

DREJTUAR: **Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve**
KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

Të Nderuar,

Në datën 04.05.2021, kemi marrë dijeni për Vendimin Nr. 343, datë 04.05.2021 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, për shkak se vlerësojmë se gjatë procesit zgjedhor prej të cilit ka dalë ky vendim kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor, si dhe tërësia e shkeljeve të ligjit, të ndodhura në këtë zonë zgjedhore ka cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që ka ndikuar në ndarjen e mandateve, sic do të provohen gjatë hetimit administrativ, po parashtrojmë këtë ankim me faktet, dispozitat ligjore dhe arsyetimin ligjor, si më poshtë:

I. RRETHANAT E CËSHTJES

1. Në datën 25.04.2021, u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Në zonën zgjedhore Tiranë morën pjesë në zgjedhje 484.777 votues ose 53.24%. Në datën 26 dhe 27 Prill, u krye numërimi i votave për subjektet zgjedhore, gjatë të cilit u konstatuan 466.066 fletë të vlefshme dhe 18.422 fletë të pavlefshme ose 3.80%.
2. Mandatet në këtë zonë zgjedhore u ndanë, si vijon: PS 18 mandate, PD 15 mandate, LSI 2 mandate dhe PSD 1 mandat. Në datën 04.05.2021, me vendimin Nr. 343, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.
3. Duke qenë se jemi të bindur, bazuar në prova dhe fakte të pakundërshtueshme, se periudha para dhe zgjedhore u shoqërua me shkelje të ligjit, të cilat cënuan rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikoi drejtpërdrejtë në ndarjen e mandave, në vijim do të parashtrojmë faktet që mbështesin këtë pretendim:

A. Blerja e votës dhe përdorimi i personave me precedentë të tmerrshëm kriminalë (16 prova):

4. Gjatë periudhës Mars – Prill 2021, Partia Demokratike ka depozituar **50 kallëzime penale në SPAK** dhe **130 kallëzime në prokuroritë e rretheve**. Ndër 50 kallëzimet e depozituara në

- SPAK, **30 prej tyre kanë të bëjnë me raste flagrante të shitblerjes së votës** nga drejtues, përfaqësues apo mbështetës të Partisë Socialiste.
5. Në Qarkun e Tiranës për rastet e shitblerjes së votës dhe shkelje të tjera flagrante të ligjit lidhur me to, që kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor, Partia Demokratike ka depozituar **7 (shtatë) kallëzime penale në SPAK** gjatë fushatës zgjedhore në datat **04.04.2021; 06.04.2021; 07.04.2021 (2); 12.04.2021; 15.04.2021 dhe 18.04.2021**, përkatësisht:
 6. Në datën **04.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar – SPAK, shtetasit **Aleksandër Lipivani, Emiljano Dusha, Ardian Davidhi, Rexhep Spahiu dhe Marlind Shkreli**, të cilët me veprime konkrete kanë konsumuar veprat penale të **"Korrupsionit aktiv në zgjedhje"**, parashikuar nga neni 328, **"Korrupsionit pasiv në zgjedhje"**, parashikuar nga neni 328/b, **"Kanosjes apo dhunimit ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje"** parashikuar nga neni 329 dhe **"Marrjes ose përdormit të paligjshëm të dokumenteve të identifikimit"** parashikuar nga neni 331/a të Kodit Penal (**Prova Nr. 1 – Kallëzimi penal i Partisë Demokratike, datë 04.04.2021**).
 7. Në rrugën “Qemal Stafa”, Njësia Administrative nr. 8 në Tiranë, në atë që njihet si “Lokali Nelit”, është krijuar një strukturë e mirfilltë blerje vote, shantazhi dhe kërcënim si dhe mbledhje të kartave të ID nga persona të lidhur drejtpërsëdrejti me Partinë Socialiste. Kjo skemë kriminale blerje vote është e organizuar dhe funksionon nga shtetasit **Aleksandër Lipivani, Emiljano Dusha, Ardian Davidhi, Rexhep Spahiu, Marlind Shkreli dhe një shtetas i quajtur Klodi**, të cilët në ambientet e lokalit të sipërpërmendur dhe jo vetëm, shpërndajnë para cash për qytetarët në këmbim të votës për Partinë Socialiste. Personat kryesorë të kësaj skeme janë **Aleksandër Lipivani, Emiljano Dusha dhe Ardian Davidhi**, të cilët konsiderohen edhe si “thesi i parave” që ju shpërndahen qytetarëve në këmbim të votës.
 8. Burimi i parave është tërësisht i paligjshëm dhe produkt i veprimtarive kriminale. Kjo pasi, shtetasi **Aleksandër Lipivani**, si punonjës i administratës publike ndër vite është akuzuar shpesh herë për korrupsion, ndërsa shtetasi **Emiljano Dusha**, i cili është zotërues i shoqërisë **MSSC Military System Supply Company shpk** me NIPT L01306040L, është përfitues nga ana e Qeverisë jo vetëm e procedurave korruptive të prokurimit por edhe të kontratave të klasifikuara (sekrete), me objekt blerje armatime dhe pajisje për Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe Policinë e Burgjeve. Bazuar në të dhënat zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, kjo shoqëri ka përfituar **5 procedura prokurimi korruptive**, me vlerë **3 milionë euro**, pa garë ose si oferta më e lartë me diferencë mijëra euro me ofertën më të ulët dhe ku vlera e

kontratave është sa 98% e vlerës së fondit limit. Nga ana tjetër, bazuar në të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financave, kjo shoqëri ka përfituar **55 transaksione thesari si kontrata të klasifikuara (sekrete)**, me vlerë **11 milionë euro**.

9. Nga të dhënat zyrtare, shtetasi Emiljano Dusha, i cili në rrjetet sociale e prezanton veten edhe si “misionar i Partisë Socialiste” ka përfituar 14 milionë euro tendera dhe kontrata sekrete nga ana e Qeverisë dhe tashmë këto para të përfituara në shkelje të ligjit, i përdor në fushatë për blere vote. Sërish nga të dhënat zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik është i verifikuar edhe fakti se shtetasi **Ardian Davidhi**, nëpërmjet shoqërisë së zotëruar prej tij **K O A N sh.p.k.** me NIPT K41710001D, ka përfituar **12 procedura prokurimi**, me vlerë **5.7 milionë euro**. Këto tendera janë përfituar kryesisht pa garë ose si oferta më e lartë me diferencë mijëra euro me ofertën më të ulët dhe ku vlera e kontratave është sa 97% e vlerës së fondit limit.
10. Në datën **06.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasit **Tom Doshi**, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, Kryetar i Partisë Social Demokrate dhe kandidat për deputet në Qarkun e Tiranës dhe Shkodrës dhe personat me rekorde kriminale **Filip Gjeloşi** dhe **Pal Gjeloşi**, të cilët me veprime konkrete kanë konsumuar veprat penale të **"Korrupsionit aktiv në zgjedhje"** parashikuar nga neni 328, **"Korrupsionit pasiv në zgjedhje"** parashikuar nga neni 328/b, **"Kanosjes apo dhunimit ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje"** parashikuar nga neni 329 dhe **"Marrjes ose përdorimit të paligjshëm të dokumenteve të identifikimit"** parashikuar nga neni 331/a të Kodit Penal (**Prova Nr. 2 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 06.04.2021**).
11. Pavarësisht investimit të ndërkombëtarëve për të mos kandiduar persona të përfshirë në afëra korruptive apo me të kaluar kriminale në listë si kandidatë për deputete dhe thirrjes së vazhdueshme për të mos përfshirë në fushatë persona me rekorde kriminale, krimi dhe politika po punonjë së bashku me çdo mjet dhe mënyrë të kundraligjshme për të ndryshuar rezultatin e zgjedhjeve të 25 prillit. Rasti më tipik në këtë aspekt është ai i **Tom Doshit**, kryetarit të Partisë Social Demokrate dhe kandidat për deputet në Qarkun e Tiranës dhe Shkodrës. **Nëpërmjet Vendimit të datës 16 Prilli 2018, Departamenti Amerikan i Shtetit i ndaloi Tom Doshit hyrjen në SHBA me motivacioni si i përfshirë në mënyrë sinjifikative në korrupsion (Prova Nr. 3 – Public designation of Albanian MP Doshi for significant corruption)**. Madje pikërisht për këtë fakt, Ambasada Amerikane në Tiranë ka kërkuar në

- mënyrë të përsëritur dhe të prerë se ky shtetas nuk duhet të përfshihet në lista si kandidat në zgjedhjet e 25 prillit (**Prova Nr. 4 – Deklaratë e Amb.Amerikane për Tom Doshin**).
12. Megjithatë ky shtetas u regjistrua në zgjedhje si kandidat për deputet në Qarkun e Tiranës dhe Shkodrës dhe përdori çdo mjet të paligjshëm në mënyrë që të fitonte mandatin e deputetit. Nëpërmjet një skeme shantazhi dhe presioni, çdo punonjësi të punësuar pranë bizneseve të kandidatit Doshi i është kërkuar në mënyrë të prerë të votojë për të, madje të sigurojë edhe 20 emra dhe karta ID si vota të sigurta, në të kundërt do pushohet nga puna. Ajo që është edhe më shqetësuese, është fakti se në fushatë për të po punojnë persona me rekorde të rënda kriminale. **Filip Gjeloşi (Prova Nr. 5 – RENEA arreston për të tretën herë Filip Gjeloşajn, nën akuzë për kultivim droge)** dhe **Pal Gjeloşi** (xhaxhai i Filipit), dy nga elementët kryesorë të botës së krimit në Tiranë, të përfshirë në vepra të rënda penale si vrasje, rrëmbim personi dhe shumë të tjera, kanë blerë vota në favor të kandidatit Tom Doshi. Zona ku ata veprojnë janë Njësia nr. 4 në Tiranë, Rruga “Siri Kodra”, Allias dhe Babrru. Këta persona me rrezikshmëri të lartë shoqërore, nëpërmjet presionit dhe shantazhit dhe në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë krijuar një skemë kriminale të blerjes së votës për kandidatin Tom Doshi.
13. Në datën **07.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasit **Arben Ahmetaj**, Ministër Shteti për Rindërtimin dhe kandidat për deputet në Qarkun e Tiranës, **Ervin Bushati**, Bashkëdrejtuesit Politik i Partisë Socialiste në Qarkun e Tiranës dhe kandidat për deputet në Qarkun Tiranë, **Sadri Abazi**, Deputet për Qarkun Tiranë, **Arli Naska**, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Tatimeve e Taksave Vendore në Bashkinë Tiranë, **Mariglen Qato**, Drejtor i Inspektoriatit Ndërtimor në Bashkisë Tiranë, **Arlind Hoxha**, specialistit pranë Zyrës së Mediave dhe Publikut në Bashkinë Tiranë, **Artan Ligori**, Drejtor i Zyrës së Tatimeve e Taksa Vendore në Bashkinë Tiranë, **Aurel Veizaj**, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, **Elion Selmanaj**, Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, **Entel Agolli**, Drejtor në Postën Shqiptare, **Erion Xhebraj**, specialistit pranë Ndërmarrjes së Pastrim Gjellbërimit, Bashkia Tiranë, **Leonard Kuçi**, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, **Roven Zeka**, punonjës i policisë pranë Komisarariatit nr. 4, Tiranë dhe **Dilaver Velo**, punonjës i policisë pranë Komisarariatit nr. 4, Tiranë, të cilët me veprime konkrete kanë konsumuar veprat penale të "**Korrupsionit aktiv në zgjedhje**" parashikuar nga neni 328, "**Korrupsionit pasiv në zgjedhje**" parashikuar nga neni 328/b, "**Kanosjes apo dhunimit ndaj pjesëmarrësve**

në zgjedhje" parashikuar nga neni 329 dhe **"Marrjes ose përdormit të paligjshëm të dokumenteve të identifikimit"** parashikuar nga neni 331/a të Kodit Penal (**Prova Nr. 6 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 07.04.2021**).

14. Shtetasit e mësipërm kanë shkelur Kodin Penal dhe Kodin Zgjedhor nëpërmjet: Intimidimit me anë të punonjësve të administratës shtetërore të anëtarëve të Partisë Demokratike të zhvillojnë aktivitetet e parashikuara prej tyre në Njësitë Administrative 4 dhe 8, duke i kërcënuar këta të fundit me sanksione administrative/penale. Vizitave dhe intimidimit me anë të punonjësve të administratës shtetërore të pronarëve të bar/kafeve ku Partia Demokratike ka zhvilluar takime, duke i kërcënuar që në rast se lejojnë mbledhje në të ardhmen do të gjobiten nga organet e tatimeve dhe policisë. Kërcënimi me anë të telefonit apo personalisht nëpërmjet punonjësve të administratës shtetërore të aktivistëve të Partisë Demokratike dhe aleatëve të opozitës me qëllim që të largohen nga veprimtaria në këtë parti dhe të mos ushtrojnë të qetë të drejtat e tyre ligjore dhe në rast mostërheqje do të përballen jo vetëm me dënime atyre dhe familjarëve të tyre, por dhe me dhunë fizike.
15. Kanë shpërndarë kuponë për pajisjen me Kartë Identiteti dhe Pasaportë Biometrike shtetasve banues në Njësitë Administrative 4 dhe 8 në këmbim të premtimit të tyre që do të votojnë në zgjedhjet e ardhshme për Partinë Socialiste. Kanë shpërndarë Çetifikata Pronësie, Vërtetime Pronësie kundrejt premtimit për të votuar në favor të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Kanë shpërndarë ndihma në ushqime e veshmbathje, të gjitha këto në këmbim të premtimit për të votuar për Partinë Socialiste. Kanë shpërndarë para "cash" në disa zona të varfra të Njërive Bashkiake të sipërcituara. Thuajse çdo ditë të kallëzuarit në cilësinë e punonjësve të administratës publike, nuk kanë qenë në zyrën e tyre, por në vende të caktuara në Njësitë administrative 4 dhe 8, duke takuar funksionarë dhe simpatizantë të Partisë Socialiste dhe bërë fushatë politike me qëllim mbledhjen e votave për këtë subjekt politik.
16. Çdo ditë pas orës 20:00, orë në të cilën askush nuk duhet të dalë aq më tepër të bëjë fushatë, të kallëzuarit kanë qenë aktiv në zonë, duke përdorur asete të zyrës që drejojnë (burime njerëzore, automjete, pajisje zyre etj.) dhe duke biseduar me qytetarë të zonës me qëllim mbledhjen e votave për Partinë Socialiste. Kanë koordinuar e urdhëruar marrjen nga votues të identifikuar si votues tradicionalë të Partisë Demokratike apo opozitës, kartat e identitetit të tyre dhe të familjarëve me qëllim që këta të fundit të mos votojnë në zgjedhje. Kanë koordinuar e urdhëruar kërkimin me anë të kanosjes apo korrupsionit të kartave të identitetit të kësaj kategorie votuesish, me qëllim ndikimin në rezultatet zgjedhore në favor të Partisë Socialiste.

17. Në datën **07.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasen **Meri Musa**, me detyrë drejtoreshë e Shkollës “Ibrahim Brahja” në Sauk, të cilët me veprime konkrete kanë konsumuar veprat penale të **“Korrupsionit aktiv në zgjedhje”** parashikuar nga neni 328 dhe **“Korrupsionit pasiv në zgjedhje”** parashikuar nga neni 328 të Kodit Penal. Shtetasja **Meri Musa**, me detyrë drejtoreshë e Shkollës “Ibrahim Brahja” në Sauk, ka qenë organizatore e një skeme kriminale të blerjes së votës në favor të Partisë Socialiste në Sauk. Me burime të paligjshme dhe të pidentifikuara të ardhurash, kjo shtetase ka premtuar dhe dhënë para në këmbim të votës për Partinë Socialiste. Nga ana tjetër, pavarësisht detyrës si drejtoreshë shkolle, ajo ka punuar aktivisht gjatë orarit të punës në fushatë për Partinë Socialiste në zonën e Saukut (**Prova Nr. 7 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, në datën 07.04.2021**).
18. Në datën **12.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasit **Belinda Balluku**, Ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kandidate për deputete në zonën e Kombinatit në Tiranë, **Laureta Omeri**, Këshilltare e Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtare në disa borde të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe drejtuese e shtabit të fushatës së Belinda Ballukut si kandidate për deputete në zonën e Kombinatit në Tiranë, **Elira Gogo**, Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tërë Jug (përgjegjëse për zonën e Kombinatit), **Johana Bushi**, **Erga Ibrahim**, **Ceno Klosi**, **Gazment Zela**, **Juljana Melyshi**, **Ilir Belba**, **Elfrida Brati** dhe persona të tjerë të pidentifikuar prej nesh, të cilët me veprime ose mosveprime kanë konsumuar veprat penale të **“Shpërdorimit të detyrës”** parashikuar nga neni 248, **“Korrupsioni aktiv në zgjedhje”** parashikuar nga neni 328, **“Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”** parashikuar nga neni 328/a dhe **“Grupit të strukturuar kriminal”** parashikuar nga neni 333/a të Kodit Penal (**Prova Nr. 8 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 12.04.2021**).
19. **Belinda Balluku**, në cilësinë e kandidates për deputete në Qarkun e Tiranës në zonën e Kombinatit, nëpërmjet një grupi të strukturuar kriminal ju siguron qytetarëve të Kombinatit leje legalizimi, certifikata pronësie etj., në këmbim të votave për Partinë Socialiste dhe vete. **Laureta Omeri** është Drejtuese e Shtabit të fushatës së Ballukut në Kombinat dhe njëkohësisht Këshilltare dhe Anëtare në disa borde të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Më herët ka mbajtur pozicionin e N/Kryetares së Bashkisë Vorë, e emëruar me mbështetjen e Belinda Ballukut. Kjo shtetase ka rol kyç në këtë organizatë kriminale me qëllim

- tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve nëpërmjet lejeve të legalizimit, certifikatave të pronësisë etj.
20. Në funksion të maksimizimit të votës për Belinda Ballukun dhe Partinë Socialiste, **Laureta Omeri**, Drejtuese e Shtabit të Ballukut, ka urdhëruar **Organizatat Politike (struktura të PS-së)** të evidentojnë në terren personat/familjet të cilat kanë probleme legalizimesh, hipoteka etj. **Organizatat Politike (OP)** nëpërmjet **koordinatorëve** jo vetëm që kanë evidentuar në terren personat/familjet, të cilat kanë probleme legalizimesh, por edhe ju kanë premtuar kryerjen e legalizimit në këmbim të votës. Kjo pasi në bisedat në grup dalin materiale të punuara nga OP ku këta persona përfshihen nga patronazhistët në listat e votuesve të sigurt.
 21. Po në cilësinë e drejtueses së fushatës, kjo shtetase ka hapur në rrjetin e komunikimit Whatsapp një grup të emërtuar **“Grupi Matjeve Kombin”**, me imazhin e kandidates për deputete në Kombin **Belinda Balluku**, e cila shërben si urë lidhëse midis **Organizatave Politike** (struktura të Partisë Socialiste) dhe administratës së **Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**, dhe funksionon vetëm në bazë të instruksioneve dhe urdhrave të saj. Theksojmë se, në të gjithë komunikimin dalin fjalët **votues**, **lista** dhe **patronazhe** (vota të sigurta) pra një skemë e organizuar blerje vote si dhe materialet/dokumentat përkatës (**Prova Nr. 9 – Foto nga grupi në whatsapp “Grupi i Matjeve Kombin” dhe materiale të tjera**).
 22. Vetëm nga bisedat e disponuara dalin **8 lista të përfunduara legalizimesh**, dhënë nga kordinatorët e mëposhtëm të Partisë Socialiste:
 1. **Johana Bushi** (Ka qenë shefe e kabinetit të Belinda Ballukut, kur ishte Drejtoreshë e Agjencisë Nacionale të Transportit Ajror (ANTA)
 2. **Erga Ibrahimi**
 3. **Ceno Klosi**
 4. **Gazment Zela**
 5. **Juljana Melyshi**
 6. **Ilir Belba**
 7. **Elfrida Brati**
 8. **Anisa (nuk ka mbiemër)** – lista të cilën po bëjmë matjet aktualisht.
 23. Pasi **Laureta Omeri** merr listat nga strukturat e PS me votues të sigurt, të cilat përkojnë me objekte që duhet të legalizohen, **ia përcjell me urdhër** Drejtoreshës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë Jug, **Elira Gogo** (përgjegjëse për zonën e Kombinatit). Nga komunikimet në grup, Laureta thotë: *“Kini parasysh që një lagje/bllok do jetë i njëjti grup matjesh. Drejtoresha*

- pastaj duhet ta zgjidhë vetë me kolegët që do ndjekin përpunimin e dosjeve". Elira Gogo i përcjell listat grupeve të terrenit të administratës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të cilët bëjnë matjet. Sipas komunikimeve këta persona janë të emëruar politikisht në administratë dhe plotësisht të përfshirë në fushatë për Belinda Ballukun dhe Partinë Socialiste.*
24. Për të faktuar kryerjen e matjeve ata dërgojnë "location" në grupin në whatsapp, së bashku me emrin dhe numrin e personit të përfshirë në listat e Organizatave Politike si persona me probleme legalizimesh, për të faktuar se kanë shkuar në terren për të kryer matjet, si kusht kryesor për të kaluar më pas dosjet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për miratim. Sipas komunikimeve, në përfundim të matjeve administrata detyrohet nga ana e Laureta Omerit për të telefonuar qytetarët dhe për t'i informuar "me dashuri" se legalizimi i premtuar po kryhet. *"Ju lutem sa të mbaroni këto që keni në dorë bëjme këto të dyja (bëhet fjalë për dy rast të fundit të një liste). Gazi i ndjek dhe ti, ti telefonosh pak me dashuri zotërinjtë".*
25. Nga data 24.03.2021 deri sot (informacioni që kemi ne), janë matur në terren pronat e **146 familjeve**, të cilët **janë përfshirë në listat e patronazhistëve si vota të sigurta**. Pasi përfundon procesi i matjeve në terren, dosja kalohet për miratim nga Drejtoresha e ASHK Tërana Jug, **Elira Gogo**, e cila pasi përfundon edhe këtë proces administrativ, poston në grup certifikatën përkatëse të miratuar. Ky grup ka qenë aktiv deri në datën 24 Prill dhe çdo ditë vinin me dhjetra mesazhe për përfundimin e procesit të legalizimit për familjet e evidentuara nga struktrat e PS, të cilave më pas në këmbim të votës për Belinda Ballukun ju sigurohet leja e legalizimit.
26. Në datën **15.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasit **Arben Ahmetaj**, Ministër Shteti për Rindërtimin, **Rakip Suli**, Kryetar i Bashkisë Kamëz, **Ylli Shehu**, Kryetar i Njësisë Administrative Bathore, Bashkia Kamëz, **Ardjen Markola**, Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit, **Erlend Baballëku**, Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit, **Teuta Çami**, Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit, **Mirela Ndreu**, Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit dhe **Ernest Sinani**, Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit, për shkelje të Kodit Zgjedhor dhe Kodit Penal duke konsumuar veprat penale të **"Shpërdorimit të detyrës"** parashikuar nga neni 248 dhe **"Korrupsionit aktiv në zgjedhje"** parashikuar nga neni 328 të Kodit Penal (**Prova Nr. 10 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 15.04.2021**).
27. Në datë 24 Mars 2021, emisioni STOP (sezoni 6, episodi 143) trajtoi çështjen e abuzimit me fondet e tërmetit në Bashkinë Kamëz. Zona e quajtur Ish-Stallat, Njësia Administrative

Bathore në Bashkinë Kamëz është një nga zonat e prekura nga tërmeti i datës 26.11.2020 dhe në redaksinë e emisionit “Stop” kanë ardhur disa ankesa lidhur me shpërndarjen e fondeve nga ana e njësive administrative Bathore për rikonstruksionin e shtëpive të prekura nga tërmeti. Sipas përcaktimeve ligjore çdo kryefamiljar me shtëpi të vlerësuar me DS3, duhet të përfitojë 4.5 milionë lekë të vjetra si dëmshpërblim për riparimin e shtëpisë. Disa banorë thonë, se kjo shumë nuk u mjafton për ta bërë shtëpinë të banueshme. Të tjerë thonë, se nuk kanë marrë asnjë përfitim monetar, ndryshe nga komshinjtë, që janë në të njëjtat kushte dëmtimi ose edhe më të dëmtuar (**Prova Nr. 11 – Skandali me fondet e tërmetit, paratë janë shpërndarë edhe tek personat jashtë vendit**).

28. Janë disa banorë në zonën e ish-Stallave që kanë komentuar lidhur me përfitimin e grantit të rindërtimit. Banorit 1, shtetasi Agim Topalli, shtëpinë ja kanë kategorizuar si DS3 dhe ka përfituar 4.5 milion lekë të vjetra, të cilat i konsideron si të pamjaftueshëm për rikonstruksionin e shtëpisë. Banori 2, kategorizimin e shtëpisë sipas letrave e ka si DS4, por përfitimi i ka kaluar si DS3. Komenton se një pjesë e banorëve të zonës kanë marrë bonus qiraje duke jetuar në shtëpinë e tyre. Banori 3, nuk ka përfituar asnjë fond për dëmtimin e shtëpisë. Kur është interesuar pranë njësive administrative i kanë komunikuar se ka çertifikatë pronësie dhe nuk meriton të marrë shpërblim. Banori 4, shtetasi Sefer Tanushi, komenton për padrejtësinë që është bërë ndaj fondit të shpërndarë nga Bashkia apo shteti. Kanë përfituar 30 familje, nga ku dy komshinjtë kanë përfituar nga fondi për rindërtim, ndërsa ai vetë jo.
29. Në listën e emrave të siguruar nga “Stop”, rezulton se janë shpërndarë fonde edhe për persona të cilëve nuk u takon dëmshpërblimi. Në disa familje, përveç kryefamiljarit, kanë marrë para edhe anëtarët e tjerë të familjes. Në listën, që disponon emisioni “Stop”, ka edhe familje, që nuk jetojnë te ish-stallat, madje disa jetojnë jashtë Shqipërisë. Nëse një shtëpi është e dëmtuar nuk ka rëndësi sa familjarë jetojnë, përfiton vetëm kryefamiljari. Në bazë të vërtetimeve të pa kundërshtueshme kanë përfituar persona që jetojnë jashtë vendit dhe në Kosovë. Emisioni STOP siguroi listën e fondit të dëmshpërblimit të kategorizuar si DST. Bashkia Kamëz me Projekt Vendimin nr 130 datë 02.02.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga granti i rikonstruksionit” ka ngritur Komisionin e Posaçëm të Rindërtimit për objektet kolektive. Pjesëtarët e këtij komisioni janë **Ardjen Markola, Erlend Baballëku, Teuta Çami, Mirela Ndreu, Ernest Sinani**. Në kundërshtim me atë çka parashikon procedura, ato nuk janë pjesë e Bashkisë Kamëz.

30. Referuar Emisionit “STOP” dhe listës së siguruar prej tyre të përfituesve, familja e parë ka si kryefamiljar Agim Ibish Lleshi, i cili përfiton 4.5 milion lekë të vjetra për rikonstruksionin e shtëpisë sipas përcaktimit që i është bërë kësaj familje me formularin DS3, por në listë shohim që kanë përfituar dhe anëtarë të tjerë të kësaj familje, tre anëtarët Ermal Agim Lleshi, Egzon Agim Lleshi dhe Ramazan Agim Lleshi. Shpërdorimi i fondeve të tërmetit për këtë familje arrin në 13.5 milion lekë të vjetra. Familja e dytë, Vehap Ibish Lleshi, kryefamiljar, por në listë del që ka përfituar dhe një anëtar tjetër i kësaj familje, Eduard Vehap Lleshi. Shpërdorimi i fondeve të tërmetit për këtë familje është 4.5 milion lekë të vjetra. Familja e tretë, Fatime Bajram Bulica, kryefamiljare dhe i takon të marrë 4.5 milion lekë të vjetra. Ndërkohë sipas listës rezulton që kanë përfituar dhe dy anëtarë të tjerë të kësaj familje, Agim Jonuz Bulica dhe Urim Jonuz Bulica. Shpërdorimi i fondeve të tërmetit për këtë familje është 9 milion lekë të vjetra. Familja katër, Shkëlzen Bajram Hasa, kryefamiljar ku rezulton sipas ligjit të marrë 4.5 milion lekë të vjetra, por në listë figuron dhe Ardit Shkëlzen Hasa dhe Bajram Shkëlzen Hasa. Shpërdorimi i fondeve të tërmetit për këtë familje është 9 milion lekë të vjetra. Familja pesë, Xhemal Bajram Toluli, kryefamiljar ku rezulton sipas ligjit të përfitojë 4.5 milion lekë të vjetra, por në listë figuron dhe Ylli Xhemal Toluli. Shpërdorimi i fondeve të tërmetit për këtë familje është 4.5 milion lekë të vjetra.
31. Siç duket qartë nga kjo listë, njësia administrative Bathore ka një fond të përcaktuar prej 4.5 milion lekë të vjetra për çdo kryefamiljar, por për disa familje në mënyrë abusive i ka dhënë për të gjithë anëtarët e një familjeje ndonëse ligji parashikon se këtë fond për ta bërë shtëpinë e banueshme duhet ta marrë vetëm kryefamiljari. Kjo ka sjellë që shumë familje që vërtetë kanë nevojë dhe i takon dëmshpërblimi për rindërtimin, mos ta përfitojnë atë. Gjithashtu, në këtë listë janë qytetarë persona, të cilët nuk figurojnë banues të Zonës ish-Stallat Bathore madje jetojnë jashtë Shqipërisë, por çuditërisht ata kanë përfituar shumën prej 4.5 milion lekë të vjetra nga njësia administrative Bathore si më poshtë: Rexhep Haxhi Mulaku dhe Ardian Fatmir Hamzaj, nuk janë banorë të ish-Stallave në Bathore. Fatmir Vesel Lashi, figuron që jeton në Itali. Elisabeta Agim Kurhaska figuron që është e martuar në Kosovë.
32. Për të qenë transparent dhe për t'i shkruar deri në fund kësaj çështje emisioni “Stop” iu drejtua fillimisht Njesisë Administrative Bathore dhe Bashkisë së Kamzës për të pyetur nëse këtë fond limit për të rindërtuar shtëpitë, të cilat janë kategorizuar në DS3 e përfitojnë të gjithë antarët e familjes apo vetëm kryefamiljari. Njësia Administrative Bathore ka konfirmuar që këtë shumë e përfiton vetëm kryefamiljari dhe jo të gjithë antarët e familjes. Nga Njësia Administrative

- Bathore, Bashkia Kamëz është përgjegjës për një punonjëse dhe një punonjës me emrin Elidon Marku. Kjo skemë kriminale favorizimi me grante dhe dëmshpërblime të qytetarëve në Bathore, të cilët nuk janë demtuar nga tërmeti, nuk janë banorë të zonës po edhe që jetojnë jashtë vendit është jo vetëm një aferë korruptive, por po përdoret nga Ministria e Rindërtimit, Bashkia Kamëz dhe Njësia Administrative Bathore për blerje votash në favor të PS-së me fondet e rindërtimit për të maksimizuar në mënyrë të paligjshme votat për Partinë Socialiste.
33. Në datën **15.04.2021**, portali “JOQ Albania” ka publikuar disa raste të blerjes së votave pranë zonës së teleferikut Tiranë, ku familjeve të ndryshme u janë dhënë zarfe me ngjyrë mavi (ngjyra e PS), mbishkrimin “Miqësisht, Erion Veliaj”, nënshkrimin e tij, dhe brenda tyre gjenden shuma 5.000 lekë (të reja) (**Prova Nr. 12 – “Miqësisht Erion Veliaj”/Kryetar i Bashkisë fut 50-shen në zarfin lejla, qytetari DENONCON: Iu është shpërndarë familjeve afër teleferikut**).
34. Në datën **18.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasit **Bujar Mema**, Kryetar i Bashkisë Kavajë, **Sami Dervishi**, Drejtor i shkollës 9-vjeçare Karpën, **Bujar Dervishi**, Specialist në Komisaratin e Policisë Kavajë dhe **Arben Mema**, Specialist në Komisaratin e Policisë Kavajë, të cilët me veprime konkrete kanë konsumuar veprat penale të **"Shpërdorimit të detyrës"**, parashikuar nga neni 248, **"Korrupsioni aktiv në zgjedhje"**, parashikuar nga neni 328 dhe **"Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore"** parashikuar nga neni 328/a të Kodit Penal (**Prova Nr. 13 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 18.04.2021**).
35. Gjatë periudhës zgjedhore në fshatin Bago, Bashkia Kavajë, shtetasve të ndryshëm i është lejuar të ndërtojnë pa leje kundrejt votave për Partinë Socialiste. Këto veprime antiligjore janë shtuar së tepërmi dhe po përdoren masivisht për fushatë elektorale për të maksimizuar votën për Partinë Socialiste. Në fshatin Bago, Kavajë është lejuar të ndërtohet pa leje nga shtetasi **Ervin Duda**. Ndërtim ky i favorizuar nga shtetasit **Sami Dervishi**, kryetar i seksionit të Partisë Socialiste në Karpën, me detyrë Drejtor në Shkollën 9-vjeçare Karpën, nga djali i tij, **Bujar Dervishi** me detyrë Specialist i Policisë së Zonës (SPZ) në Komisaratin e Policisë Kavajë dhe **Arben Mema** me detyrë Specialist i Policisë së Zonës (SPZ) në Komisaratin e Policisë Kavajë. Ky ndërtim është lejuar **kundrejt 20 votave për Partinë Socialiste në zgjedhjet e 25 prillit**. (**Prova Nr. 14 – Ndërtimi pa leje i Ervin Duda**).

36. Po në fshatin Bagot të Kavajës është lejuar të ndërtojë pa leje edhe shtetasi **Naim Isteri**. Ndërtim ky i favorizuar sërish nga shtetasit **Sami Dervishi**, kryetar i seksionit të Partisë Socialiste në Karpën, me detyrë Drejtor në Shkollën 9-vjeçare Karpën, nga djali i tij, **Bujar Dervishi** me detyrë Specialist i Policisë së Zonës (SPZ) në Komisariatit e Policisë Kavajë dhe **Arben Mema** me detyrë Specialist i Policisë së Zonës (SPZ) në Komisariatit e Policisë Kavajë. Ky ndërtim është lejuar **kundrejt 20 votave për Partinë Socialiste në zgjedhjet e 25 prillit (Prova Nr. 15 – Ndërtimi pa leje Naim Isteri)**. Lejimi i ndërtimeve të paligjshme në këmbim të votës u shtua së tepërmi në këtë fshat gjatë fushatës elektorale, nëpërmjet ndihmës dhe veprimeve kriminale të funksionarëve të administratës dhe policisë me qëllim maksimizimin e paligjshëm të votave për Partinë Socialiste.
37. Të gjitha sa më sipër të provuara dhe faktuara gjenden në aneksin 1 të kësaj ankese, vecanërisht 7 kallëzimet penale nga data 04.04.2021 dhe 18.04.2021, si dhe 8 prova më sipër. Faktet dhe grup-faktet e paraqitura provojnë katërcipërisht shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor me qëllimin e qartë për të ndikuar mbi rezultatin zgjedhor dhe ndarjen e mandateve. Partia Demokratike ka denoncuar në mënyrë të vazhdueshme faktin se në zonën zgjedhore Qarku Tiranë nuk kishte përballë saj një parti politike dhe kandidatët e saj që garonin me një ofertë politike, por një makineri shtetërore, e cila në bashkëpunim me grupe të strukturuar dhe banda kriminale, blinin vota, kërcënonin qytetarët, intimidonin nëpunësit publikë, shpërndanin leje legalizimi/ndërtimi, licensa, shpërblime dhe prokurime publike.
38. Shitblerja e votës është një ndër problematikat kryesore të konstatuara edhe në Deklaratën e Gjetjeve dhe Rekomandimeve Paraprake të Misionit Ndërkombëtarë të Vëzhguesve të OSBE/ODIHR (në vijim Misioni i OSBE/ODIHR). Konkretisht, në raport thuhet praktikat gjërësisht të përhapura të shitblerjes së vota vazhduan të përbënin problem (shih fq. 2). Akuzat për shitblerja votash ishin konstante gjatë fushatës, duke treguar se ky vazhdoi të përbëntë një problem gjërësisht të përhapur. Struktura e Posacme e Anti-Korrupsionit (SPAK) e infomoi MKVZ-në e ODIHR-it se deri më 24 prill 2021, kishte hapur më shumë se 30 çështje që lidheshin me shitblerjen e votës. MKVZ-ja e ODIHR-it u informua, gjithashtu, nga prokurorë të Beratit dhe të Shkodrës se kishin nisur hetimet për disa incidente të shitblerjes së votës. PD-ja depozitoi një ankesë në Strukturën e Posacme Anti-Korrupsion (SPAK) që përmbante dhjetëra akuza për incidente shitblerjeje të votës në Elbasan (shih fq. 11).
39. MKVZ-ja e ODIHR-it mori raportime të besueshme se koordinatorët e fushatës së partive më të mëdha i ishin afruar një numri të konsiderueshëm zgjedhësish nga komunitetet rome

dhe egjiptiane për t'u blerë votat. OJQ-të rome raportuan se kjo praktikë është e zakonshme dhe se shumë votues do t'i shisnin votat, të shtyrë nga varfëria (shih fq. 18). Në disa qarqe, MNVZ-ja vuri re grupe djemsh të mbledhur jashtë qendrave të votimit, që dukeshin sikur kontrollonin zonë dhe shihnin se kush votonte. Në qarkun e Shkodrës, vëzhguesit vunë re një person që tërhiqte dikë tjetër për ta futurë në qendrën e votimit, dhe, në momentin që ky i dyti ishte brenda qendrës së votimit, u udhëzua për kë të votonte. Po në këtë qark, MNVZ-ja që dëshmitare e një rasti të shpërndarjes së parave në një qendër votimi (shih fq. 19). Shitblerja e votës theksohet si një ndër problemet kryesore të zgjedhjeve në Shqipëri edhe në deklaratën e datës 7 maj 2021, të Misionit të SHBA-ve në OSBE (**Prova Nr. 16 – Deklaratë e SHBA në OSBE, datë 07.05.2021**).

A.2 Blerja e votës nëpërmjet dhënies së ndihmave ushqimore, bonuseve dhe përfitimeve të tjera (12 prova)

40. Sipas të dhënave të publikuara në media nga organizata të shoqërisë civile, bashkitë Durrës, Tiranë, Kavajë, Lezhë, Rrogozhinë, Vorë, Krujë, Lac dhe Mirditë shpërndanë 40 milionë euro për familjet e prekura nga tërmeti i Nëntorit 2019. Kjo vlerë u nda përkatesisht në 14 milionë euro gjatë muajit Mars, ndërsa 26 milionë të tjera u shpërndanë në muajin Prill. Vetëm gjatë javës së fundit të fushatës zgjedhore, Bashkia Durrës shpërndau 6 milionë euro për procesin e rindërtimit ose 89 herë më shumë se sa ka shpërndarë në 15 muajt e fundit. Ndërsa, vlera konkrete dhe familjet përfituese në Qarkun Tiranë mbeten për t'u përcaktuar në momentin e marrjes së informacionit gjatë hetimit administrativ (**Prova Nr. 17 – Dhënia e parave familjeve të prekura nga tërmeti**).
41. Partia Demokratike disponon pamje filmike në të paktën 42 raste të ministrave, deputetëve, kandidatë të PS për deputetë duke shpërndarë ndihma ushqimore për familjet në nevojë, dhurata ose përfitime të tjerë për kategori të caktuara. Rastet e identifikuara nga Partia Demokratike janë si vijon: Elona Gjeberë, me detyrë deputete (3 raste); Vasilika Hysi, me detyrë zëvendëskryetare e Kuvendit (1 rast); Ervin Bushati, me detyrë deputet dhe kryetar i PS Tiranë (17 raste); Ogerta Manastirliu, me detyrë Ministër i Shëndetësisë (5 raste); Fatmir Xhafaj, me detyrë deputet (1 rast); Rakip Suli, me detyrë kryetar i Bashkisë Kamëz (1 rast); Xhemal Qefalia, me detyrë deputet (2 raste); Ulsi Manja, me detyrë deputet (3 raste); Sadi Vorpsi, me detyrë deputet (1 rast); Sadri Abazi, me detyrë deputet (5 raste); Mimi Kodheli, me

- detyrë deputete (1 rast) dhe Erion Veliaj, me detyrë kryetar i Bashkisë Tiranë dhe drejtues politik i PS Tiranë (2 raste) (**Prova Nr. 18 – Shpërndarja e ndihmave ushqimore nga eksponentët e PS**).
42. Ndërsa, për rastin e Kombinatit, PD disponon fakte të pakundërshtueshme të dhënies së ndihmave ushqimore komunitetit rom. (**Prova Nr. 19 – Dhënie e ndihmave ushqimore në Kombinat për romët**). Në një mesazh të dërguar në whatsapp nga strukturat e PS në Kombinat, thuhet “Përshëndetje! Uroj të jeni mirë. Son në organizatën 1873 u shpërndanë ndihma për 30 familje në nevojë, ku secila familje mori nga 2 pako me ushqime bazë që i nevojitet një familjeje. Për organizimin e kësaj ndihme falënderojmë deputeten Znj. Belinda si dhe të deleguarën tonë Eda Bega, për mbështetjen dhe organizimin në shpërndarjen e këtyre ndihmave. Gjithashtu falënderojmë edhe anëtarët e organizatës që u treguan të gatshëm për shpërndarjen. #Bashkëdojadalin” (**Prova Nr. 20 – Shpërndarja e ushqimeve në Kombinat, mesazhi whatsapp**). Është e qartë se dhënia e këtyre ndihmave ushqimore, dhurata apo përfitimeve të tjera për kategori të caktuara nuk niset nga qëllime humaniste, por me qëllim të pastër tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve, duke shfrytëzuar varfërinë e tyre.
43. Ndërkohë, në një denoncim të bërë publik në media, OSHEE iu ka paguar 13 mijë punonjësve të saj një rrogë plus gjatë fushatës elektorale të Partisë Socialiste me qëllim marrjen e mbështetjes për Partinë Socialiste. Drejtori i përgjithshëm i OSHEE ishte i angazhuar drejtpërdrejtë në fushatë si drejtues politik i PS për Qarkun Durrës (**Prova Nr. 21 – Pagë shtesë për 13 mijë punonjës të OSHEE**).
44. Nëpërmjet numrit të telefonit +355 4 450 0920, emigrantë shqiptarë, që jetojnë dhe punojnë në Milano, Itali, janë kontaktuar nga persona, që pretendonin se ishin punonjës administrate, të cilëve iu është premtuar se nëse vinë në Shqipëri për të votuar Partinë Socialiste, rrugën dhe të gjitha shpenzimet e tjera do t’i kenë të paguara (**Prova Nr. 22 – Numri i telefonit që janë kontaktuar emigrantët shqiptarë**).
45. Me Vendimin Nr. 1044, datë 18.12.2020 “Për një shtesë në vendimin Nr. 929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Mbi krijimin e një fondi të posacëm””, qeveria përcaktoi dhënien e një shpërblimi fundviti për mjekët dhe punonjësit e Policisë së Shtetit. Mënyra e pagesës do të përcaktohej nga Fondi i Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (**Prova Nr. 23 – VKM Nr. 1044/2020**).
46. Me Vendimin Nr. 1076, datë 24.12.2020, Qeveria ka vendosur të ndryshojë strukturën dhe nivelin e pagave për punonjësit e stafit mjekësor, punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe

- punonjësit e stafit teknik të shkencave mjekësore në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë, Njësisë Mjekësore Ushtarake në Spitalin Universitar të Traumës, në strukturat e Forcave të Armatosura dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (**Prova Nr. 24 – VKM 1076/2020**). Ndërsa, me Vendimin Nr. 1102, datë 24.12.2020, Qeveria ka vendosur të akordojë fonde në vlera të ndryshme për kategori të ndryshme të popullsisë rurale nga fondi i posacëm për bujqësinë dhe zhvillimin rural (**Prova Nr. 25 – VKM 1102/2020**).
47. Në **11.02.2021**, u publikua në Fletoren Zyrtare një vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore me nr. 101, datë 15.12.2020 “Autorizim i ndihmës shtetërore për fuqizimin e të rinjve dhe të rejave”, nëpërmjet të cilit autorizohet Bashkia Tiranë të mbështeste me grante të rinjtë e prekur nga pasojat e shkaktuara nga tërmetet e nëntorit 2019, si dhe pandemia COVID-19. Ndihma do të jepej në formën e grantit në vlerën 16 milionë lekë ose 131 mijë euro, ku cdo përfituese do të mbështetet me grant të drejtëpdrejtë rreth 80.000 lekë ose 6.6 mijë euro (**Prova Nr. 26 – Vendimi nr. 101, date 15.12.2020 “Autorizim për dhënien e ndihmës shtetërore**).
48. Në **16.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasit **Erion Veliaj**, Kryetar i Bashkisë Tiranë, **Ogerta Manastirliu**, Ministër i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe **Sokol Dardha**, Administratori i Njësisë Administrative Nr. 9, Bashkia Tiranë, të cilët me veprime konkrete kanë konsumuar veprat penale të **“Shpërdorimit të detyrës”**, parashikuar nga neni 248, **“Korrupsioni aktiv në zgjedhje”**, parashikuar nga neni 328 dhe **“Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”** parashikuar nga neni 328 / a të Kodit Penal (**Prova Nr. 27 – Kallëzimi penal i Partisë Demokratike, datë 16.04.2021**).
49. Me qëllim favorizimin e kandidates Ogerta Manastirliu në zgjedjet e 25 prillit u shpërdanë ushqime në familjet në nevojë nëpërmjet automjetit në pronësi të Bashkisë Tiranë, të cilat janë magazinuar në ambientet e Biblotekës “Petro Zheji” e ndodhur në Njësinë Administrative Nr. 9, Tiranë (**Prova Nr. 28 – Foto nga magazinimi i ushqimeve në bibliotekën “Petro Zheji”**). Këto veprime janë kryer me vetëdije, në kundërshtim me dispozitat ligjore, me dashje dhe në bashkëpunim me të kallëzuarit. Fakt tjetër që kërkojmë të përmendim është dhe vënia në dispozicion e të gjithë strukturës dhe pasurive publike të Bashkisë së Tiranës në funksion të fushatës elektorale. Siç jeni në dijeni kryetari i Bashkisë Tiranë është dhe Drejtuesi Politik i Partisë Socialiste për Qarkun Tiranë dhe në funksion të kësaj detyre në mbështetje të kandidatëve të PS të kallëzuar prej nesh, ka konsumuar elementet e veprave penale të sipërcituar.

B. Vendosja e shtetit në shërbim të Partisë, duke përdorur në mënyrë të paligjshme burimet shtetërore për devijimin e vullnetit të zgjedhësve (45 prova)

B.1 Tendera/prokurime publike për individët me rekorde kriminale në këmbim të mbështetjes politike në zgjedhje:

50. Viti 2020, si një vit para-zgjedhor pa një rritje të lartë të kontratave publike, qoftë në numër, ashtu edhe në vlerën e tyre. **878 kontrata publike me vlerë 505 milionë Euro u prokuruan në vitin 2020**, ndërkohë që mesatarja e vlerës së kontratave publike të 5 viteve të fundit është në vlerën 116 milionë Euro.
51. Me Vendimin Nr. 1185, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave “Mbi përcaktimin e metodologjisë dhe procedurave për monitorimin e trafikut në fushën e hidrokarbureve”, qeveria shpalli një koncesion me vlerë 100 milionë Euro dhe kohëzgjatje 10 vite (**Prova Nr. 29 – VKM Nr. 1185/2020**).
52. Sic kemi cituar në paragrafët 7-9 të këtij seksioni, shtetasit **Aleksandër Lipivani, Emiljano Dusha, Ardian Davidhi, Rexhep Spahiu, Marlind Shkreli** dhe një shtetas i quajtur **Klodi**, janë angazhuar në blerje vote për llogari të Partisë Socialiste. Këta shtetas njihen gjithashtu si përfitues të kontratave publike, me vlera të larta, përgjithësisht pa garë ose në shkelje të hapur të parimit të barazisë së pjesëmarrësve në tendera publikë. Konkretisht, shtetasi **Emiljano Dusha**, i cili është zotërues i shoqërisë **MSSC Military System Supply Company shpk** me NIPT L01306040L, është përfitues nga ana e Qeverisë jo vetëm e procedurave korruptive të prokurimit por edhe të kontratave të klasifikuara (sekrete), me objekt blerje armatime dhe pajisje për Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe Policinë e Burgjeve. Bazuar në të dhënat zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, kjo shoqëri ka përfituar **5 procedura prokurimi korruptive**, me vlerë **3 milionë euro**, pa garë ose sa 98% e vlerës së fondit limit. Nga ana tjetër, bazuar në të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financave, kjo shoqëri ka përfituar **55 transaksione thesari si kontrata të klasifikuara (sekrete)**, me vlerë **11 milionë euro** (**Prova Nr. 30 – Të dhënat nga APP/Thesari**).
53. Ndërsa, shtetasi **Ardian Davidhi**, nëpërmjet shoqërisë së zotëruar prej tij **K O A N sh.p.k.** me NIPT K41710001D, ka përfituar **12 procedura prokurimi**, me vlerë **5.7 milionë euro**. Këto tendera janë përfituar kryesisht pa garë ose si oferta më e lartë me diferencë mijëra euro

me ofertën më të ulët dhe ku vlera e kontratave është sa 97% e vlerës së fondit limit (**Prova Nr. 31 – Të dhënat nga APP/Thesari**).

B.2 Shteti vendosi investimet publike/rindërtimin në funksion të PS për zgjedhjet (shkelje e përsëritur mbi 120 herë në të gjithë vendin):

54. Kryeministri Rama, ministrat, deputetët dhe kryebashkiakët e PS-së përdorën investimet publike dhe procesin e rindërtimit për propagandë politike, në kundërshtim me parashikimet e 78 dhe 91 të Kodit Zgjedhor dhe Vendimin Nr. 9/2020 të KQZ-së. Konkretisht, Pavarësisht se pronat e tyre nuk kanë pasur ndërtime, shtetasi e mëposhtëm kanë përfituar dëmshpërblime nga Bashkia Tiranë, si rezultat i procesit të rindërtimit, me meritën e vetme sepse janë mbështetës të Partisë Socialiste. Konkretisht, shtetasit që kanë përfituar janë: Eshref Disha, babai i kryetarit të PS Laprakë; Syle Gosturani, anëtar i Partisë Socialiste (QV 2029); Mimoza Pëllumbi, drejtuese e organizatës së PS për QV 2007/2008, e punësuar pranë repartit inspektim-shpëtim miniera; Dali Totraku, anëtar i PS (QV 2009); Besnik Cjapi, anëtar i PS-së; Arze Zejneli, punonjëse e Bashkisë Tiranë; Kujtim Mema, punonjës i Bashkisë Tiranë; dhe Besim Mamo, punonjës i Bashkisë Tiranë.
55. Shtetasve Hamdi Pepa dhe Muharrem Troka, banues në Bashkinë Rrogozhinë, iu është plotësuar dokumentacioni për të përfituar dëmshpërblimet nga procesi i rindërtimit vetëm se janë votues të Partisë Socialiste. Por, sikurse provohet nga pamjet foto të siguruara nga strukturat e PD-së, këto shtëpi nuk kanë asnjë dëmtim nga tërmeti (**Prova Nr. 32 – Shtëpitë e padëmtuara të Hamdi Pepa dhe Muharrem Troka**).
56. Në njësinë administrative Nr. 2, Tiranë janë shtruar me asfalt për fushatë elektorale katër rrugë, përkatësisht Rr. Haxhi Alija, Rr. Hamide Dalipi, Rr. Hajredin Fratari dhe Rr. Haki Glina. Këto rrugë janë investuar pa asnjë transparencë, punimet janë kryer gjatë natës, me burime financiare të dyshimta, në mungesë të një procedure prokurimi publik dhe pa asnjë tabelë informuese lidhur me autoritetin kontraktor, fondin limit, vlerën e kontratës, operatorin fitues, kohëzgjatjen e punime, kërkesa këto të domosdoshme për të qenë në përputhje me ligjin (**Prova Nr. 33 – Foto të rrugëve Haxhi Alija; Hamide Dalipi; Hajredin Fratari, Haki Glina**). Po ashtu, janë konstatuar në datën 16 Mars është konstatuar shtrimi me asfalt elektorale i rrugëve “Branko Kadia”, “Artitekt Sinani”, pa asnjë njoftim apo transparencë lidhur me kërkesat e sipërcituara. Ndërkohë, punimet për shtrimin e rrugës janë kryer edhe në rrugën

- “Hajdar Hidi”, njësia administrative Nr. 10, Tiranë (**Prova Nr. 34 – Foto të rrugëve Hajdar Hidi, Branko Kadia, Artitekt Sinani**).
57. Në datën 28 Mars, kryetari i Forumit Rinor të PD-së ka denoncuar publikisht se prej 2 javësh në rrugën “Mito Sotir Gurra”, në Unazën e Re, po hidhet asfalt elektoral dhe për këtë punimet kryhen natën. Lidhur me këto punime që po kryhen, nuk ka asnjë tabelë informuese për banorët, asnjë procedurë prokurimi publik apo kontratë publike (**Prova Nr. 35 – Denoncimi i Kreut të FRPD: Në Unazën e Re po hidhet asfalt elektoral, punimet bëhen natën. SPAK të hetojë**).
58. Nga informacionet e mbledhura në terren ka rezultuar se Arben Pëllumbi, kandidat për deputet i PS në Qarkun Tiranë, në zonën e depos së ujit afër liqenit të Farkës ka kryer disa takime me banorë të zonës, duke iu premtuar shtrimin e rrugëve në këmbim të votës. Këto punime kanë filluar të kryhen, pa asnjë procedurë prokurimi publik, pa asnjë transparencë apo njoftim (**Prova Nr. 36 – Foto të rrugës afër zonës së depos së ujit, Liqeni i Farkës**). Po ashtu, në rrugën “Danish Jukniu”, Sauk janë kryer punime për shtrimin e rrugës me qëllim të pastër elektoral (**Prova Nr. 37 – Foto të shtrimit të rrugës “Danish Jukniu”**).
59. Gjatë takimit elektoral të kandidatëve të Partisë Social Demokrate, me kryetar Tom Doshin, në fshatin Bulqesh, Bashkia Kamëz, është ngritur si problematikë mungesa e rrugës, ndërtimi i të cilës është premtuar të bëhet nga PSD. Menjëherë pas takimit ka filluar rikonstruksioni i rrugës, pa asnjë procedurë prokurimi public dhe pa asnjë transparencë mbi burimin e financimit (**Prova Nr. 38 – Video e fillimit të punimeve në Bulqesh, Kamëz**).
60. Në datën **15.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasit **Erion Veliaj**, në cilësinë e Bashkëdrejtuesit Politik të Partisë Socialiste në Qarkun Tiranë dhe Kryetarit të Bashkisë Tiranë, në bashkëpunim me shtetasin **Florian Pullazi**, në cilësinë e Kryetarit të Njësisë Administrative Nr. 2, Tiranë, të cilët me veprime konkrete kanë konsumuar veprat penale të **“Korrupsionit aktiv në zgjedhje”** parashikuar nga neni 328 dhe **“Korrupsionit pasiv në zgjedhje”** parashikuar nga neni 328 të Kodit Penal (**Prova Nr. 39 – Kallëzimi penal i Partisë Demokratike, datë 15.04.2021**).
61. Shtetasi **Erion Veliaj**, në cilësinë e Bashkëdrejtuesit Politik të Partisë Socialiste në Qarkun Tiranë dhe Kryetarit të Bashkisë Tiranë, po përdor në mënyrë të kundërligjshme, çdo mjet dhe pasuri publike në funksion të maksimizimit të votës për Partinë Socialiste. Në bashkëpunim me shtetasin **Florian Pullazi**, në cilësinë e Kryetarit të Njësisë Administrative Nr. 2, Tiranë,

- po kryejnë investime elektorale veçanërisht në Njësine Administrative nr. 2, Tiranë, pa transparencë, ku punimet kryhen vetëm natën, me burime financiare të dyshimta në mungesë të një tenderi publik dhe tabele të afishuar që të tregojë autoritetin kontraktor, vlerën e fondit limit, vlerën e kontratës, operatorin fitues si dhe kohëzgjatjen e kryerjes së punimeve siç ndodh në raste ku investimet janë në përputhje me ligjin.
62. I tillë është edhe investimi i kryer natën në **Rrugën “Ali Visha”**, një rrugë dhe zonë e cila nuk ka pasur **asnjë investim publik nga viti 2015**. Ky investim pa transparencë, ku punimet kryhen natën, me burime të pidentifikuara në një zonë ku nuk është investuar prej mbi 6 vitesh nga Bashkia Tiranë është vetëm në funksion të zgjedhjeve dhe maksimizimit të votës për Partinë Socialiste në Njësine Administrative nr. 2 në Tiranë. Foto bashkëlidhur tregon gjendjen e rrugës në mëngjesin e datës 14.04.2021, natën e së cilës është punuar për të ndërtuar për qëllime elektorale një nga rrugët më problematike të Njesisë Administrative nr. 2, për të cilën nuk u investua kurrë në 6 vjet (**Prova Nr. 40 – Foto nga investimi në rrugën “Ali Visha”**).
63. Në datën **18.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasit **Arben Ahmetaj**, me detyrë Ministër Shteti për Rindërtimin, **Edison Memolla**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë, **Anëtarët e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Rrogozhinë, Muharem Troka, Fatmir Haska dhe Shefit Thartori**, të cilët me veprime konkrete kanë konsumuar veprat penale të **“Shpërdorimit të detyrës”** parashikuar nga neni 248, **“Korrupsionit aktiv në zgjedhje”** parashikuar nga neni 328, **“Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”** parashikuar nga neni 328/a dhe **“Korrupsionit pasiv në zgjedhje”**, parashikuar nga neni 328/b të Kodit Penal (**Prova Nr. 41 – Kallëzimi penal i Partisë Demokratike, datë 18.04.2021**).
64. Pas tërmetit të datës 26.11.2019 Qeveria Shqiptare miratoi një sërë Ligjesh, Vendime të Këshillit të Ministrave dhe Vendime të Këshillave Bashkiake, të cilat lidhen me hartimin dhe zbatimin e masave për eliminimin e pasojave dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara e të shkatërruara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit, duke përcaktuar objektet që përfitojnë dhe masën e përfitimit. Duke shfrytëzuar fatkeqësinë natyrore, Qeveria dhe Bashkitë kanë krijuar një skemë kriminale të blerjes së votës dhe korrupsionit me fondet e rindërtimit nga tërmeti, në funksion të maksimizimit të paligjshëm të votave për Partinë Socialiste, në kundërshtim flagrant me Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të tij.

65. Në Bashkinë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, në mënyrë të organizuar po zbatohet një skemë kriminale e blerjes së votës dhe korrupsionit nëpërmjet fondeve dhe procesit të rindërtimit. Kjo bashki dhe rrethinat nuk janë goditur nga tërmeti i 26 nëntorit, por banesat e ndërtuara rreth viteve 1970 në zonën e Lekaj, Sinaballaj dhe Cikalleshit, kanë pësuar dëmtime të medha duke i nxjerë ato të pabanueshme. Këto zona janë në periferi të kodrave, në majë, ku nuk ka pasur kurrë infrastrukturë rrugore dhe ku për shkak të fatkeqsisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti janë bllokuar dhjetra familje.
66. Prej dy vitesh këto familje në mungesë të shtëpive, të cilat janë të pabanueshme për shkak të tërmetit, jetojnë në varfëri ekstreme, në çadra plasmasi dhe pa asnjë mbështetje nga qeveria apo bashkia. Skema kriminale e blerjes së votës në Rrogozhinë, fillon me përcaktimin e parë nga Bashkia të shtëpive të pretenduara si të dëmtuara nga tërmeti. Lista e parë përmban 1.700 banesa/familje të pretenduara si të dëmtuara, të cilat fillimisht janë llogaritur si DS1, DS2 dhe vetëm 20% e tyre si DS3. Pavarësisht këtij kategorizimi, në listën përfundimtare të gjitha këto banesa u kategorizuan në mënyrë kriminale si DS4 dhe DS5.
67. Në datën 12.04.2021, në një mbledhje me dyer të mbyllura dhe pa asnjë transparencë, **Këshilli Bashkiak i Bashkisë Rrogozhinë vendosi të përfshijë përveç 1.700 banesave/familjeve të para edhe 871 banesa/familje si përfituese nga fondet e rindërtimit.** Ky vendim përcakton listën me specifikime sipas metrave katrore të banesës, numurit të subjekteve përfituese dhe vlerën totale për secilën kategori, si më poshtë:
1. 57 banesa janë kategorizuar DS2 nën 100 m² dhe përfitojnë 200.000 lekë/banesë ose 11.400.000 lekë/total.
 2. 210 banesa janë kategorizuar DS2 mbi 100 m² dhe përfitojnë 250.000 lekë/banesë ose 52.500.000 lekë/total.
 3. 32 banesa janë kategorizuar DS3 nën 100 m² dhe përfitojnë 400.000 lekë/banesë ose 12.800.000 lekë/total.
 4. 572 banesa janë kategorizuar DS3 mbi 100 m² dhe përfitojnë 500.000 lekë/banesë ose 286.500.000 lekë/total.
68. Sipas këtij vendimi përfituese janë 871 banesa/familje të kategorizuara si DS2 dhe DS3, me një vlerë totale prej 362.700.000 lekë. Nga ana tjetër, nëpërmjet Vendimit nr. 20 datë 24.3.2021 *“Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grandit të rindërtimit për ndërtesat e cilesuara DS4 dhe DS5”*, bashkia ka akorduar grant edhe për 85 familje, të cilat nuk do të rindërtohen por vetë qytetarët do të kryejnë rindërtimin nëpërmjet granteve të përfituara nga shteti. Sipas këtij vendimi, për

- ato familje që kanë më tepër se 4 anëtarë, granti do të jetë 35 milionë lekë; për ato familje që kanë më tepër se 3 anëtarë, granti do të jetë 28 milionë lekë dhe për ato familje që kanë më tepër se 2 anëtarë, granti do të jetë 22 milionë lekë.
69. Përfitues të granteve janë gjithashtu banorë të Rrogozhinës, të cilët nuk janë prekur nga tërmeti, por kanë përfitur në kundërshtim me ligjin, madje disa prej të cilëve duke jetuar nëpër vila në qytet kanë përfitur grante për shtëpitë e dyta në fshat. Bazuar në listat me emrat e personave përfitues, është evident jo vetëm fakti që nuk përmbushin kriteret ligjore për përfitim, por mbi të gjitha që fondet e rindertimit janë përdorur për qëllime të pastra elektorale. Kjo pasi, përfitues janë pjesa dermuese e punonjësve të bashkisë, eksponentëve kryesore socialiste në Bashkinë e Rrogozhinës, si dhe personave të cilët pavarësisht se nuk përmbushin kriteret ligjore për përfitim ju janë akorduar grante nga Bashkia grante në këmbim të votës për Partinë Socialiste.
70. Konkretisht, shtëpia e shtetasit **Muharem Troka** nuk ka pasur asnjë dëmtim por ai ka përfitur 400.000 lekë pasi është baba i Administratores së Njesisë Gosë, Valmira Troka (**Prova Nr. 42 – Foto si përfitues Muharrem Troka dhe shtëpia e padëmtuar**). Shtetasi **Fatmir Haska** është Kryetar i seksionit Gosë Qender për Partinë Socialiste. Edhe në këtë rast shtëpia nuk ka pasur asnjë dëmtim por ka përfitur para pasi është pjesë e strukturave dhe votues i Partisë Socialiste (**Prova Nr. 43 – Foto si përfitues Fatmir Haska dhe shtëpia e padëmtuar**). Nëpërmjet Vendimit nr. 20 datë 24.3.2021 *“Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rindertimit për ndertesat e cilesuara DS4 dhe DS5”*, në listë si përfitues i 35 milionë lekëve është edhe punonjësi i bashkisë Rrogozhinë **Shefit Hajdar Thartori**, i cili pavarësisht se jeton në një vilë ka përfitur grant për një shtëpi të dytë në pronësi të tij, në kundërshtim me VKM e cila ndalon përfitimin e personave që kanë dy ose më shumë shtëpi (**Prova Nr. 44 – Foto si përfitues Shefit Thartori dhe shtëpia e padëmtuar**).
71. Në 2 Maj, në media u publikua një artikull, sipas të cilit vetëm një ditë përpara zgjedhjeve rruga “Spahiu” në Shkozë u shtrua me asfalt. Për këtë projekt nuk u krye asnjë procedurë paraprake prokurimi dhe nuk ka asnjë informacion mbi kompaninë që hodhi asfaltin apo koston e këtij projekti. Sipas informacioneve të marra në terren, ky projekt u sponsorizua tërësisht nga kandidati për deputet me Nr. 17 në listën e Tiranës, Alqi Bllako (**Prova Nr. 45 – Skandali: Asfalt pa prokurim në vigjilje të votës, dhe në shërbim të saj! SPAK ka një indicia të fortë**).

72. Përdorimi i burimeve shtetërore për fushatë evidentohet edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR. Konkretisht, Misioni shprehet se pavarësisht një kuadri ligjor solid që ndalon shpërdorimin e burimeve administrative dhe minimizon avantazhin e partisë në pushtet, ministrat vazhduan të bënin fushatë gjatë angazhimeve zyrtare. Publiciteti që erdhi si rrjedhojë e kësaj i dha partisë qeverisëse një avantazh të konsiderueshëm (shih fq. 2).
73. Ministrat vazhduan me angazhimet e tyre zyrtare gjatë gjithë fushatës. Ata u shfaqën rregullisht në “vizita inspektimesh” të objekteve kyce, si në qendrat e vaksinimit, me maska në fytyrë ose me bluza që lexonin “Nr. 12” (numri i PS-së në fletën e votimit), gjë që coi në publicitet të konsiderueshëm dhe që përbëri aktivitet për qëllime fushate. Edhe Kryeministri inauguroi disa projekte madhore infrastrukturore gjatë fushatës zgjedhore. Këto lloj aktiviteteve i dhanë një avantazh të konsiderueshëm PS-së, gjë që ishte përforcuar tashmë edhe më shumë nga dominimi i PS-së në administratën lokale. (shih fq. 12). Por, përdorimi i burimeve shtetërore nga ana e Partisë në pushtet, u ngrit si problem edhe në deklaratën e datës 07.05.2021 të Misionit të SHBA në OSBE.

B.3 Intimidimi dhe përdorimi i paligjshëm administratës shtetërore për të mbështetur PS:

74. Gjatë fushatës u konstatuan raste të shumta, të cilat janë denoncuar vazhdimisht nga Partia Demokratike se si të gjitha nivelet e administratës qendrore dhe vendore ishin përfshirë në fushatë, duke mbështetur publikisht kandidatët e PS-së. Drejtoritë vendore arsimore, drejtoritë vendore të bujqësisë, spitalet rajonale, shkollat e mesme, agjencitë vendore të kadastrës, administratat e policisë dhe burgjeve, gjendja civile etj., u kthyen gjatë fushatës zgjedhore në shtabe elektorale të PS-së.
75. Nëpunësit civilë ishin nën presion të vazhdueshëm për të mbështetur kandidatët socialistë, në të kundërt mund të shkarkoheshin nga detyra. Konkretisht, nëpunësve civilë iu kërkuar pjesëmarrje e detyruar në takime elektorale, dorëzimi i listës me votuesit në familjet e tyre, dhënia e kartave të identitetit dhe të dhënave të tjera personale, pëlqimi dhe shpërndarja e postimeve në rrjetet sociale, përfshirja në fushatën derë më derë, dhënia e përfitimeve të ndryshme për simpatizantët e Partisë Socialiste. Nëpunës, të niveleve të ulëta dhe të mesme, të Autoritetit Rrugor Shqiptar kanë denoncuar presionin e vazhdueshëm nga eprorët e tyre për të paraqitur një listë me 30 deri në 50 votues për Partinë Socialiste (emrat dhe kartat e identitetit) ose përndryshe do të përballeshin me masa disiplinore.

76. Në 27 shkurt, drejtoresha e Institutit Shëndetësor Shtetëror, Areti Bruka ka kërkuar nga të gjithë punonjësit të paraqiten në institucion, jo për punë, por për t'u komunikuar se brenda një jave kohë ata duhet të paraqesin listat me emrat e votuesve që do të votojnë PS-në. Emrat në listë do të takoheshin apo bisedonin më pas me anëtarë të shtabeve elektorale ose të deleguar të PS-së (**Prova Nr. 46 – Drejtoresha e ISSH-së kërcënon punonjësit**). Ndërkohë, e njëjta situatë ka ndodhur javën e fundit edhe në Kombinat, ku drejtoria arsimore iu ka kërkuar punonjësve të dalin në punë të shtunën, për t'u ngarkuar detyrat që do të kryenin në favor të PS-së gjatë zgjedhjeve.
77. Gjatë fushatës elektorale, është konstatuar se Kol Hyseni, prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është angazhuar në mbledhjen e votave për Partinë Socialiste. Hyseni ka në pronësi të tij një lokal në pjesën përballë Prokurorisë së Tiranës. Në këtë lokal, nën shoqërinë e drejtorit të OSHEE Tiranë, Klevis Jahaj, prokurori Hyseni kryen takime të shumta me njerëz që kanë pasur të bëjnë me të për shkak të detyrës, duke iu kërkuar votën qoftën edhe nëpërmjet pagesës në dorë. Konkretisht, në këto takime është kërkuara: (i) karta ID/pasaporta për shtetasit që dihet se janë me bindje të djathta përkundrejt pagesës 200 Euro; ose (ii) shtetas, që votojnë PS, të filmojnë votën, përkundrejt pagesës 200/300 Euro. Pagesat janë premtuar se do të kryhen menjëherë nga Klevis Jahaj, drejtor i OSHEE Tiranë. Në 19 prill, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi shkarkimin e prokurorit Hyseni për shkak se nuk justifikonte pasurinë dhe lidhjeve me elementë të botës së krimit (**Prova Nr. 47 – KPK shkarkon nga detyra prokurorin Kol Hysenaj**).
78. Bledar Doracaj, drejtor i përgjithshëm i Gjendjes Civile, pjesë e drejtuesve të nivelit të lartë të administratës, nëpunës civilë, është përfshirë në fushatë duke përdorur funksionin e tij për të sulmuar kryetarin e Partisë Demokratike, por edhe duke bërë thirrje të drejtpërdrejtë në rrjetet e tij sociale për të votuar PS-në (**Prova Nr. 48 – Lista e zgjedhësve, Bledar Doracaj i bën thirrje kryedemokratit: Rinovo kartën e identitetit, ka dy vite që të ka skaduar**).
79. Në 16 Mars, Etleva Balla, drejtore në Poliklinikën e Specialiteteve Nr. 1, Tiranë, ka ushtruar presion ndaj stafit të saj duke kërkuar vota për kandidaten e Partisë Socialiste, Ogerta Manastirliu, njëkohësisht Ministër i Shëndetësisë. Sipas informacione të marra nga strukturat e PD-së, znj. Lela Bucpapa, e cila punon si laborante në këtë poliklinikë dhe është thirrur nga drejtoresha e saj, duke i kërkuar me insistim të votojë PS dhe kandidaten Manastirliu. Pas refuzimit nga ana e znj. Bucpapa, ndaj saj kanë filluar presionet për vendin e punës.

80. Në 23 mars, kandidatja për deputete e PS, Dallëndyshe Bici, me Nr. 22 në listën e Qarkut Tiranë, ka mbledhur me urdhër të gjithë drejtorët e shkollave, ndër të cilët Abaz Hoxha, drejtor i shkollës së mesme “Gramoz Palushi”, në njësinë administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz. Drejtorëve iu është kërkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të angazhohen në fushatë dhe të mbledhin sa më shumë vota për Partinë Socialiste (**Prova Nr. 49 – Dallëndyshe Bici mbledh drejtorët e shkollave në Paskuqan**).
81. Në 31 mars, kryetari i FRPD-së, Belind Këllici ka denoncuar Fatmir Cibakun, drejtor i Ndërmarrjes Shtetërore të Transportit “Misto Mame”, i cili është angazhuar në shpërndarjen e ndihmave ushqimore dhe mbledhjen e kartave të identitetit në zonën e ish-zjarrëfikësve, pas shkollës “Musine Kokalari”. Fatmir Cibaku, pavarësisht ndalimit për të marrë pjesë në aktivitete politike gjatë orarit zyrtar të punës, është parë shpesh në zyrat elektorale të PS-së gjatë paraditeve (**Prova Nr. 50 – Denoncimi/Fatmir Cibaku, drejtori i Ndërmarrjes Shtetërore të Transportit “Misto Mame” shpërndan ndihma dhe mbledh karta identiteti për vota**).
82. Në 9 Prill, Rozafat Sopaj, drejtor i Banesave Sociale pranë Bashkisë Tiranë, ka publikuar një foto në rrjetet e tij sociale, duke bërë fushatë për kandidatin me Nr. 17 në listën e Qarkut Tiranë, Alqi Bllako. Foto është rerealizuar nga zyra e tij në institucionin që ai drejton. Fushata e zhvilluar në institucione është rreptësisht e ndaluara nga neni 6 i Vendimit Nr. 9/2020 të KQZ-së (**Prova Nr. 51 – Foto Rozafat Sopaj në zyrën e tij, drejtor i banesave sociale Tiranë**).
83. Erfan Shkëmbi, përgjegjës sektori në Drejtorinë e Administrimit të Njësisë Administrative në Bashkinë e Tiranës, është angazhuar në orarin zyrtar gjatë gjithë fushatës për kandidatin për deputet të PS, Plarent Ndreca me Nr. 20 në listën e Qarkut Tiranë, duke shkelur haptazi nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 6 të Vendimit Nr. 9/2020 të KQZ-së që ndalojnë rreptësisht angazhimin e punonjësve të administratës publike në fushatë zgjedhore gjatë orarit zyrtar.
84. Lorena Alla dhe Adelajda Sorra, punonjëse të burimeve njerëzore në Drejtorinë Rajonale të OSHEE Tiranë, përballë dispancerisë, thërrasin punonjësit dhe u bëjnë presion të vazhdueshëm për t’u angazhuar në fushatën e Partisë Socialiste. Ky informacion ka ardhur nga punonjës, të cilët janë kontaktuar dhe kërcënuar nga këto dy punonjëse.
85. Në 16 Prill, strukturat lokale të PD-së kanë denoncuar me pamje filmike përfshirjen në orarin zyrtar të punës administratën e Bashkisë Tiranë, e cila po bënte fushatë derë më derë për Partinë Socialiste dhe kandidaten e saj. Ndërkohë, punonjësve të Bashkisë Tiranë, të cilët janë

- evidentuar nga patronazhistët si të djathtë ose mbështetës të PD-së, u është dhënë urdhër i prerë që të mos dalin të votojnë, përndryshe do të pushohen nga puna.
86. Portali “JOQ Albania” ka publikuar denoncimin e një polici bashkie, i cili informon se drejtori i Policisë Bashkiake Tiranë, Ermal Kapllani, i përfshirë në listën e zezë për korrupsion nga vetë kryeministri Edi Rama (**Prova Nr. 52 – Ermal Kapllani, drejtor i akuzuar për korrupsion në listën e zezë të Ramës**), iu ka kërkuar të gjithë inspektorëve të sjellin një listë me karta e ID së familjarëve të tyre, përndryshe do t’i pushonin nga puna. Punonjësi i policisë shpjegon më tej se drejtuesit e policisë bashkiake iu kërkojnë nga 1.000 Euro për të mbajtur vendin e punës (**Prova Nr. 53 – Foto e publikuar nga “JOQ Albania”**).
87. Ndërkohë, raste të shumta janë konstatuar të përdorimit të aseteve shtetërore ose administratës shtetërore në funksion të fushatës së PS-së. Konkretisht:
- (i) Pranë zyrave elektorale të PS-së, shpeshherë u konstatuan makina, që i përkisnin institucioneve shtetërore. Bashkëlidhur do të gjeni rastin e një makine të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave pranë një zyre elektorale të PS në Njësinë Nr. 8, Tiranë (**Prova Nr. 54 – Makinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave pranë zyrës elektorale të PS Tiranë**);
 - (ii) Punonjësit e Policisë Bashkiake Tiranë, vecanërisht ata që mbulojnë zonën e Dajtit, u detyruan të shpërndajnë në rrjete sociale materiale propagandistike në mbështetje të kandidat për deputet të PS me Nr. 14 në Qarkun Tiranë. Ky fakt provohet pasi të gjithë këta punonjës shpërndanë në rrjetet e tyre të njëjtin poster me përmbajtje “Numër 14 Xhemal Qefalia” (**Prova Nr. 55 – Policët bashkiakë shpërndajnë posterin e kandidatit të PS për deputet Xhemal Qefalia**);
 - (iii) Pranë Bashkisë Rrogozhinë u punësuan disa militantë të PS-së nga qytete të ndryshme, të cilët për shkak të angazhimit të tyre në fushatë elektorale, nuk u paraqitën asnjë ditë në punë. Konkretisht, punonjësit janë: Elidon Bega, me detyrë këshilltar i kryetarit (nga Berati); Lulëzim Haliti, punonjës i Ujësjellësit, bashkëshorti i hallës së kryetarit të Bashkisë (nga Lushnja); Romina Bega, punonjëse e Bashkisë (nga Elbasani) dhe Erald Abazi, punonjës i Bashkisë (nga Lushnja);
 - (iv) Në 18 Mars, shefi i emergjencave civile në Bashkinë Rrogozhinë, Rakip Tosku, duke përdorur automjetin e institucionit, ka shpërndarë ndihma ushqimore, batanie dhe veshje në lagjen Nr. 1 të Rrogozhinës, në këmbim të votës për Partinë Socialiste (**Prova 56 – Shefi i Emergjencave Rrogozhinë shpërndan ndihma ushqimore**).

88. Pranë Partisë Demokratike, ka mbërritur një denoncim nga Znj. Luiza Bakllava, e cila ankohet kundër administratës së Bashkisë Tiranë për djalin e saj Erald Bakllava, i cili pasi është evidentuar nga patronazhistët si votues i PD-së, është kërcënuar se do ta largonin nga puna nëse shkon të votojë.
89. Presionet ndaj nëpunësve publikë dhe detyrimi i tyre për t'u angazhuar në fushatë u evidentuan edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR. Konkretisht, Misioni shprehet se ofrimi i stimujve dhe presioni i pretenduar ndaj nëpunësve civilë përbën problem (shih fq. 2). MKVZ-ja e ODIHR-it mori edhe raportime për përpjekje të bëra për ndikim të votës përmes ofrimit të stimujve. Këtu futet edhe lëshimi i lejeve për legalizim. Në këto raporte pretendohet, gjithashtu, se shumë nëpunës civilë, një grup i punësuar që është vulnerabël ndaj presioneve, janë inkurajuar të votojnë për partinë qeverisëse (shih fq. 3);

B.4 Punësime të reja në administratën publike, si shkelje e rëndë e ligjit për përfitim politik duke devijuar vullnetin:

90. Nga viti 2017 e në vijim, Qeveria ka nxjerrë 28 vendime duke shtuar numrin e punësimeve në strukturat e qeverisjes qendrore me 16 645 pozicione të reja. Përveç kësaj punësimi në sektorin publik u rrit ndjeshëm në periudhën parazgjedhore, saktësisht në kohën para moratoriumit ndaj autorizimit të punësimeve të reja në administratën publike. Sipas INSTAT, midis tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020, punësimi në sektorin publik është rritur me 6 për qind ose me 10.572 persona (**Prova Nr. 57 – Raporti i INSTAT**). Më 24 Dhjetor, qeveria me VKM Nr. 1151 autorizoi edhe 2.472 pozicione të tjera. (shih fq. 12 të Raportit Paraprak të OSBE/ODIHR) (**Prova Nr. 58 – Vendimi Nr. 1151/2020 i Këshillit të Ministrave**).
91. Në dhjetor 2020, në Bashkinë Kamëz janë shtuar 451 të punësuar në administratë, ndërsa në mars 2021 administratës i janë shtuar edhe 552 punonjës të tjerë, duke e cuar numrin total në 1.003 të punësuar rishtazi. Nga të dhënat zyrtare të kontribueve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat, rezulton se në 4 muajt e fundit, administratës së Bashkisë i janë shtuar 101 persona (**Prova Nr. 59 – Rritja e numrit të punonjësve në Bashkinë Kamëz**).
92. Sipas një denoncimi të mbërritur pranë Partisë Demokratike, znj. Belinda Balluku, me detyrë Ministër i Energjisë dhe Infrastrukturës, ka ndërhyrë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivës për punësimin e rreth 150 punonjësve. Saktësia e këtij informacioni do të dalë nga marrja e provës gjatë hetimit administrativ për numrin e punonjësve me kontrata të plota/të

përkohshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivës nga data 01.01.2020 – 30.04.2021, megjithatë është e qartë se punësimi administrativ në administratë u përdor për qëllim të qartë elektoral, në kundërshtim të plotë me përcaktimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe neni 3 të Vendimit Nr. 9/2020 të KQZ-së.

93. Në 18 Prill, kandidatja për deputete e PS, Ogerta Manastirliu, njëkohësisht Ministër i Shëndetësisë, nëpërmjet email-it personal ka kërkuar nga strukturat e PS-së që të vijjnë propozime për vendet vakante në institucionet publike, si dhe arsimin përkatës për çdo pozicion. Këto emërimë do të kryheshin para datës 25 prill 2021. Konkretisht:
- (i) Në NJVKSH Tiranë duhet një specialist auditi që të ketë mbaruar ekonomik; si dhe një recepsionit në Poliklinikën Paskuqan, me arsim të mesëm;
 - (ii) Në Maternitetin e Ri kërkohet magazinier me arsim të mesëm;
 - (iii) Në DRF Tiranë nevojitet një informaticien ose inxhinier elektronik me kontratë 1-vjecare;
 - (iv) Në Maternitetin e Vjetër duhet një sanitare me arsim të mesëm;
 - (v) Në ISSH kërkohen tre inspektorë provizorë (sipas profilit shëndet publik, ekonomik dhe juridik) (**Prova Nr. 60 – Foto nga email-i i Ogerta Manastirliu**).
94. Në datën **19.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasit **Edison Memolla**, Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë, **Elidon Bega**, Këshilltar i Kryetarit të Bashkisë, **Lulëzim Halit**, punonjës i Bashkisë Rrogozhinë, **Romina Bega**, punonjës i Bashkisë Rrogozhinë dhe **Erald Abazi**, punonjës i Bashkisë Rrogozhinë, të cilët me veprime konkrete kanë konsumuar veprat penale të “**Shpërdorimit të detyrës**” parashikuar nga neni 248, “**Korrupsionit aktiv në zgjedhje**” parashikuar nga neni 328, “**Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore**” parashikuar nga neni 328/a dhe “**Korrupsionit pasiv në zgjedhje**” parashikuar nga neni 328/b të Kodit Penal (**Prova Nr. 61 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 19.04.2021**).
95. Punësimet elektorale në administratën qendrore dhe vendore si dhe blerja e votës nëpërmjet vendeve të punës, janë një nga mënyrat dhe mjetet e përdorura masivisht nga qeveria në zgjedhje, në funksion të maksimizimit të paligjeshëm të votës për Partinë Socialiste. Në vitin 2020, Administrata e Bashkisë Rrogozhinë ka pasur në strukturën e saj **90 të punësuar**, të cilët në muajin shkurt të vitit 2021 sipas listëpagesave zyrtare llogariten në **317 të punësuar**. Brenda

një kohe shumë të shkurtër dhe në funksion të blerjes së votës janë shtuar **227 të punësuar** në aparatën e Bashkisë Rrogozhinë.

96. Nëpërmjet veprimeve të tilla shtetasi **Edison Memolla**, Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë ka konsumuar elementët e veprave penale të **Shpërdorimit të detyrës**" parashikuar nga neni 248, **"Korrupsioni aktiv në zgjedhje"** parashikuar nga neni 328 dhe **"Korrupsionit pasiv në zgjedhje"** parashikuar nga neni 328/b të Kodit Penal. Nga listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat për punësim për muajin shkurt në Bashkinë Rrogozhinë, përveç shtimit të jashtëzakonshëm të punonjësve në këmbim të votës, figurojnë si të punësuar edhe persona të cilët nuk janë paraqitur asnjë ditë në punë por që paguhën nga paratë publike.

97. Raste të tilla, janë punësimi i shtetasve të mëposhtëm, të cilën të vetmen meritë kanë atë të angazhimit në fushatë për Partinë Socialiste:

Elidon Bega, me pozicion Këshilltar i Kryetarit të Bashkisë, është nga Berati dhe nuk paraqitet asnjëherë në punë pasi është i angazhuar në fushatë për Partinë Socialiste.

Lulëzim Haliti është nga Lushnja gjithashtu burri i halles së Kryetarit të Bashkisë dhe merr rrogë tek ujësjellësi pa u paraqitur asnjëherë në punë.

Romina Bega dhe **Erald Abazi** nga qarku i Elbasanit përfitojnë rrogë nga Bashkia Rrogozhinë megjithëse nuk janë banues në Rrogozhinë dhe nuk janë paraqitur asnjë ditë në punë.

Në cilësinë e provës, bashkëlidhur këtij ankimi gjeni listëpagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat për punësim, për muajin shkurt të Bashkisë Rrogozhinë.

98. Në datën **19.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasit **Erion Veliaj**, Kryetar i Bashkisë Tiranë, **Ogerta Manastirliu**, Ministre e Shëndetësisë, Herion Rrapaj, Drejtor i DPN 2, **Bashkia Tiranë** dhe **Drejtuesit e Institucioneve Publike që kanë bërë rekrutimin e personave në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, dhe me Aktet Ligjore**, i cili me veprime konkrete kanë konsumuar veprat penale **"Shpërdorimit të detyrës"** parashikuar nga neni 248, **"Korrupsioni aktiv në zgjedhje"** parashikuar nga neni 328 dhe **"Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore"** parashikuar nga neni 328/a të Kodit Penal (**Prova Nr. 62 - Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 19.04.2021**).

99. Drejtori i Përgjithshëm i Rrugëve dhe i Ndrëçimit, Herion Rrapaj, ju ka dërguar informacion shtabeve të partisë për vende pune që duhen mbushur me njerëz të partisë. Punësimi elektoral është urgjent dhe vartësi i Erion Veliajt në Bashki, u kërkon shtabeve elektorale të Tiranës që të dorëzojnë propozimet e tyre deri ditën e diel, 1 javë para zgjedhjeve. Çdo gjë të këtij shteti që ne e mbajmë në këmbë me taksat tona, Edi Rama dhe Erion Veliaj e kanë vënë në shërbim të pushtetit të tyre. Ata shesin për 1 votë edhe vendin e sanitaresh tek materniteti i vjetër. Hapin vende të përkohshme pune për të gënjyer njerëzit që të votojnë për ta. Janë vende pune si specialist audi, receptionist në poliklinikë, magazinier tek materniteti, inxhinier elektronik, sanitaresh tek materniteti, inspektor tek Instituti i Shëndetit.
100. Pra vende pune që në shëndetësi, që paguhet nga taksat tona që përqëndrohen te shtabet elektorale të Ogertës dhe tek Erion Veliaj si drejtues i fushatës së Edi Ramës në Tiranë. Është vërtetuar që për t'u favorizuar kandidatja Manastirliu, janë përdorur drejtorët dhe përgjegjësit e institucioneve shtetërore duke punësuar njerëz dhe duke rekrutuar persona me qëllim të qartë dhe të pastër elektoral. Këto veprime janë tërësisht të paligjshme dhe në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor si dhe të Vendimi i Komisionit Rregullator nr.9 datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve".
101. Bazuar në të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financave për periudhën janar – prill 2014, nga buxheti i shtetit janë paguar për "paga bazë" **40 milionë euro**, ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit 2021 janë paguar **224 milionë euro** pra **184 milionë euro më shumë**. Kjo vlerë, bazuar në të dhënat zyrtare të Tatimeve është edhe më e lartë nëse në analizë marim edhe 244 institucione të organizuar si shoqëri tregëtare ku shteti është aksionar. Sipas Ministrisë së Financave, për periudhën janar – prill 2021 janë paguar 20 milionë euro më shumë për paga krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020. Bazuar në të dhënat e Tatimeve shpenzimet për paga duke përfshirë edhe 244 institucione shtetërore të organizuara si shoqëri tregëtare, shpenzimet për paga nga shteti shqiptar llogariten në **63 milionë euro**. Me qëllim ndikimi në shtresat vulnerabël, bazuar në të dhënat e zyrtare të Ministrisë së Financave, qeveria ka paguar për ndihmën ekonomike për familjet në nevojë **313,763,706 lekë** më shumë për periudhën janar – prill 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020. Po në të njëjtën periudhë, nga

të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financave, qeveria ka shpërndarë për **6.182 persona** për “paga lufte” një vlerë prej **247,282,296 lekë**.

B.5 Dhënia e lejeve të legalizimit/ndërtimit gjatë fushatës zgjedhore (3 prova):

102. Deputetë të ndryshëm të Partisë Socialiste shpërndanë leje legalizimi në kundërshtim me përcaktimin e Kodit Zgjedhor dhe Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së. Në 30 dhjetor 2020, kandidati për deputet i PS-së dhe drejtuesi politik për Njësinë 10, Tiranë, Fatmir Xhafaj u shfaq në një takim publik, me mbështetës dhe simpatizantë të PS-së, duke shpërndarë leje legalizimi (**Prova Nr. 63 – Fatmir Xhafaj shpërndan leje legalizimi**). Është e qartë se shpërndarja e lejeve të legalizimit nga ana një kandidati për deputet (deputet në detyrë), i cili nuk e ka aspak për funksion kryerjen e kësaj veprimtarie, bëhet me qëllim të pastër elektoral për të fituar mbështetje në votat nga familjet apo personat që përfitonin lejet në fjalë.
103. Në 27 shkurt, shoqëruesit e Ministres së Drejtësisë, Etilda Gjonaj, duke përdorur makinën zyrtare të Ministrisë, shpërndanë 12 leje legalizimi në Njësinë Administrative Nr. 7, Tiranë. Kjo njësi ishte zona që mbulonte Ministria Gjonaj, si kandidate për deputete të PS me Nr. 7 në listën e Qarkut Tiranë (**Prova Nr. 64 – Shoqëruesit e Etilda Gjonaj shpërndajnë leje legalizimi**).
104. Në datën **07.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasin **Dritan Stroka**, punonjës i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të cilët me veprime konkrete kanë konsumuar veprat penale të **“Korrupsionit aktiv në zgjedhje”** parashikuar nga neni 328 dhe **“Korrupsionit pasiv në zgjedhje”** parashikuar nga neni 328 të Kodit Penal (**Prova Nr. 65 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 07.04.2021**).
105. Shtetasi **Dritan Stroka**, me detyrë punonjës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, është organizator i një skeme kriminale të blerjes së votës në favor të Partisë Socialiste në Sauk nëpërmjet premtimit dhe shpërndarjes së legalizimeve në këmbim të votës. Në shpërdorim të detyrës dhe funksionit pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, ai premtonte dhe shpërndanë çertifikata legalizimi në këmbim të votës së Partisë Socialiste, në zonën e Saukut të Sipërm, Saukut të Poshtëm dhe Senatoriumit. Nga ana tjetër, pavarësisht detyrës dhe funksionit

- pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, ky shtetas punon aktivisht gjatë orarit të punës në fushatë për Partinë Socialiste në zonën e Saukut.
106. Në datën **08.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar – SPAK, shtetasit **Erion Veliaj**, Kryetar i Bashkisë Tiranë, **Ogerta Manastirliu**, Ministre e Shendetësisë, **Ulsi Manja**, Deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, **Artan Lame**, Drejtor i Përgjithshëm i ASHK-së, **Taulant Tusha**, Drejtor në Bashkinë e Tiranës, **Bledar Doracaj**, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe **Arlind Gjokutaj**, të cilët me veprime konkrete kanë konsumuar veprat penale të **“Shpërdorimit të detyrës”** parashikuar nga neni 248, **“Korrupsioni aktiv në zgjedhje”** parashikuar nga neni 328, **“Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”** parashikuar nga neni 328/a, **“Përhapjes së sekreteve vetjake”** parashikuar nga neni 122 dhe **“Grupit të strukturuar kriminal”** parashikuar nga neni 333/a të Kodit Penal (**Prova Nr. 66 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 08.04.2021**).
 107. Shtetasit e mësipërm kanë krijuar një skemë kriminale të blerjes së votës nëpërmjet shkeljes së ligjit si më poshtë: Është vërtetuar që kandidatja Manastirliu ka premtuar dhe ka pajisur me Leje Legalizimi disa banesa pranë xhamisë dhe në disa lagje të tjera, në mënyrë të menjëhershme në Njesi Administrative Nr. 9 fotot e të cilave po i bashkalidhim këtij kallëzimi. Sipas denoncimeve të banorëve të lagjes, këto leje jo vetëm janë selektive, por edhe janë premtuar dhe dhënë në këmbim të kërkesës së Kandidates Manastirliu, kundrejt votave. (Kronikat). Në zonën e Bregut të Lumit, në fund të Bulevardit të Ri, Ministria Manastirliu ka urdhëruar bërjen e matjeve të shtëpive, në këmbim të marrjes së votave. Kjo është denoncuar edhe nga banorë të zonës të cilët denoncuan edhe legalizimet selektive për qëllime të pastra elektorale. (Kronikat).
 108. I kallëzuar Ulsi Manja, në të njëjtën mënyrë ka premtuar dhe ka pajisur personalisht me Leje Legalizimi banesa në mënyrë të menjëhershme në Njesi Administrative Nr.11 fotot e të cilave, postuar nga vetë kandidati, po i bashkalidhim këtij kallëzimi. Sipas denoncimeve të banorëve të lagjes, këto leje jo vetëm janë selektive, por edhe janë premtuar dhe dhënë në këmbim të kërkesës së Kandidatit, kundrejt votave. (Foto). Ky veprim i kryer nga ana e ASHK Tiranë që ka marrë urdhëra dhe është vënë në shërbim total të fushatës së PS duke shkelur detyrën duke konsumuar elementët e veprës penale të përmendura më sipër. Këto veprime të kryera më vetëdije dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore është bërë me dashje dhe në bashkëpunim me të kallëzuarit.

109. I kallëzuari Artan Lame ka kryer elementet e veprave penale të sipërmendura pasi në urdhëra verbal dhe me orientime nga ana e tij si drejtues ka vënë në funksion të premtimeve elektorale dhe me qëllim drejtimin e dhe orientimin e votës me anë të favoreve administrative ka vënë në dispozicion institucionin që ai drejton për të legalizuar banesa duke tejkaluar procedurën normale vetëm pasi kandidatja e PS i premtojë qytetarëve për legalizim në shkëmbim të votave.
110. Fakt tjetër që dëshirojmë të përmendim ka të bëjë me shpërdorimin e fondeve të tërmetit dhe përdorimin e tyre për të shpërblyer militantëve dhe njërëzve afërt partisë socialiste. Nga ana juaj mund të provohet fare qartësisht dhe shumë lehtësisht që këto fonde po i jepen funksionarëve të partisë socialiste dhe pse banesat e tyre nuk kanë asnjë dëmtim apo kanë në një masë shumë të vogël. Vlen të përmendim që këto vlera financiare jepen vetëm me bekimin e kandidatëve të zonës në Njësinë Administrative Nr.9 dhe 11. Nga ana e strukturave të Partisë Demokratike janë evidentuar abuzime me fondet publike ku kanë përfituar personat e poshtëshënuar të cilët realisht nuk kanë pasur dëmtime strukturore. Më konkretisht nga ne janë identifikuar në Njësinë Administrative personat:
1. Eshref Disha, babai i kryetarit të PS-së Laprakë
 2. Syle Gosturani, pjesë e strukturës së PS, qendra e votimit 2029
 3. Mimoza Pëllumbi, e punësuar te Reparti i Inspektim Shpetim Miniera, drejton organizatën e PS për qendrat e votimit 2007 dhe 2008
 4. Dali Totraku, pjesë e strukturës së PS qendra e votimit 2009
 5. Besnik Cjapi, pjesë e strukturës së PS
 6. Arze Zejneli, punonjës në Bashkia Tiranë
 7. Kujtim Mema, punonjës në Bashkia Tiranë
 8. Besim Mamo, punonjës në Bashkia Tiranë
111. Fakt tjetër që kërkojmë të përmendim është dhe vënia në dispozicion e të gjithë strukturës dhe financave të Bashkisë së Tiranës në funksion të fushatës elektorale. Siç e dini kryetari i Bashkisë Tiranë, Erjon Velia, është dhe Drejtuesi Politik i PS për Qarkun Tiranë dhe në funksion të kësaj detyre në mbështetje të kandidatëve të PS të kallëzuar prej nesh ka konsumuar elementet e veprave penale të sipërcituara. Nga ana e të kallëzuarit Erion Veliaj, në tejkalim të kompetencave dhe të detyrave, kanë shpërdoruar fondet publike vetëm me qëllime elektorale që favorizojnë kandidatët e kallëzuar nga ana jonë. Më konkretisht po ju referojmë disa nga rrugët që janë shtruar pa asnjë projekt, pa asnjë procedurë tenderimi:

Rruga “Andrea Themeli”

Rruga “Allaman Dervishi”

Rruga e Shinave në Njësinë Nr.11

Rruga “Demir Progni”

Rruga Agim Hysenbelliu në Njësinë Nr. 11

Rruga “Jezerca” në Njësinë 11

Rruga “Allaman Dervishi” në Njësinë 11

Rruga “Bektash Kozeli” në Njësinë 11

Rruga “Mustafa Cakulli” në Njësinë 11

Rruga “Nuri Kello” në Njësinë 11

112. Kryerja e këture punimeve në kohë fushate dhe pa asnjë projekt të miratuar apo po kryer procedurat ligjore është në shkellje të gjithë dispozitave ligjore të planifikimin urban dhe për qeverisjen vendore. Kryerja e këtyre punimeve pa leje ndërtimi është kryer me qëllim vetëm për përfitime elektorale nga ana e PS dhe me qëllimin që kjo e fundit të përfitojë nga ana elektorale. Për këta persona nuk ka asnjë rëndësi shpërdorimi i fondeve publike dhe keqadministrimi i tyre por vetëm përfitimi elektoral i Partisë Socialiste. Gjithashtu, pranë Partisë Demokratike ka pasur denoncime nga persona që punojnë në administratën publike apo familjarë të tyre të cilët telefonohen apo takohen personalisht për t’i kërcënuar me vendin e punës nëse votën nuk e jepnin për PS. Shumë qytetarë e biznese të njësive administrative nr 9 telefonohen cdo ditë duke u shantazhuar nga stafi i shtabit politik të ministres Manastirlliu.
113. Sipër KMY në zonën e Nj. Administrative nr 11 është hapur një zyrë e pa branduar e Kandidatit Ulsi Manja, e cila drejtohet nga Taulant Tusha, zyrtar i lartë i bashkisë Tiranë. Në këtë zyrë thirren punonjës të administratës publike në varësi të bashkisë dhe institucioneve shtetërore, duke u kërcënuar me vendin e punës nëse nuk deklaronin votën e tyre e të familjarëve të tyre për PS. (foto e zyrës nga jashtë). Gjithashtu, Drejtoresha dhe punonjës të Drejtorisë së Cerdheve dhe Kopshteve, në varësi e me urdhër të Erjon Veliajt, ushtrojnë prëson ndaj edukatoreve dhe sanitarëve apo punonjësve të tjerë për të deklaruar votën kundrejt mbajtjes së vendit të punës. Drejtori i Postes Shqiptare dhe drejtues të tjerë të këtij institucioni, janë përfshirë në një krim elektoral duke kërkuar karta identiteti e duke kërcënuar për vendin e punës të punonjësve që kanë banim në Tiranë përfshirë edhe Nj. 9 dhe 11 sipas denoncimeve që disa punonjës kanë bërë.
114. Fakt tjetër që kërkojmë të përmendim është dhe shfaqia në listat e zgjedhëzve të shtetasve që janë transferuar në mënyrë të paligjshme në Njësinë Administrative 11 pa pasur dokumentacion

të saktë dhe ligjor. Është interesante fakti që shume prej këtyre banorëve kanë të njëjtin Kodë banese që më saktësisht është ai 090 dhe që kjo e fundit i përket çuditërisht një anëtare të Partisë Demokratike dhe e cila nuk ka ansnje dijeni që këta shtetas të banojnë në shtëpinë e tyre. Shtimi fiktiv i banorëve në lista të zgjedhësve me qëllim për të votuar kandidatët e kallëzuar prej nesh përben shkeljen e dispozitave ligjore të drejtuesit të Gjëndjes Civile pasi ka lejuar kryerjen e veprave penale.

115. Në 20 prill, u publikua një audiopërgjim i drejtorit të përgjithshëm të Kadastrës, Artan Lame, gjatë një takimi me vartësit e tij, ky i fundit u kërkon që mos procedojnë më tej me rreth 100.000 kërkesa për leje legalizimi të banesave private, të cilat me siguri do të refuzohen duke sjellë prishjen e tyre. Kjo pasi, refuzimi i dhënies së lejeve të legalizimit do të sillte që këta persona të votonin për opozitën. Në të kundërt, drejtori Lame kërkon që të përshpejtohet procedura për rreth 60.000 kërkesa për leje legalizimi, të cilat kanë mundësi të mëdha për t'u miratuar, në mënyrë që kjo të përkthehet në mbështetje për Partinë Socialiste (**Prova Nr. 67 – Audiopërgjimi i Drejtorit të përgjithshëm Artan Lame**). Lëshimi i lejeve për legalizim në këmbim të votave në favor të PS-së u evidentua edhe në Raportin e OSBE/ODIHR (shih fq. 13).
116. Në datën 21 prill, vetëm katër ditë para zgjedhjeve, kryetari i Forumit Rinor të PD-së, së bashku me strukturat, kanë publikuar pamje filmike nga një makinë e ndaluar në Vaqarr, e cila i përkiste djalit të xhaxhit të Administratorit të Njesisë administrative Vaqarr, Gentjan Myrto. Në makinën me targa AA043EC, janë gjetur krahas pakove me ushqime, certifikata, vërtetime banese, deklarata për përfshirje në procedura legalizimi dhe lista zgjedhësish. Qartazi, shpërndarja e ushqimeve, por edhe e lejeve të legalizimit, certifikatave të pronësisë etj., po bëhet me qëllim marrjen e votave në favor të PS-së (**Prova Nr. 68 – Këllici hap “pakon e iftarit” që kapi në Vaqarr, gjen legalizimet e PS për vota**).

B.6 Kërcënimi i votuesve për mbylljen e bizneseve të tyre nëpërmjet inspektimeve të paligjshme dhe dhunë ndaj votuesve:

117. Z. Arben Sinani, pas një eksperiencë të gjatë në sektorin e arsimit, themeloi dhe drejton shkollën private “Dituria”, licensuar nga Ministria e Arsimit në vitin 1999 (22 vite eksperiencë). Ai është një mbështetës i Partisë Demokratike, i cili shpesh ka shërbyer si kryetar i KZAZ-së Nr. 32, Tiranë pranë Shkollës Artistike “Jordan Misja” (**Prova Nr. 69 – Kryetar i KZAZ-së**

- Nr. 32, Tiranë**). Në datën 4 shkurt 2021, tre inspektorë të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Tiranë kryen një inspektim; sipas ligjit dhe rregulloreve përfundimet e këtij inspektimi duhet të ishin vënë në dispozicion në datën 5 Shkurt. Megjithatë, akoma sot nuk ka asnjë njoftim zyrtar lidhur me përfundimet e inspektimit. Fatmir Basha, vëllai i Znj. Linda Basha (bashkëshortes së kryeministrit Rama), fqinj dhe njohje e vjetër e Z. Sinani, i tha këtij të fundit që duhet të hiqte dorë nga cdo aktivitet në mbështetje të PD-së, në të kundërt shkolla e tij do të mbyllej. Fatmir Basha këmbëngulte se e njëjta metodë po përdorej në të gjithë vendin.
118. Në datën 21.02.2021, shtetasi Dorian Protoduari, i angazhuar në protestat e Unazës së Re dhe mbështetës familjarisht i PD-së, është dhunuar nga disa persona të cilët njihen për lidhjet e tyre të ngushta me kandidatin për deputet të PS-së, Arben Ahmetaj, njëkohësisht Ministër i Shtetit për Rindërtimin. Më herët të njëjtët persona kanë kërcënuar edhe nënën e tij (**Prova Nr. 70 – Dhunohet aktivisti i Unazës së Re, ishin njerëzit e Arben Ahmetaj, ja emrat**). Ndërkohë, në 22.02.2021, një zyrë elektorale e PD, në njësinë administrative Nr. 7, Tiranë është dëmtuar gjatë natës (**Prova Nr. 71 – Dhunohet zyra elektorale e PD-së në njësinë Nr. 7, Tiranë**).
119. Në datën **07.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasit **Agim Hoxha**, Shef i Komisarariatit nr. 4 Tiranë, **Nexhip Begaj**, Agjent Krimesh pranë Komisarariatit nr. 4 Tiranë, **Shpetim Karaj**, Agjent Krimesh pranë Komisarariatit nr. 4 Tiranë dhe **Florenc Gjonaj**, Oficer pranë Komisarariatit nr. 4 Tiranë, të cilët me veprime konkrete kanë konsumuar veprat penale të **“Shpërdorimit të detyrës”** parashikuar nga neni 248, **“Korrupsioni aktiv në zgjedhje”** parashikuar nga neni 328 dhe **“Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”** parashikuar nga neni 328/a të Kodit Penal (**Prova Nr. 72 – Kallëzimi penal i Partisë Demokratike, datë 07.04.2021**).
120. Policia e Shtetit pavarësisht se me ligj është e depolitizuar, është shndëruar në një degë të partisë në pushtet dhe me forcën që i jep funksioni publik, në shpërdorim të detyrës po përdor çdo mjet dhe mënyrë për të maksimizuar votën për Partinë Socialiste. Shtetasit e mësipërm, në shpërdorim të detyrës kanë krijuar një skemë kriminale të blerjes në favor të Partisë Socialiste. Kjo skemë kriminale organizohet dhe funksionon në zonën e Qesarakut, Fresk dhe konsiston në shantazh dhe presion për të votuar Partinë Socialiste, në të kundërt do shoqërohen në polici pa asnjë motivacion ligjor dhe real. Nga ana tjetër, lirohen të gjithë ata persona të cilët votojnë Partinë Socialiste pavarësisht se janë shkelës të ligjit.

121. Edhe më kriminal është fakti se, në funksion të maksimizimit të votës për Partinë Socialiste këta persona po ju vendosin gjoba të padrejta bizneseve që nuk votojnë PS. Para një jave Nexhip Begaj së bashku me Florenc Gjonaj shkuan tek një biznes bilardoje tek Fresku dhe i vunë gjobë, por u përballën me reagimin e personave që ishin në bilardo, i cili ariti deri në konfrontim fizik. Kjo ngjarje kriminale është fshehur nga policia për shkak të faktin se shkelësit e ligjit ishin personat e mësipërm.
122. Në datën 19 Prill, në ambientet e zyrës elektorale të PD Kavajë është plagosur sekretari i degës Bledar Okshtuni nga shtetasi Ndricim Jonuzi, i cili ka qenë i shoqëruar nga shtetasi Markel Shtylla, me detyrë drejtor i Policisë Bashkiake Kavajë dhe Dorian Troplini, me detyrë polic i Policisë Bashkiake. Më herët këta persona kishin qenë në një drekë me kryetarin e Bashkisë Kavajë, Redian Krali (**Prova Nr. 73 – Foto e Redian Krali me Ndricim Jonuzin**).

B.7 Transferimi i paligjshëm i gjendjes civile për të rritur numrin e votuesve në zona të caktuara:

123. Në datën **23.03.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasin Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë dhe drejtues politik i Partisë Socialiste për Qarkun Tiranë, shtetasen Blerina Gjylamenti, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe Kandidat për Deputet në zgjedhjet e 25 prillit në listën shumëemërore të Partisë Socialiste në Qarkun Korçë, si dhe çdo person tjetër të paidentifikuar, i cili me veprimet apo mosveprimet ka konsumuar veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, “Korrupsionit aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328 dhe “Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” parashikuar nga neni 328/a të Kodit Penal (**Prova Nr. 74 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, 23.03.2021**).
124. Kjo pasi në datën 17 dhe 18 mars, Emisioni Investigativ “BOOM” në Radio Televizionin “Ora”, publikoi fakte të pakundërshtueshme të skemës kriminale të transferimit të qytetarëve nga një qendër votimi në një tjetër, me qëllim ndikimin e paligjshëm dhe ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve të 25 prillit 2021. Nëpërmjet kësaj skeme kriminale të dirigjuar nga Zyrat Elektorale të Partisë Socialiste, me nismën e Blerina Gjylametit, Deputete e zonës dhe urdhër të Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë, njëkohësisht Bashkëdrejtues Politik i Partisë Socialiste për Qarkun Tiranë, janë anashkaluar tërësisht Njësitë Administrative dhe procedurat ligjore, duke

zhvendosur qytetarët nga rrethet ose të paregjistruar në Tiranë, si banues dhe për pasojë votues po në Tiranë. Si rezultat i kësaj skeme, vetëm në zonën e Yzberisht janë transferuar 14.000 banorë në katër muaj, duke cuar numrin e banorëve nga 8.000 në 22.000 (**Prova Nr. 75 – Skandali/Zyrat elektorale të PS-së transferojnë votuesit në Tiranë me 1 telefonatë, dalin “jashtë loje” njësitë bashkiake**).

C. Përdorimi i paligjshëm i të dhënave personale: shteti vendosi të dhënat personale në dispozicion të serverave të PS në Tiranë (4 Prova):

125. Në datën 11 Prill, media publikoi një bazë të dhënash të 910.000 zgjedhësve që përdorte Partia Socialiste në Tiranë, duke bërë publike të dhënat personale si numri i ID, vendi i banimit, numri i telefonit dhe bindja politike, e shprehur në zgjedhjet e kaluara dhe projeksionet për zgjedhjet e 2021 (**Prova Nr. 76 – Eskluzive/Si na monitoron Rilindja nr. e telefonit, nr. ID, vendet e punës, të dhënat konfindenciale për 910 mijë votues**). Ky database sipas medias ishte i instaluar në të gjitha zyrat elektorale të PS dhe lehtësisht i aksesueshëm për të gjithë personelin e shtabeve elektorale të PS. Media më pas konfirmoi faktin se database të tilla kishte në cdo qark të Shqipërisë (**Prova Nr. 77 – Zbërthehet burimi i Lapsi.al/Si e përdorin Drejtuesit Politikë të PS programin me të dhënat për 3.5 milion shqiptarë**).
126. Sipas medias, të dhënat e PS janë marrë nga të dhënat shtetërore që qytetarët i kanë vënë në dispozicion në portalin e-albania për të marrë shërbime gjatë pandemisë, apo në institucionet e tjera shtetërore për të marrë shërbime nga administrata, si pensionet apo dëmshpërblimet e ndryshme për shkak të fatkeqësive si tërmeti etj. Shteti vendosi në dispozicion të partisë të dhënat e qytetarëve, dhe më pas këto të dhëna iu shpërndanë cdo shtabi për të intimiduar qytetarët pasi ata (shtabi i PS) dinin gjithcka për ta, të dhënat personale, por edhe bindjen politike të tyre, shumë kohë para datës së zgjedhjeve.
127. Si rezultat i mbledhjes, përpunimit dhe përdorimit të paligjshëm të të dhënave nga ana e Partisë Socialiste, shumë qytetarë kanë marrë në telefonat e tyre mesazhe të personalizuar nga kandidatët për deputetë të PS-së, ku iu kërkohet të votojnë numrin e PS dhe numrin e tyre në zgjedhjet parlamentare të 25 prillit. Një nga këto raste, është edhe mesazhi i dërguar nga kandidat për deputet në Qarkun Tiranë, Spartak Braho, i cili qarttazi ka informacion edhe mbi origjinën e personit, të cilit i shkruan (**Prova Nr. 78 – Mesazhet e Spartak Brahos**).

128. Lidhur me këtë skandal të përmasave të jashtëkonshme, në datën **14.04.2021**, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – SPAK, shtetasit **Edi Rama**, Kryetar i Partisë Socialiste dhe Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, **Bledi Çuçi**, Ministër i Brendshëm, **Anila Denaj**, Ministër i Financave dhe Ekonomisë, **Arben Pëllumbi**, Sekretar Organizativ dhe i Koordinimit Elektoral në Partinë Socialiste dhe Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, **Mirlinda Karçanaj**, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, **Bledar Doracaj**, Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile dhe **Enton Duro**, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, të cilët me veprime konkrete kanë konsumuar veprat penale të **“Shpërdorimit të detyrës”** parashikuar nga neni 248, **“Korrupsioni aktiv në zgjedhje”** parashikuar nga neni 328, **“Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”** parashikuar nga neni 328/a, **“Përhapjes së sekreteve vetjake”** parashikuar nga neni 122 dhe **“Grupit të strukturuar kriminal”** parashikuar nga neni 333/a të Kodit Penal (**Prova Nr. 79 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 14.04.2021**).
129. Skandali me të dhënat personale u evidentua edhe në Raportin paraprak të OSBE/ODIHR. Rrjedhja e të dhënave personale sensitive, duke përfshirë edhe preferencat politike të zgjedhësve përbën shqetësim serioz dhe i bën zgjedhësit vulnerabël (shih fq. 2). Gjatë fushatës, përmes një rrjedhjeve informacioni, në domeinin public doli një databazë me informacione personale dhe detaje kontakti për afërsisht 900.000 qytetarë shqiptarë, që përmbante edhe preferencat e tyre potenciale të votimit. Ekzistenca e kësaj database në domeinin publik u konfirmua në mënyrë të pavarur nga MKVZ-ja e ODIHR-it. Disa bashkëbisedues të MNVZ-së nga partitë kryesore politike besonin se një incident i tillë mund të konsiderohej nga elektorati si shpërdorim i të dhënave personale për interesave të partive (shih fq. 12). Rrjedhja e të dhënave personale u konstatua me shumë shqetësim edhe nga Misioni i SHBA në OSBE.

D. Mohimi i të drejtës për të votuar i emigrantëve (2 Prova):

130. Deri në datën 19.04.2021, nuk ka patur asnjë ndalim që emigrantët shqiptarë, të hynin në Shqipëri (vendlindjen e tyre) dhe të vendoseshin në karantinë. Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm 1 javë para zgjedhjeve, nxori një vendim që detyronte emigrantet që vinin nga Greqia apo Maqedonia e Veriut të karantinoheshin detyrimisht për një periudhë 2-javore (**Prova Nr. 80 – Vendimi i Komitetit Teknik të Ekspertëve për**

karantimin e emigrantëve). Ky vendim pengonte efektivisht mbi 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës, në mënyrë diskriminuese.

131. Pavarësisht se nenet 24 dhe 25 përcaktojnë të drejtën e shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë Shqipërisë, për të votuar aty ku ata jetojnë, administrata zgjedhore nuk bëri asgjë që të garantonte efektivisht këtë të drejtë. Sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2020, numri i shtetasve shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë Shqipërisë është 1.68 milion ose 44.5% e totalit të numrit të zgjedhësve. Për më tepër, 600 mijë emigrantëve që jetojnë në Greqi, iu mohua efektivisht e drejta për të votuar, duke vendosur detyrimin e karantimit vetëm një javë përpara zgjedhjeve. Detyrimi për t'u karantinuar u shfuqizua në datën 3 Maj, një javë pas përfundimit të zgjedhjeve (**Prova Nr. 81 – Shfuqizohet vendimi i Komitetit Teknik të Ekspertëve**).
132. Mohimi i të drejtës për të votuar i shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë u evidentua edhe në Raportin paraprak të OSBE/ODIHR. Konkretisht, Misioni shprehet se megjithëse në Kodin Zgjedhor parashikohet si mundësi, qytetarëve nuk iu ofrua mundësia për të votuar jashtë vendit. Megjithatë, votuesit që jetojnë jashtë mund të kthehen dhe të votojnë në qendrat përkatëse të votimit, megjithëse në praktikë, kjo mund të jetë penguar nga masat e marra për shkak të COVID-19 (shih fq. 7). Një numër i konsiderueshëm zgjedhësish jetojnë jashtë vendit. Shumica e tyre nuk mundën të votojnë për shkak të mundësisë për të votuar jashtë shtetit dhe kufizimeve të vendosura ndaj udhëtimeve për shkak të COVID-19 (shih fq. 19).

D.1 Mohimi i të drejtës për të votuar të infektuarve me COVID-19:

133. Zgjedhësit që ishin infektuar me COVID-19 dhe që ndodheshin në karantinë, qenë të detyruar të respektonin rregullat e izolimit, duke cuar de facto në mohimin e së drejtës së tyre për të votuar. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar me COVID-19 në ditën e zgjedhjeve ishte rreth 23.000. Kjo praktikë bie ndesh përkatësisht me dispozitat për të drejtat e votimit dhe barazinë e votës të parashikuar në nenin 45 të Kushtetutës dhe me paragrafin 7.2 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 të OSBE-së. (shih fq. 8 të Raportit paraprak të OSBE/ODIHR).

E. Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor:

134. Në datën 30.07.2020, Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet ligjit Nr. 115/2020 miratoi nismën e Partisë Socialiste për disa ndryshime kushtetuese, të cilat në thelb sanksiononin: (i) heqjen e koalicioneve parazgjedhore; (ii) sistemin me votim preferencial për 2/3 e kandidatëve; dhe (iii) vendosjen e një pragu kombëtar. Në vijim të ndryshimeve kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë miratoi në datën 05.10.2020 disa ndryshime në Kodin Zgjedhor, të cilat kishin të bënin me: (i) **ulja nga 3% në 1%** e pragut kombëtar; (ii) renditja e kandidatëve që përfitojnë mandat ndryshon nëse kandidati ka marrë një numër votash parapëlqyese më të madh se herësi që del nga pjesëtimi i numrit të votave të subjektit me numrin e mandateve të fituara; (iii) ri-renditjen e listës fituese sipas kandidatëve që kanë fituar numër votash më të madh se herësi; dhe (iv) kryetari i partisë ka të drejtë të kandidojë deri në katër qarqe.
135. Ndryshimet e njëanshme në Kodin Zgjedhor nga Partia Socialiste, duke shkelur marrëveshjen konsensuale me KQZ-në, u evidentuan si problematike edhe nga Misioni i OSBE/ODIHR. Konkretisht, Misioni shprehet se disa bashkëbisedues të MKVZ-së së ODIHR-it, duke përfshirë edhe në KQZ, u shprehën se ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor krijuan një sërë paqartësish dhe ngritën shqetësime rreth kapacitetit teknik për zbatimin e tyre, sidomos në kohën e shkurtër mes ndryshimeve dhe zgjedhjeve (shih fq. 5).
136. Në Opinionin e tyre të Përbashkët, Komisioni i Venecias të Këshillit të Evropës dhe ODIHR-i shprehën keqardhje që procedurat e miratimit të ndryshimeve në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor kishin qenë jashtëzakonisht të nxituara dhe që nuk ishin paraprirë nga një proces i duhur konsultimi. Ata vunë gjithashtu në dukje se ndryshimet në lidhje me numrin minimal të kandidatëve përbëjnë disavantazh për partitë e vogla dhe se mundësia që u jepet drejtuesve të partive që të kandidojnë në disa zona zgjedhore njëherësh përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta (shih Opinioni i përbashkët i Komisionit të Venecias dhe ODIHR-it në vitin 2020).

E.1 Numri i madh i fletëve të votimit të pavlefshme (6 prova):

137. Në 31.03.2021, Komisioneri Shtetëror miratoi fletët e votimit, e cila përmbante logon e partive, emrin e subjektit/koalicionit, emrin e kryetarit të partisë dhe **emrat e kandidatëve për deputetë (Prova Nr. 82 – Vendimi i Komisionerit për fletët e votimit, datë 31.03.2021)**. Ky vendim i Komisionerit u ankimua nga Partia Socialiste, e cila kërkoi që fleta e votimit të ishte **vetëm me NUMRA, PA EMRAT e kandidatëve**. Në datën 03.04.2021, Komisioni i

Ankimeve dhe Sanksioneve vendosi të pranojë ankimin e PS për të miratuar një fletë votimi vetëm me numra, pa emrat e kandidatëve (**Prova Nr. 83 – Vendimi i KAS, 03.04.2021**). Ndaj këtij vendimi, u ushtrua ankim nga Partia Demokratike në Kolegjin Zgjedhor, i cili në 04.04.2021 vendosi të lërë në fuqi vendimin e KAS-it (**Prova Nr. 84 – Vendimi i Kolegjit Zgjedhor, datë 04.04.2021**). Kompania Celtics, e cila ishte ngarkuar me prodhimin e fletëve të votimit, informoi në të njëjtën ditë KQZ se afati 10-ditor për prodhimin e fletëve të votimit është “një mision i pamundur”, duke kërkuar minimalisht 20 ditë (**Prova Nr. 85 – Letra e kompanisë Celtics**).

138. Në kohën e shkurtër të mbetur në dispozicion nga dita e votimit, KQZ bëri një fushatë sensibilizuese mbi mënyrën se si qytetarët duhet të votonin që fleta e votimit të ishte e vlefshme. Megjithatë, kjo nuk e uli numrin e votave të pavlefshme, të cilat sipas të dhënave zyrtare të KQZ-së arritën në 83.028 vota ose 5% e totalit të numrit të votuesve. Ndërsa, në Qarkun Tiranë numri i fletëve të votimit të pavlefshme ishte 18.422 ose 3.80% (**Prova Nr. 86 – Faqja zyrtare e KQZ-së**).
139. Në datën 29 Prill, u shpërnda në rrjetet sociale dhe mediat online, një video e Ana Kekezit, me detyrë drejtoreshë pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturave të Mbetjeve (AKUM), e cila ishte numëruese në një KZAZ. AKUM është një agjenci shtetërore, që drejtohet nga Z. Alqi Bllako, kandidat për deputet me numër preferencial 17 në Qarkun Tiranë. Në video ajo duket teksa me stilolaps kryen shënime mbi fletët e votimit, cka rrjedhimisht i bën ato të pavlefshme. Sipas denoncimeve të mbërritura nga terreni ky nuk ishte një fenomen i izoluar, por i përdorur në masë, për të bërë të pavlefshme fletë votimi që ishin hedhur në favor të subjekteve të tjera zgjedhore, kundërshtarë të Partisë Socialiste (**Prova Nr. 87 – Ana Kekezi bën të pavlefshme fletët e votimit**).
140. Ky fakt u evidentua edhe në Deklaratën e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake, të publikuar në datën 25.04.2021 nga Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR, i cili në faqen 7 shprehet (citim): “...fushata e informimit të zgjedhësve ishte e pamjaftueshme dhe se kishte filluar me vonesë, sidomos sa i përket identifikimit të zgjedhësve dhe konfigurimit të ri të fletës së votimit. Kjo kontribuoi në krijimin e një konfuzioni në ditën e zgjedhjeve.”
141. Ndërsa datën 28.04.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve bëri një deklaratë për shtyp, si vijon: “Nëse fleta e votimit do ishte me emra, ndoshta do ishte ndryshe. Por, vendimmarrja e CAS-it dhe Kolegjit vlerësoi që informacioni mund të ishte më i thjeshtë për votuesit. Kemi

83 mijë fletë votimi të pavlefshme. Para se KQZ t'i djeg ndoshta është mirë që të shohim ato fletë votimi që janë vlerësuar të pavlefshme, për cfarë arsye është.” (**Prova Nr. 88 – Deklarata e Komisionerit Shtetëror Celibashi**).

E.2 Diskriminimi i kandidatëve gjatë procesit zgjedhor:

142. Ligji u lejon vetëm kryetarëve të partive, por asnjë kandidati tjetër, që të kandidojnë deri në katër zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta (shih fq. 2, Raporti Paraprak i OSBE/ODIHR).

F. Votimi më shumë se një herë

143. Një nga risitë e zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në 25 prill 2021 ishte identifikimi elektronik i zgjedhësve, i cili nënkupton identifikimin e zgjedhësit nëpërmjet verifikimit të të dhënave personale nga leximi me pajisje dhe përqasja e tyre me bazën elektronike të të dhënave, si dhe regjistrimi në pajisje i shenjave daktiloskopike. Futja e këtij mekanizmi të ri në Kodin Zgjedhor ishte kërkuar me forcë nga PD dhe kishte qenë pjesë e konsensusit të arritur ndërmjet palëve për ndryshimet e Kodit Zgjedhor në Korrik 2020. Nëpërmjet identifikimit elektronik synohej të eliminohej votimi më shumë se një herë, në të njëjtën qendër votimi apo qendra të tjera, të eliminohej votimi për të tretët apo votimi familjar.
144. Megjithatë, për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion, mosrealizimeve të auditimeve të pavarura dhe konsultimeve me publikun, sic konstaton me të drejtë Misioni i OSBE/ODIHR në Raportin paraprak (shih fq. 2, 7, 19), pati probleme me vënien në punë të pajisjeve, operatorëve të kualifikuar, përdorimit, ndërprerjes së energjisë etj. Por, gjithësesi ajo që mbetet problematike është fakti se nga informacionet e marra në terren nga strukturat e Partisë Demokratike rezulton se gjithësesi pajisjet e identifikimit elektronik nuk e eliminuan fenomenin e votimit të dyfishtë, votimit për të tretët apo familjarë, apo falsifikimin e identitetit të zgjedhësve. Kjo pasi pavarësisht mjetit të identifikimit të paraqitur, pajisja e identifikimit elektronik pranonte edhe shenjat daktiloskopike të personave të tjerë të ndryshëm nga poseduesit e mjeteve të ID.
145. Në ditët pas ditës së zgjedhjeve, në rrjetet sociale qarkullojë një video, ku disa persona testonin pajisjen e identifikimit elektronik, e cila pranonte shenjën e gishtërinjve të personave të tjerë,

pavarësisht mjetit të identifikimit të paraqitur. Nisur nga ky shqetësim se pajisjet e identifikimit elektronik, jo vetëm nuk kanë eliminuar votimin e dyfishtë, por mund ta kenë lehtësuar, në datën 6 maj 2021, Komisioneri dhe Zv.komisionerja Shtetërore e Zgjedhjeve u shprehën se pas kthimit së pajisjeve të identifikimit elektronik nga qendrat e votimit, aktualisht është duke u kryer kryqëzimi i të dhënave për të verifikuar raste kur zgjedhës të caktuar kanë votuar në qendra votimi të ndryshme apo brenda të njëjtës qendër votimi. Kjo tregon që shqetësimi i ngritur për votimin e dyfishtë, votimin për të tretët apo familjarët, është një shqetësim i drejtë dhe i bazuar.

146. Në përmbledhje të fakteve deri në datën 25.4.2021 del qartë se i gjithë **SHTETI U VU NË DISPOZICION TË PARTISË. SHTETI DHE PARTIA (PS) U BËNË NJË.**

II. E DREJTA E APLIKUESHME

147. **Kushtetuta e Shqipërisë:**

- (i) **Neni 1** parashikon se: “3. Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike.”
- (ii) **Neni 18** parashikon se: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.”
- (iii) **Neni 35** parashikon se: “1. Askush nuk mund të detyrohet përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij. 2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.”
- (iv) **Neni 45** parashikon se: “1. Cdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjec, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. 4. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.”
- (v) **Neni 64** parashikon se: “3. Zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumemërore. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, për caktimin e zonave zgjedhore, pragun kombëtar, numrin e mandateve për secilën zonë, shpërndarjen e mandateve dhe masën e shtrirjes së votimit parapëlqyes përcaktohen në ligjin për zgjedhjet. Ligji për zgjedhjet garanton që votimit parapëlqyes t’i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore dhe të sigurojë përfaqësim gjinor.”

148. **Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut:**

- (i) **Neni 3, Protokolli 1** parashikon se “Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjet e organit ligjvënës.”
- (ii) **Neni 8** parashikon se: “1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

149. **Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore:**

- (i) **Pika 27** parashikon se: “Liria e zgjedhësve për të shprehur vullnetin e tyre kërkon, para së gjithash, zbatimin rigoroz të procedurës së votimit. Në praktikë, zgjedhësit duhet të kenë mundësi të hedhin votat e tyre për listat e rregjistruara ose për kandidatët, gjë që do të thotë se atyre duhet t'u vihen në dispozicion fletët e votimit me emrat e kandidatëve, dhe ata duhet të kenë mundësi të hedhin fletët e votimit në kutitë e votimit.”
- (ii) **Pika 49** parashikon se: “Është mirë që të shmanget shpallja e shumë fletëve të votimit si të pavlefshme ose të prishura. Në rast dyshimi, duhen bërë përpjekje për të mesuar se cili ka qenë qëllimi i votuesit.”

150. **Kodi Zgjedhor:**

- (i) **Neni 2** parashikon se: “27. “Identifikimi elektronik” është identifikimi i zgjedhësit nëpërmjet verifikimit të të dhënave personale nga leximi me pajisje dhe përqasja e tyre me bazën elektronike të të dhënave për listën e zgjedhësve të qendrës së votimit, si dhe regjistrimi në pajisje i shenjave daktiloskopike. 29. “Votimi për të tretët” është votimi kur zgjedhësi voton në emër dhe për llogari të personave të tjerë, të pranishëm ose jo në qendrën e votimit. Përveçse kur bëhet votimi i asistuar sipas këtij ligji, votimi për të tretët është i kundërligjshëm dhe dënohet sipas Kodit Penal. 30. “Votim

familjar” është formë e votimit për të tretët dhe ndodh kur një pjesëtar i familjes, si rregull kryefamiljari, voton në emër dhe për llogari të pjesëtarëve të tjerë.”

- (ii) **Neni 12** parashikon se: “5. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) është organ kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor.”
- (iii) **Neni 21** parashikon se: “1. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, KAS-i ushtron këto kompetenca: a) vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose më shumë qendra votimi, në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe për përsëritjen e pjesshme ose të plotë të zgjedhjeve.”
- (iv) **Neni 24** parashikon se: “1. KQZ-ja udhëheq dhe mbikëqyr procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin, për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit dhe kërkojnë nga KQZ-ja që të pajisen me dokumentacionin e votimit nga jashtë.”
- (v) **Neni 25** parashikon se: “1. Pavarësisht nga procedura e votimit, manuale ose elektronike, votat e votuesve nga jashtë vendit administrohen nga KQZ-ja, duke garantuar integritetin e votimit dhe fshehtësinë e votës nga çdo ndërhyrje mbi fletët e votimit ose mbi informacionin elektronik të votimit që administrohet prej saj.”
- (vi) **Neni 33** parashikon se: “KZAZ-ja kryen këto detyra: ë) përgatit dhe miraton tabelën përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për çdo subjekt zgjedhor në ZAZ dhe ia dërgon atë KQZ-së, së bashku me materialet e tjera të nevojshme, në përputhje me nenin 122 të këtij Kodi.”
- (vii) **Neni 78** parashikon se: “6. Ndalohet zhvillimi i fushatës zgjedhore në institucionet publike. 7. Subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve u ndalohet dhe mbajnë përgjegjësi penale në rast se ofrojnë ose japin të holla, të mira materiale, premtojnë për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t’u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike.”

- (viii) **Neni 91** parashikon se: “1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo cdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale ose kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit apo pronësia. 2. Në kuptim të këtij neni “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe cdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim. 3. Gjatë fushatës zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi nga puna, lrimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. 4. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.”
- (ix) **Neni 92** parashikon se “6. Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, ose zhvillimi i tyre, pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës, si dhe titullarin përkatës të institucionit kur ai ka pënguar zbatimin e kësaj dispozite.”
- (x) **Neni 98** parashikon se: “4. Fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posacme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor. Mënyra e votimit parapëlqyes përcaktohet nga KQZ-ja në varësi nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejet i ngarkuar, konfigurimi i

fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer.”

- (xi) **Neni 106** parashikon se: “1. Pasi merr fletën e votimit, zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë dhe në fletën e votimit shënon në vendin e përcaktuar nga fleta e votimit për subjektin zgjedhor dhe/ose kandidatin e parapëlqyer të subjektit zgjedhore shenjë “x” ose “+” ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij.”
- (xii) **Neni 116/1** parashikon se: “5. Në përfundim të numërimit dhe nxjerrës së rezultatit të ZAZ-së, kutitë e materialeve të votimit dërgohen në KQZ së bashku me kutitë e votimit. Kutitë e materialeve të votimit hapen në KQZ gjatë fazës së shqyrtimit të ankimit, në përputhje me nenin 136 dhe/ose pikën 1 të nenit 138 të Kodit, nëse provat e kërkuara administrohen sipas këtij Kodi, në kutinë e materialeve të votimit.”
- (xiii) **Neni 117** parashikon se: “2. Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërën nga subjektet zgjedhore dhe/ose vetëm për njërin nga kandidatët e tij. Kur është votuar për më shumë se një kandidat të të njëjtit subjekt zgjedhor, vota i llogaritet vetëm subjektit zgjedhor. 3. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur: a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja; b) fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në nenin 103 të këtij Kodi; c) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës; ç) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore; d) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit; dh) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit; e) është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor; e/1) nuk është e qartë se për kë është votuar; ose ë) zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit. 4. Vlerësimi i votave synon të identifikojë, sa të jetë e mundur, qëllimin e zgjedhësit.”
- (xiv) **Neni 123** parashikon se: “1. KQZ-ja verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për zonën zgjedhore për Kuvendin apo për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse. Për këtë, KQZ-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore dhe e miraton atë me vendim jo më vonë se 48 orë nga mbërritja e të gjitha tabelave të zonës zgjedhore. 4. Vendimi i KQZ-

së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, sipas këtij neni, mund të ankimohet po në KAS, sipas procedurave të parashikuara në pjesën X të këtij Kodi. 5. Vendimi i KZAZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve të ZAZ-së, çdo vendim i KZAZ-së, i marrë gjatë procedurës së marrjes në dorëzim të materialeve dhe dokumentacionit zgjedhor nga KQV-të, si dhe gjatë numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit të votimit, janë vendime të ndërmjetme dhe ankimohen në KAS së bashku me ankimin kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas pikës 1 të këtij neni.”

- (xv) **Neni 123/1** parashikon se: “1. KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së. 2. Kërkesat ose ankesat e subjekteve zgjedhore trajtohen sipas procedurës së përcaktuar nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.”
- (xvi) **Neni 124** parashikon se: “1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit. 3. Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, të marrë sipas nenit 123 të këtij Kodi, mund të paraqitet ankim po në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi. Ankimi ndaj vendimit mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi.”
- (xvii) **Neni 143** parashikon se: “1. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit KQZ-ja vendos sipas rastit: ç) shpalljen e zgjedhjeve të pavlefshme në një ose disa qendra votimi të zonës zgjedhore ose në të gjithë njësinë zgjedhore; d) lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve, sipas nenit 122 ose nenit 123 të këtij Kodi.”
- (xviii) **Neni 152** parashikon se: “2. Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose

të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë.”

- (xix) **Neni 160** parashikon se: “KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimit, në rast se: a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore.”
- (xx) **Neni 161** parashikon se: “1. Pas përfundimit të procesit të ankimit, jo më vonë se 3 ditë nga nxjerrja e rezultatit të zonës zgjedhore, KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjektit shpall të pavlefshme dhe urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore, kur pavlefshmëria e shpallur në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore ose në shkallë vendi.”

151. **Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”:**

- (i) **Neni 6** parashikon se: “1. Të dhënat personale përpunohen vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin; b) për hartimin dhe përmbushjen e kontratave, në të cilat subjekti i të dhënave personale është palë; c) për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave; ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit; d) për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një competence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, të cilës i janë përhapur të dhënat; dh) për ndjekjen e interesave legjitimë të kontrolluesit ose të një pale të tretë, të cilës i janë përhapur të dhënat, përvec kur këta interesa mbizotërojnë mbi interesat për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të subjektit të të dhënave.”
- (ii) **Neni 7** parashikon se: “1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, ndalohet përpunimi i të dhënave, që zbulojnë origjinën racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësinë në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimet penale, si dhe shëndetin dhe jetën seksuale.”

152. **Vendimi Nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator:**

- (i) **Neni 3** parashikon se: “1. Në zbatim të këtij vendimi: 1.1 “veprimtari të ndaluara për t’u promovuar” janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posacërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë: a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të cdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të cdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut; b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si dhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik; c) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e monumenteve dhe të objekteve të paluajtshme të karakterit arkeologjik, historik, kulturor e shkencor dhe të objekteve publike, ose për mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve të luajtshme me vlerë institucionale, historike, arkeologjike, kulturore ose shkencore; c) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi; d) mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësisë natyrore. 1.3 “veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: a) shpërndarjen në veprimtari publike të lejeve të legalizimeve, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve; b) shpërndarjen në veprimtari publike të akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, certifikatave të pronësisë, dhe çfarëdolloj titulli pronësie sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, si dhe të regjistrimeve të titujve të pronësisë sipas ligjit Nr. 111/2018, “Për kadastrën” në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve; b) vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose në nivel të njërive të vetëqeverisjes vendore, apo cdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione dhe/ose emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit; c) përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari

dhe ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjetet e komunikimit elektronik, si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim; d) gjatë fushatës zgjedhore, marrja në punë, pushimi nga puna, lrimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat në organikën e cdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura. dh) kontrollet dhe verifikimet e bizneseve tregtare dhe operatorëve në kundërshtim me procedurat ligjore dhe veprimtarinë institucionale. 3. Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjen ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljet e kamatëvonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore e doganore, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë. 4. Katër muaj para datës zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndakohet dhënia e kontratave publike të koncesionit/partneritet public privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncesionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t'u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor.”

- (ii) **Neni 6** parashikon se: “1. Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë periudhës zgjedhore, i krijohen kushtet e nevojshme dhe i garantohet moscënimi i të drejtave dhe lirive kushtetuese për të ushtruar pa ndikim lirinë e shprehjes dhe/ose për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të vecanta në legjislacionin në fuqi dhe në këtë vendim. 3. Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të

institucioneve shtetërore, i ndalohet cdolloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje. 6. Ndalohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës shtetërore të institucionit, nëpërmjet ushtrimit të presionit ndaj tyre për këtë qëllim, si dhe premtimit ose ofrimit të përfitimeve nëpunësve publikë, për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës.”

153. **Jurisprudenca:**

- (i) Vendimi Nr. 75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese;
- (ii) Vendimi Nr. 169, datë 26.07.2002 i Gjykatës Kushtetuese;
- (iii) Vendimi Nr. 39, datë 27.07.2015 i Gjykatës Kushtetuese;
- (iv) Vendimi Ireland v. United Kingdom, datë 18.01.1978 i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (v) Vendimi Hirst v. Mbretëria e Bashkuar, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (vi) Vendimi Azis v. Qipro, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (vii) Vendimi Libita v. Italy, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (viii) Vendimi Sitaropoulos etj. v. Greqia, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (ix) Vendimi Catt. v. Mbretëria e Bashkuar, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (x) Vendimi S. and Marper v. Mbretëria e Bashkuar, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (xi) Vendimi Rotaru v. Rumania, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (xii) Vendimi Aman v. Zvicra, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (xiii) Vendimi Association “21 December 1989” and other v. Rumania, i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- (xiv) Vendimi Nr. 45, datë 18.11.2013 i Kolegjit Zgjedhor.

III. ANALIZA LIGJORE

III.1 NË LIDHJE ME PROCEDURËN DHE KONTESTIMIN

A. Në lidhje me legjitimimin e palës ankuese

154. Neni 123/1, pika 1 e Kodit Zgjedhor parashikon se KQZ-ja vihet në lëvizje me kërkesë të subjekteve zgjedhore në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së. Ndërsa, neni 124, pika 1 dhe 3 parashikojnë se cdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së që çenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit. Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore, mund të paraqitet ankim po në KQZ jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi.
155. Me Vendimin Nr. 72, datë 15.02.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur të regjistrojë si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021 “Partia Demokratike”, me Kryetar z. Lulzim Basha, me shkronjat nistore “PD” ose “PDSH”. Ndërsa, me Vendimin Nr. 107, datë 02.03.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur të regjistrojë koalicionin “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” ose “PD-AN”, si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, të udhëhequr nga Partia Demokratike.
156. Në zbatim të nenit 123/1, pika 1 dhe nenit 124, pikat 1 dhe 3, sipërcituar, Partia Demokratike e Shqipërisë ka legitimatio activa për të paraqitur cdo ankim, që e cmon të bazuar, kundër vendimeve të KZAZ-së apo KQZ-së. Në rastin konkret, PD ka paraqitur një ankim kundër Vendimit Nr. 343, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë”, duke kërkuar pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Tiranë. Në këtë kuptim, PD përmbush kriterin e parë procedural, legjitimimin aktiv, për paraqitjen e këtij ankimi.

B. Në lidhje me kompetencën e organit administrativ

157. Neni 12, pika 5 e Kodit Zgjedhor parashikon se Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative. Neni 21, pika 1, gërma “a” parashikon se KAS-i vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe përsëritjen e pjesshme ose të plotë

të zgjedhjeve. Ndërsa, neni 123, pika 5 parashikon se vendimet për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ankimohen në KAS.

158. Me Vendimin Nr. 343, datë 04.05.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit në Zonën Zgjedhore Tiranë. Në zbatim të nenit 12, pika 5, nenit 21, pika 1, gërma “a” dhe nenit 123, pika 5 e Kodit Zgjedhor, cdo subjekt zgjedhor, i legjitimuar sipas parashtrimeve në paragrafët 11 – 13, ka të drejtë të paraqesë ankim kundër vendimit të KQZ për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultatit zgjedhor në KAS, brenda afatit ligjor. Në rastin konkret, Partia Demokratike ka paraqitur një ankim kundër Vendimit Nr. 343, datë 04.05.2021, duke kërkuar pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Tiranë. Shqyrtimi i këtij ankimi është kompetencë ekskluzive e KAS-it. Në këtë kuptim, PD përmbush kriterin e dytë procedural, kompetencën lëndore, për shqyrtimin e këtij ankimi.

C. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit

159. Kriteri i tretë për paraqitjen e një ankimi administrativ kundër vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit Zgjedhor ka të bëjë me afatin ligjor të ankimit. Për këtë, neni 152, pika 2 i Kodit Zgjedhor ka parashikuar një afat të përgjithshëm ankimi 5-ditor kundër të gjitha vendimeve të marra nga KQZ-ja në periudhën 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve deri në përfundimin e shqyrtimit administrativ të ankimeve. Ndërsa, neni 124, pika 3 ka parashikuar shprehimisht që kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit në Zonën Zgjedhore Tiranë mund të bëhet jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e këtij vendimi.
160. Në rastin konkret, vendimi Nr. 343 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është shpallur në datën 04.05.2021. Për respektimin e afatit ligjor, subjekti zgjedhor duhet të paraqesë një ankim jo më vonë se data 10.05.2021. Ankimi i PD-së është paraqitur në datën 07.05.2021, pra brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga nenet 152, pika 2 dhe 124, pika 3 të Kodit Zgjedhor. Në këtë kuptim, PD përmbush kriterin e tretë procedural, afatin ligjor, për paraqitjen e këtij ankimi.
161. **Konkluzion:** Neni 130 i Kodit Zgjedhor përcakton se KQZ merr vendim për pranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon: a) kompetencën e KQZ-së; b) legjitimitimin e ankuesit; dhe c) respektimin e afateve ligjore. Duke qenë se sic kemi shpjeguar më lart, ankimi i paraqitur

nga PD-ja përmbush të tre kriteret procedurale (legjitimimin, kompetencën dhe afatin ligjor), kërkojmë pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve.

III.2 NË LIDHJE ME THEMELIN E PRETENDIMEVE PËR PAVLEFSHMËRI

A. Në lidhje me pavlefshmërinë e zgjedhjeve

162. Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në mënyrë të detajuar cilat janë rastet kur zgjedhjet shpallen të pavlefshme, cili është organi kompetent dhe pasojat që sjell një vendim i tillë. Konkretisht, neni 160 parashikon se KQZ-ja i shpall zgjedhjet të pavlefshme kur tërësia e shkeljeve të ligjit mund të ketë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Një vendimmarrje e tillë, sipas neni 121, pika 1 është kompetencë ekskluzive e KAS-it. Në rast të marrjes së një vendimi për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë zgjedhore, neni 161, pika 1 parashikon se KQZ-ja urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore.
163. Për të vërtetuar (pa)ligjshmërinë e një veprimi të kryer, pra për të vërtetuar atë që parashikon Kodi Zgjedhor, nëse shkelja e ligjit ka qenë e tillë sa ka cënuar rëndë procesin zgjedhor apo nëse tërësia e shkeljeve të kryera ka qenë e atyre përmasave sa mund të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, KAS-i duhet të orientohet nga konceptet e përpunuara nga jurisprudenca gjyqësore mbi parimin e proporcionalitetit. Terminologjia “e rëndë” dhe ndikimi “në një masë të tillë”, i përdorur në nenin 160, pika 1, shkronja “a” të Kodit Zgjedhor, imponon kryerjen nga KAS-i të një vlerësimi të arsyeshëm, objektiv dhe të paanshëm mbi natyrën e shkeljes së ligjit. Kuptimi i saktë dhe i drejtë i terminologjisë së përdorur në këtë dispozitë ligjore, duhet të analizohet dhe vlerësohet në tërësi nga disa faktorë, që kanë të bëjnë me rëndësinë e shkeljes së ligjit, pasojat e ardhura apo që mund të vinin nga kjo shkelje (shih vendimin Nr. 45, datë 18.11.2013 të Kolegjit Zgjedhor; vendimin nr. 75, datë 19.04.2002 të Gjykatës Kushtetuese).
164. Në rastin konkret, Partia Demokratike do të parashtrojë një numër të madh shkeljesh të Kushtetutës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kodit të Praktikës së Mirë për Cështjet Zgjedhore dhe Kodit Zgjedhor, të cilat në tërësinë e tyre çënojnë rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikojnë drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Tërësia e

këtyre shkeljeve krijon bindjen e plotë bazuar në fakte dhe prova të pakundërshtueshme, si dhe Kodin Zgjedhor, për shpalljen e pavlefshme dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Tiranë.

A.1 Shkeljet ligjore lidhur me manipulimin e vullnetit të zgjedhësve nëpërmjet blerjes së votës, përdorimit të personave me precedentë kriminalë, dhënies së ndihmave ushqimore, bonuseve dhe përfitimeve të tjera, si shkelje të ligjit që kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor:

165. Manipulimi i vullnetit të zgjedhësve nëpërmjet premtimit, ofrimit apo dhënies së përfitimeve monetare apo materiale, ashtu si edhe kërcënimi i votuesve, kanë qenë problematika të theksuara që kanë shoqëruar vazhdimisht proceset zgjedhore në Shqipëri, vecanërisht në 10 vitet e fundit. Në raportet ndërkombëtare për vëzhgimin e zgjedhjeve në Shqipëri, vecanërisht në raportet e OSBE/ODIHR, këto problematika vijnë të përsëritura dhe vazhdimisht ka rekomandime për të marrë masat e duhura ligjore dhe institucionale për luftimin e këtyre fenomeneve.
166. Për luftimin me efikasitet të këtyre fenomeneve, legjislatori shqiptar, i asistuar nga ekspertiza ndërkombëtare e partnerëve tanë, ka miratuar ndryshime të vazhdueshme në Kodin Zgjedhor, në Kodin Penal dhe akte të shumta nënligjore që synojnë pikërisht adresimin e këtyre problematikave. Konkretnisht, neni 78, pika 7 e Kodit Zgjedhor parashikon ndalimin e subjekteve zgjedhore të ofrojnë ose japin të holla, të mira materiale, premtojnë vend pune apo favorizime të tjera me qëllim për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme në mbështetje të një kandidati.
167. Ky parashikim i Kodit Zgjedhor është reflektuar më tej edhe në Kodin Penal, i cili në nenin 328 parashikon se ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të me qëllim votimin në një mënyrë të caktuar, përbën veprë penale dhe dënohet me burg nga një deri në 5 vjet. Shpeshherë praktika e shitblerjes së votës është e shoqëruar edhe me veprimtari të tjera të paligjshme, të tilla si marrja e dokumentit të identifikimit për të moslejuar votimin, kanosja e zgjedhësit apo detyrimi për të votuar në një mënyrë të caktuar nga një person që ushtron një funksion publik.
168. Megjithatë, ekzistenca e një legjislacioni solid për krimet zgjedhore më shumë është tregues i përmbushjes në letër të rekomandimeve në raportet ndërkombëtare lidhur me zgjedhjet në

Shqipëri, se sa një vullnet i mirëfilltë i partive politike. Megjithatë, tre partitë kryesore shqiptare (PS, PD dhe LSI) arritën një dakordësi mbi ndryshimet e Korrikut 2020 në Kodin Zgjedhor, të cilat gjithësesi u pasuan nga ndryshime të tjera të njëanashme nga Partia Socialiste, fatkeqësisht edhe në zgjedhjet parlamentare të 25 Prillit nuk munguan rastet flagrante të shitblerjes së votës, dhënies së ndihmave ushqimore apo kërcënimit të votuesve nga ana e drejtuesve, përfaqësuesve apo mbështetësve të Partisë Socialiste.

169. Shkeljet flagrante të Kushtetutës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kodit të Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore, Kodit Zgjedhor, tërësia e veprimtarisë kriminale të kallzuar gjatë periudhës zgjedhore, e dokumentuar sipas **88 provave** të këtij ankimi do të analizohen si vijon:
170. **Së pari**, sic kemi shpjeguar në pjesën e rrethanave të cështjes, Partia Demokratike nëpërmjet strukturave të saj në terren ka evidentuar dhe faktuar raste të shumta flagrante të shitblerjes së votës. Për të gjitha këto raste, PD ka depozituar 50 kallëzime penale në SPAK, ndër të cilat 30 kanë të bëjnë me raste masive të shitblerjes së votës dhe 130 kallëzime në prokuroritë e rretheve për shkelje të tjera. Në rastin e qarkut Tiranë, Partia Demokratike ka depozituar 7 kallëzime në SPAK për mbi 100 zyrtarë të lartë të pushtetit qendror dhe vendor, persona me rekorde të tmerrshme kriminale, persona nën kërkim, të përfshirë drejtpërdrejtë në blerjen e votave në favor të PS-së. Kjo strukturë kriminale e blerjes së votës, është drejtuar nga drejtues të lartë të institucioneve shtetërore apo Partisë Socialiste, si Erion Veliaj, kryetar i Bashkisë Tiranë, Belinda Balluku, Ministër i Energjisë dhe Infrastrukturës, Ogerta Manastirliu, Ministër i Shëndetësisë, Arben Ahmetaj, Ministër i Shtetit për Rindërtimin, dhe deputetë e zyrtarë të lartë të tjerë të Partisë Socialiste.
171. Por, përveçse një veprimtari kriminale, e cila duhet të hetohet dhe dënohet nga organet e drejtësisë (SPAK dhe Gjykata), blerja e votës përbën shkelje të rënda të Kodit Zgjedhor, duke cënuar procesin zgjedhor, deri në atë masë sa sjell pavlefshmërinë e tij në rast se faktohet shtrirja e saj në masë të gjërë. Konkretnisht, neni 78, pika 7 e Kodit Zgjedhor parashikon shprehimisht ndalimin e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve për të ofruar ose dhënë të holla, të mira materiale, premtime për vende pune ose favorizime të tjera të cilësdo forme, me qëllim votimin në një mënyrë të caktuar ose marrjen pjesë në votime.
172. Në rastin e Qarkut të Tiranës, kemi faktuar nëpërmjet 88 provave se persona me rekorde të tmerrshme korruptive dhe kriminale, me në krye drejtuesin politik të PS-së, Erion Veliaj, kishin ndarë zonat dhe ishin angazhuar në blerjen dhe manipulimin masiv të votës. Kjo veprimtari

ishite shtrirë në të gjitha njësitë administrative të qytetit të Tiranës, ish-komunat, Paskuqani, Babrru, Kamëz, Zall-Herr, Kavajë dhe Rrogozhinë. Për cdo zonë vepronin drejtues të lartë të Partisë Socialiste, të cilët në bashkëpunim me njerëz me probleme të rënda korrupsioni apo rekorde të tmerrshme kriminale blinin cdo votë të mundshme për të siguruar mbështetje maksimale për Partinë Socialiste dhe Partinë Social Demokrate.

173. Kjo skemë kriminale e blerjes së votës në mënyrë masive, e shtrirë në të gjithë Qarkun e Tiranë, përbën shkelje të rënda të ligjit zgjedhor, të cilat kanë cënuar procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në rezultatin zgjedhor, për rrjedhojë edhe në shpërndarjen e mandateve. Ky ndikim mund të vërehet vecanërisht në votat që ka marrë PSD, me kryetar Tom Doshin në Qarkun Tiranë dhe kandidati me Nr. 30 i PS, Orinaldo Rakipi. Nga viti 2008 e në vijim, PSD nuk ka arritur të marrë votat e mjaftueshme për të prodhuar mandat deputeti në Qarkun Tiranë. Megjithatë, në këto zgjedhje PSD arriti të marrë një deputet në Tiranë, duke pasur të parin e saj deputetin Tom Doshi. Ky shtetas, sic kemi përshkruar në pjesën e fakteve është shpallur non-grata nga Departamenti Amerikan i Shtetit për raste madhore korrupsioni. Ai është vazhdimisht i akuzuar dhe dyshuar për blerje votash në Qarkun Shkodër, nga ku ka dalë fillimisht deputet. Po ashtu, sic kemi përshkruar në pjesën e fakteve, Tom Doshi ka angazhuar në Tiranë dy persona me rekorde të tmerrshme kriminale si Filip Gjelošhaj dhe Pal Gjelošhaj, të cilët nëpërmjet parave, por edhe kërcënimeve e dhunës, kanë tjetërsuar vullnetin e qytetarëve.
174. Ndërsa, rasti i dytë flagrant është ai i Orinaldo Rakipi, kandidat për deputet në listën e PS me Nr. 30. Ky shtetas, 27-vjecar, pa asnjë kontributi apo angazhim të mëparshëm në jetën partiake, politike apo publike të vendit ia arriti të marrë 15.700 vota, duke lënë pas vetes figura të njohura të PS-së, si ish-zëvendëskryeministra, ministra, deputetë etj. Rezultati surprizues i këtij kandidati, të cilin nuk e njihte askush dhe për të cilin nuk u fol një ditë të vetme publikisht, derisa filluan të numërohen votat e kandidatëve e ka një shpjegim. Ai është djali i Aqif Rakipit, ish-deputet i Kuvendit të Shqipërisë, i cili u largua për shkak të procesit të dekriminalizimit. Ky person, i skeduar me rekorde kriminale, bëri të flitet për të edhe në vitin 2017, kur arriti të prodhonte pothuajse individualisht dy mandate në Qarkun Elbasan, të cilat shumë shpejt do t'i humbiste për shkak të dekriminalizimit. Ai është i njohur për lidhjet e tij me kryeministrin, por edhe botën e krimit. Votat e marra nga Orinaldo Rakipi mund të shpjegohen vetëm nëpërmjet blerjes dhe manipulimit masiv të votës.

175. Minimalisht, në Qarkun Tiranë kemi dy deputetë, për të cilët askush nuk mund të japë një shpjegim logjik të votave të tyre apo se ku e kanë bazën e mbështetjes. Ky fenomen i shitblerjes së votës, i ngritur në sistem për shkak të mosreagimit të institucioneve publike, vecanërisht organeve të drejtësisë, ka ndikuar drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në Tiranë, për rrjedhojë edhe në ndarjen e mandateve. Këta individë, me një të shkuar kriminale, të cilat janë skeduar si të tillë nga institucionet shqiptare dhe ndërkombëtare, shfrytëzojnë varfërinë e njerëzve dhe mungesën e reagimit institucional, për të tjetërsuar vullnetin e zgjedhësve. Ata nuk sjellin as ide, as program, as zgjidhje, as përfaqësim të zgjedhësve, por vetëm janë fryt i interesave kriminalë dhe korruptivë. Ndaj, KAS nisur nga këta dy shembuj flagrantë, duhet të vlerësojë cdo fakt, cdo provë, cdo dokument, cdo informacion të vënë në dispozicion nga ana jonë për të arritur në konkluzionin e pakundërshtueshëm se shitblerja e votës, një fenomen në kundërshtim flagrant me nenin 78 të Kodit Zgjedhor, cënoi rëndë procesin zgjedhor dhe ndikoi drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve në Qarkun Tiranë. Në të kundërt, kjo do të thotë të legalizojmë blerjen e votës si një mënyrë efektive për të fituar zgjedhje dhe siguruar mandate në Kuvend.
176. **Së dyti**, neni 91, pika 4 e Kodit Zgjedhor dhe neni 3, pika 3 e Vendimit Nr. 9/2020 parashikojnë se katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re para zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, mbështetjes ekonomike, dhënien e shpërblimeve etj. Megjithatë, Qeveria dhe bashkitë e drejtuar nga socialistët në raste të shumta, të cilat i kemi shpjeguar gjërësisht nëpërmjet vendimeve të saj akordoi shtesa në ndihmën ekonomike, dhënie shpërblimesh të posacme, grante për të rinjtë, rritje pagash, fonde të posacme për bujqësinë dhe dëmshpërblime për familjet e prekura nga tërmeti, lejimin e ndërtimeve pa leje etj., duke manipuluar kështu vullnetin e zgjedhësve nëpërmjet përfitimeve ekonomike të drejtpërdrejta.
177. Konkretisht, sic kemi përshkruar në pjesën e fakteve, vecanërisht Bashkia Tiranë, Kamëz dhe Rrogozhinë abuzuan masivisht me dhënie shpërblimesh nga fondi i rindërtimit, qoftë për familje realisht të prekura nga tërmeti, por edhe për familje që nuk kishin pasur asnjë pasojë. Bashkia Kamëz vecanërisht përfshiu në skemën e dhënies së shpërblimeve edhe persona që nuk kishin të bënin fare me zonat në fjalë, që jetonin jashtë shtetit apo akordimin në kundërshtim me ligjin të ndihmës jo vetëm për kryefamiljarin, por edhe anëtarët e tjerë të familjes. Bashkia Rrogozhinë përfshiu në muajt shkurt dhe prill 2021 në skemën e fondeve të

rindërtimit mbi 2.500 familje. Vetëm në 12.04.2021, Bashkia Rrogozhinë vendosi që për 871 familje të akordojë një fond të barabartë me rreth 3 milionë euro, në një kohë kur nxjerrja e akteve për dhënie përfitimesh ishte tërësisht në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 3 të Vendimit Nr. 9/2020 të KQZ-së.

178. Numri realë i përfituesve nga këto skema tërësisht të paligjshme dhe me qëllim të qartë marrjen e votave dhe mbështetjes për Partinë Socialiste, nëpërmjet disbursimit të drejtpërdrejtë të të hollave në llogaritë e tyre, do të dalë nga informacioni i marrë gjatë hetimit administrativ, megjithatë nga një përlllogaritje e thjeshtë nëse do të llogarisnim vetëm në Bashkinë Rrogozhinë numrin e përfituesve nga fondi i rindërtimit në 2.500 familje me minimalisht katër anëtarë, atëherë do të kishim mbi 10 mijë qytetarë të prekur nga kjo vendimmarrje. Kjo shifër e parë në harmoni edhe me numrin e qytetarëve të tjerë të prekur nga vendimmarrjet e paligjshme të qeverisë dhe bashkive socialiste ndikon në mënyrë thelbësore në rezultatin e zgjedhjeve dhe ndarjen e mandateve.
179. Në këtë kuptim është e qartë se nxjerrja e vendimeve për dhënien e dëmshpërblimit familjeve të prekur nga tërmeti në periudhën 4 muaj para zgjedhjeve është në shkelje flagrante të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3 të Vendimit Nr. 9/2020 të KQZ-së. Këto shkelje të rënda, të kryera në mënyrë të përsëritur nga Bashkia socialiste në Qarkun Tiranë kanë cënuar procesin zgjedhor, duke ndikuar qartësisht në vullnetin e votuesve, e për rrjedhojë në ndarjen e mandateve. Kjo do të thotë që në këtë rast përmbushen katërcipërisht kushtet ligjore për shpalljen e pavlefshmërisë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku i Tiranës.
180. **Së treti**, dhënia e një page shtese nga drejtuesi politik i PS, Ardian Cela për **13 mijë punonjës** të OSHEE është po ashtu në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 3 të Vendimit Nr. 9/2020 të KQZ-së. Për numrin e saktë të punonjësve të OSHEE në Qarkun e Tiranës që kanë përfituar nga ky vendim, ne do të kërkojmë marrjen e informacionit zyrtar si provë, por megjithatë nuk ka dyshim se numri i punonjësve që përfaqësojnë familje të tëra, rreth familjar apo miqësor, ka ndikuar thelbësisht në rezultatin zgjedhor. Në këtë kuptim, edhe kjo vendimmarrje në shkelje të ligjit, përmasat reale të të cilës do të zbulohen gjatë hetimit administrativ, ka cënuar rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejt në ndarjen e mandateve, cka e bën kërkesë për shpalljen e pavlefshmërisë disafish të bazuar në ligj e në prova.
181. **Së katërti**, një nga veprimtaritë e paligjshme, e përdorur masivisht nga ministra dhe deputetë të Partisë Socialiste është edhe dhënia e ndihmave ushqimore familjeve në nevojë apo atyre

nga komuniteti rom. Kjo veprimtari, e cila sigurisht është blerje vote, por jo nëpërmjet të hollave, por të mirave materiale, vjen në kundërshtim flagrant me nenin 78 të Kodit Zgjedhor. Përmasat reale të këtij fenomeni në terma numerikë janë të vështirë të maten, por duke parë numrin e fakteve dhe grup-fakteve që ekzistojnë për këtë fenomen, shtrirjen e tij në cdo cep të Qarkut Tiranë, ajo ka ndikuar drejtpërdrejt në tjetërsimin e vullnetit të qytetarëve, vecanërisht në ato zona apo familje, ku varfëria është ekstreme.

182. Kjo shkelje flagrante e ligjit duhet parë në harmoni me shkeljet e tjera, për të konkluduar se ndikimi i saj në rezultatin përfundimtar dhe ndarjen e mandateve ka qenë i një rëndësie të tillë, sa i mjafton KAS-it për të konkluduar lidhur me pavlefshmërinë e zgjedhjeve në Qarkun Tiranë dhe përsëritjen e zgjedhjeve. Ky fenomen përvecse i ndaluar ligjërisht, është mjaft i shëmtuar edhe moralisht. Të shfrytëzosh varfërinë dhe pamundësinë e njerëzve për të blerë vullnetin e tyre, të mishëruar nëpërmjet votës, është një akt i ulët moral, nga i cili distancim dhe ndëshkim. Aq më tepër kur këtë e bëjnë politikanë, deputetë a ministra, të cilët janë drejtpërdrejtë përgjegjës për gjendjen e varfërisë, ku ndodhen ata njerëz. Në këtë sens, kjo nuk duhet parë vetëm *stricto sensu* si një çështje ligjore. Ajo duhet parë edhe si një çështje parimesh në një shoqëri demokratike, si një çështje morali. Ligji pa moral shndërrohet në një mjet arbitrar dhe shtypës, ndaj vlerësimi për paligjshmërinë, pavlefshmërinë e për rrjedhojë përsëritjen e zgjedhjeve parlamentare të 25 prill 2021, duhet të trajtohet si një çështje ligjore sigurisht, por edhe si një çështje ku e drejta e votës duhet të garantohet thelbësisht dhe ku cdo cënim i saj është i dënueshëm.

183. **Konkluzion:** Nga sa më sipër, është e qartë se ndërtimi i një skeme kriminale, e shtrirë në mënyrë kapilare në të gjithë Qarkun e Tiranës për blerjen e votës, nëpërmjet përfshirjes të personave me rekorde të tmerrshme kriminale, përbën shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor, duke cënuar rëndë procesin zgjedhor, e për rrjedhojë duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Nga ana tjetër, skema e shpërndarjes së parave mbi 2.500 familjeve të prekura nga tërmeti nga Bashkia Rrogozhinë përgjatë periudhës zgjedhore, e cila ka ndikuar minimalisht **mbi 10.000 qytetarë**, dhënia e një page shtesë për 13 mijë punonjës të OSHEE-së, dhënia e ndihmave ushqimore, grante e fonde të posacme, lejimi për të ndërtuar pa leje etj., të gjitha në shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të tij, kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor. Dhënia e përfitimeve në të holla apo të mira materiale nga buxheti i shtetit apo nëpërmjet burimeve të paligjshme ka synuar manipulimin e vullnetit të zgjedhësve në favor të PS-së. Megjithatë, përmasat reale të numrit të zgjedhësve që kanë përfituar nga skemat e

paligjshme të ngritura nga institucionet publike, qendrore apo vendore, do të zbulohen gjatë hetimit administrativ, në cdo rast është e qartë se shkeljet flagrante të ligjit, dhe në vecanti të neneve 78 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, të kryer nga zyrtarë të lartë drejtues të PS-së kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor, duke sjellë edhe ndryshimin e rezultateve zgjedhore dhe ndarjen e mandateve në Qarkun e Tiranës, cka në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, sjell detyrimisht pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore.

A.2 Shkeljet ligjore lidhur me përdorimin e burimeve shtetërore nëpërmjet kontratave publike, investimeve publike/rindërtimit, intimidimi dhe përdorimi i paligjshëm i administratës, punësimet në administratën publike, dhënia e lejeve të legalizimit/ndërtimit, kërcënimi/dhuna ndaj votuesve dhe transferimi i paligjshëm i gjendjes civile:

184. Një nga parimet kryesore të proceseve zgjedhore në shtetet demokratike është barazia ndërmjet palëve në garë. Ky parim është sanksionuar në nenin 1, pika 3 të Kushtetutës, i cili parashikon se qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira dhe të barabarta. Por, një nga sfidat kryesore për të arritur barazinë e partive politike në garë mbetet fakti se partia në pushtet, mund të përdorë burimet e shumta që ofron shteti për t'i vënë në funksion të maksimizimit të votës së saj. Me qëllimin eliminimin apo reduktimin e këtij rreziku, që do të minonte garën ndërmjet palëve, shtetet kanë implementuar rregulla të shumta që ndalojnë një sërë veprimtarish të qeverisë dhe parlamentit në periudhën përpara zgjedhjeve.
185. Shqipëria, si një vend me probleme të shumta sa i përket zgjedhjeve, vecanërisht në 10 vitet e fundit, ka vuajtur vazhdimisht nga përdorimi i shfrenuar i burimeve publike nga partia në pushtet, me qëllim të vetëm fitimin e votave nëpërmjet një sërë mekanizmash që ka nën kontroll cdo qeveri gjatë ushtrimit të pushtetit. Për të frenuar përdorimin e burimeve publike dhe me qëllimin krijimin e rregullave të barabarta të garës, legjislatori shqiptar ka miratuar një sërë ndryshimesh në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të tij, që ndalojnë shprehimisht kryerjen e një numri veprimtarish nga ana e qeverisë në periudhën katër muaj përpara zgjedhjeve dhe deri në formimin e qeverisë së re. Vecanërisht, ndryshimet e kryera në vitin 2020 në Kodin Zgjedhor u fokusuan thuhetse tërësisht në adresimin e kësaj problematike, nisur nga përvoja shumë problematike e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017.

186. Konkretisht, neni 78 i Kodit Zgjedhor parashikon ndalimin e zhvillimit të fushatës zgjedhore në institucionet publike. Më tej, ky nen parashikon ndalimin e partive ose kandidatëve për të premtuar vende pune apo favorizime të tjera, me qëllim votimin në një mënyrë të caktuar. Ndërsa, neni 91 parashikon ndalimin e vënies në mbështetje të kandidatëve, partive ose koalicioneve të burimeve të organeve apo enteve publike, në nivel qëndror apo vendor, si dhe cdo burimi njerëzor. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet përdorimi i detyruar i administratës shtetërore në zgjedhje ose ofrimi i përfitimeve për nëpunësit që angazhohen në zgjedhje. Pika 3 e këtij neni ndalon marrjen në punë, pushimin, lirin, lëvizjen dhe transferimin në detyrë në fushatë zgjedhore. Ndërsa, pika 4 parashikon ndalimin katër muaj para zgjedhjeve të nxjerrjes së akteve ligjore apo nënligjore që parashikojnë dhënie përfitimesh, rritje pagash, pensionesh, mbështetje ekonomike, sociale, ulje/heqje taksash, amnisti, privatizim, dhënie pasurish/shpërblimesh etj.
187. Përcaktimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor u detajuan më tej në Vendimin Nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, i cili parashikon shprehimisht se çfarë konsiderohet veprimtari të ndaluara për t'u promovuar, veprimtari të ndaluara në përgjithësi dhe ndalimet e posacme sa i përket administratës shtetërore. Qartazi, qëllimi i këtyre dispozitave është të bëjë një ndarje të qartë ndërmjet Shtetit dhe Partisë në pushtet. Kjo e fundit nuk duhet të shfrytëzojë pozicionin e saj, natyrisht më të favorizuar, për të fituar garën ndaj partive të tjera konkurrencte nëpërmjet mbështetjes shtetërore. Në të kundërt, funksionimi si Parti-Shtet do ta bënte garën thjesht një formalitet pa dobi.
188. Në rastin e zgjedhjeve parlamentare të 25 Prillit, sic kemi shpjeguar gjërësisht në pjesën e rrethanave të çështjes, faktuar me **45 prova** dhe me qëllim për të mos shmangur përsëritjet, del qartë konkluzioni që deklaroi shefja e Misionit të Vëzhguesve të OSBE/ODIHR, Znj. Ursula Gacek se **në zgjedhjet e 25 prillit nuk pati një kufi të qartë ndërmjet partisë dhe shtetit**. I njëjti shqetësim u adresuar në datën 7 maj edhe nga Misioni i SHBA në OSBE. E thënë me fjalë të tjera, Partia Socialiste u soll në fushatën zgjedhore si një Parti-Shtet, duke vënë në funksion të saj të gjithë mekanizmat shtetërorë me qëllim fitimin e zgjedhjeve.
189. **Së pari**, neni 3 i Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së ndalon mbështetjen dhe promovimin, në periudhën 4-mujore para datës së zgjedhjeve, të projekteve ose investimeve, me interes apo shtrirje territorial kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të cdo lloji, të energjetikës, telekomunikacionit, të veprave ujore të cdo lloji, në shërbim dhe interesit të publikut. Megjithatë në të paktën 20 raste në të gjithë vendin,

kryeministri, ministrat dhe deputetët promovuan projekte apo investime publike me qëllime të qarta elektorale. Por, rastet më flagrante të shkeljes së këtij aspekti të ligjit, kanë të bëjnë me rrugët e reja që u rregulluan apo shtruan gjatë fushatës zgjedhore. Sic kemi përshkruar gjërësisht në pjesën e provave, në të gjithë qarkun e Tiranës u shtruan rrugë, me qëllime të pastra elektorale. Ajo që e bën edhe më flagrante paligjshmërinë është fakti se për këto rrugë nuk pati procedura prokurimi publik, nuk pati transparencë, asnjëherë nuk u njoftua autoriteti kontraktor, fondi limit, vlera e kontratës, operatori ekonomik etj.

190. Promovimi i projekteve apo investimeve publike që do të kryhen në të ardhmen ka për qëllim të manipulojë vullnetin e zgjedhësit për të votuar në një mënyrë të caktuar. Këtë mundësi sigurisht nuk ka se si ta ketë partitë opozitare. Në këtë kuptim, përdorimi i një mekanizmi të tillë nga ana e Partisë në pushtet, minon shanset e barabarta që duhet të kenë palët në garë. Megjithatë, përmasat reale të kësaj shkeljeje të Kodit Zgjedhor, e cila sigurisht cënon rëndë procesin zgjedhor, është e vështirë të përcaktohen me terma matematikorë, ajo duhet pasur parasysh në momentin e vlerësimit të tërësisë së shkeljeve të ligjit që kanë cënuar procesin në një masë të tillë, sa të ndikojnë drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve.
191. **Së dyti**, neni 3 i Vendimit Nr. 9/2020 ndalon, gjithashtu, mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësisë natyrore. Megjithatë, në të paktën 100 raste në të gjithë vendin, kryeministri, ministrat, deputetët u shfaqën duke kryer vizita, dhënë celësa apo certifikata të objekteve të rindërtuara apo në ndërtim, pas shkatërrimit të tyre si rezultat i tërmetit të nëntorit 2019. Numri i saktë i objekteve të rindërtuara apo ndërtuara, për të cilat janë dorëzuar celësat apo dokumentet e pronësisë, në Qarkun e Tiranës, do të dalë nga provat e kërkuara për t'u marrë gjatë hetimit administrativ, megjithatë nuk ka dyshim se nisur nga aktivitetet e shumta të kryeministrit, ministrave dhe deputetëve numri i familjeve në Qarkun e Tiranës që kanë përfutur nga ndihma shtetërore gjatë kësaj periudhë është i konsiderueshëm dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin zgjedhor, e për rrjedhojë në ndarjen e mandateve. Shkelja e përcaktimeve të qarta të legjislacionit zgjedhor, duke përdorur ndihmën e dhënë nga buxheti i shtetit në rastin e një fatkeqësie natyrore, sic ishte tërmeti i 2019, cënon rëndë procesin zgjedhor, duke krijuar pabarazi të mëdha ndërmjet palëve në garë, cka më pas reflektohet edhe në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.
192. Paratë që Partia Socialiste, ministrat, deputetët, kryebashkiakët e saj nuk i ndanë drejtpërdrejtë i ndanë nëpërmjet fondeve të rindërtimit. Këtë e bënë duke përfshirë familje të shumta, herë

me meritë, e herë pa meritë, duke ndryshuar vlerën e dëmit sipas kategorive të ndryshme, dhe duke shpërndarë gjatë fushatës zgjedhore me miliona euro. Sic kemi përshkruar në pjesën e fakteve, vetëm në bashkinë Rrogozhinë u vendos në 12 prill për të përfshirë në skemën e fondit të rindërtimit mbi 870 familje, me një shumë totale rreth 3 milionë euro, e gjitha kjo në funksion të pastër të rritjes së mbështetjes për Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj. Në këtë kuptim, këto shkelje të rënda të ligjit zgjedhor, por edhe penal, cënuan rëndë procesin zgjedhor, shkatërruan barazinë ndërmjet palëve në garë, ndikuan drejtpërdrejtë në rezultatin e zgjedhjeve dhe shpërndarjen e mandateve.

193. **Së treti**, neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe neni 6 i Vendimit Nr. 9/2020 të KQZ-së përmbajnë rregullime të qarta sa i përket ndalimit të përdorimit apo detyrimit të administratës shtetërore për t'u përfshirë në fushatën zgjedhore në mbështetje të një kandidati apo partie politike. Megjithatë, gjatë gjithë fushatës u konstatuan raste të shumta, të denoncuar herë pas herë nga Partia Demokratike, se si të gjitha nivelet e administratës qendrore apo vendore ishin përfshirë në fushatë në mbështetje të kandidatëve të Partisë Socialiste. Nëpunësit civilë ishin nën presion të vazhdueshëm për të mbështetur kandidatët socialistë, në të kundërt mund të shkarkoheshin nga detyra.
194. Në disa raste, Partia Demokratike ka faktuar nëpërmjet provave të pakundërshtueshme se administrata qendrore dhe lokale u vu tërësisht në dispozicion të fushatës zgjedhore të Partisë Socialiste. Konkretisht, stafi i Bashkisë Tiranë, stafet e Ministrive, vecanërisht të Shëndetësisë dhe Energjisë/Industrië, ku kandidonin edhe ministret Manastirliu dhe Balluku, braktisën vendet e punës, duke punuar full-time për fushatën zgjedhore të PS-së. Një fakt i rëndësishëm për t'u pasur parasysh në këtë pikë është se shtabet elektorale drejtoheshin dhe përbëheshin nga punonjës të administratës së bashkive, ministrive, agjencive të varësisë dhe shoqërive aksionare, me pronësi shtetërore. Kushdo që kundërshtonte, kërcënohej me largim nga vendi i punës. Por, nën këtë veprimtari të paligjshme presionesh nuk u përfshinë vetëm punonjësit e administratës publike, por edhe familjarët e tyre. Nëpunësve u kërkohesh të sillnin lista me të paktën 30 deri në 50 votues që do të mbështesnin PS-në.
195. Këto dy shembuj janë ilustrime flagrante të shkrirjes në një të vetëm të strukturave shtetërore me strukturat partiake. Nëpunësit e administratës lokale dhe qendrore nuk konsiderohen nëpunës në shërbim të shtetit shqiptar, por si ushtarë që duhet t'i shërbejnë partisë, përndryshe i pret largimi nga puna. Këto shkelje flagrante të legjislacionit penal dhe zgjedhor, vecanërisht të dispozitave të sipërcituara, cënojnë rëndë procesin zgjedhor, pasi garën ndërmjet dy a më

shumë subjekteve zgjedhore, e kthejnë në një garë ndërmjet shtetit dhe një partie politike. Është e kuptueshme se një garë e tillë, tërësisht e shpërpjestuar, ka një fitues të paracaktuar. Prandaj, edhe në këtë rast është e qartë se shkeljet e rënda dhe flagrante të ligjit, përkatësisht nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 6 të Vendimit nr. 9/20 të KQZ, kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor, dmëtuar barazinë ndërmjet palëve garuese dhe ndikuar drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar të Qarkut Tiranë dhe ndarjes së mandateve në këtë qark, duke plotësuar kështu kushtin e nenit 160 të Kodit Zgjedhor për konstatimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve.

196. **Së katërti**, neni 91, pika 3 e Kodit Zgjedhor dhe neni 3, pika 1.3, gërma “d” i Vendimit Nr. 9/2020 ndalojnë punësimet në administratën publike në periudhën 4 muaj para zgjedhjeve. Megjithatë, sipas të dhënave zyrtare të INSTAT, midis tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020, punësimi në sektorin publik është rritur me 6 për qind ose me 10.572 persona. Ndërkohë, më 24 Dhjetor, qeveria autorizoi edhe krijimin e 2.472 pozicione të reja në administratën publike. Qartësisht, punësimet në administratën publike në periudhën zgjedhore, kur nuk diktohen nga nevoja të ngushtshme, kanë për qëllim të përkthehen në mbështetje dhe vota për partinë në pushtet. Vetëm në periudhën dhjetor 2020 – mars 2021, Bashkia Kamëz e coi numrin e të punësuarve në 1.003 punonjës rishtazi. Pati denoncime se Belinda Balluku kishte ndërhyrë për të punësuar mbi 150 punonjës në drejtorinë e arkivit. Ndërkohë, ministrja e Shëndetësisë, Manastirliu, po ashtu kandidatë e PS, kërkonte me email që t’i dërgoheshin propozime për vendet vakante. Bashkia Rrogozhinë nga ana tjetër e rriti administratën e saj me 227 të punësuar rishtazi.
197. Numri i saktë i të punësuarve në Qarkun e Tiranës dhe sa prej pozicioneve të reja parashikohen të krijohen në këtë qark, do të dalë pas marrjes së provave gjatë hetimit administrativ, megjithatë është e qartë se kjo praktikë e qeverisjes qendrore dhe vendore, në Tiranë apo kudo në Shqipëri, ka një qëllim të qartë si drita e diellit: tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve nëpërmjet ofrimit të përfitimeve të drejtpërdrejta. Këto shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të tij, që kanë synuar vazhdimisht të ndalojnë administratën të rrisë numrin artificialisht numrin e të punësuarve në kohë zgjedhore cënojnë rëndë procesin zgjedhor, duke sjellë deformim të vullnetit të zgjedhësve, me ndikim të konsiderueshëm në rezultatin përfundimtar në zonën zgjedhore përkatëse, e për pasojë edhe në ndarjen e mandateve.
198. Në këto kushte, pasi të administrohen provat shtesë që faktojnë përmasat reale të kësaj skeme të paligjshme në administratën qendrore dhe bashkitë e Qarkut Tiranë, do të dalë qartë se

- hapja e vendeve të punës në administratën publike nga ana e Qeverisë Socialiste është një shkelje e rëndë e nenit 91, pika 3 e Kodit Zgjedhor dhe neni 3, pika 1.3, gërma “d” i Vendimit Nr. 9/2020 e përmasave të tilla që ka ndikuar në shpërndarjen e mandateve për këtë qark. Kështu, duke qenë se përmbushet kushti i parashikuar në nenin 160 të Kodit Zgjedhor, KAS-i duhet të vendosë konstatimin e paligjshmërisë, shpalljen e pavlefshmërisë dhe përsëritjen e zgjedhjeve, me synim garantimin e një procesi zgjedhor të lirë, të ndershëm dhe të barabartë.
199. **Së pesti**, neni 3, pika 1.3, gërma “a” parashikon ndalimin e veprimtarive publike të cilat konsistojnë në shpërndarjen e lejeve të legalizimit në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve. Megjithatë, sic kemi relatuar në pjesën e fakteve, Partia Demokratike disponon prova dhe foto të deputetëve të Partisë Socialiste, të cilët në të paktën 9 raste shpërndajnë leje legalizimi në periudhën e ndaluar nga Kodi Zgjedhor, me qëllim të pastër elektoral. Ndërsa disa raste flagrante të denoncuar në SPAK nga PD dëshmojnë për përmasat reale të këtij problemi.
200. Konkretisht, në 12 prill, Partia Demokratike kallëzoi në SPAK një skemë kriminale të ngritur në zonën e Kombinatit nga kandidatja për deputete, njëkohësisht Ministre e Energjisë dhe Infrastrukturës, Belinda Balluku, e cila së bashku me këshilltaren e saj, kishin ngritur një grup në whatsapp, ku pasi merrnin informacione nga terreni lidhur me familjet që kishin probleme me lejen e legalizimit apo certifikatën e pronësisë, dërgonin specialistët e Kadastrës të kryenin matjet dhe më pas me procedurë të përshpejtuar siguronin dokumentin e pronësisë. Në këtë skemë përfshiheshin, sic kemi përshkruar në pjesën e fakteve, zyrtarë të lartë shtetërore, duke filluar nga ministrja, anëtarët e kabinetit të saj në ministri, drejtuesit lokalë të Agjencisë së Kadastrës etj. Një formë e tillë tjetërsimi të vullnetit të zgjedhësve, e ngritur në sistem, nuk mund të krijojë qoftë edhe iluzionin se zgjedhjet e 25 prillit ishin të lira, të barabarta apo të ndershme.
201. Ndërsa, në 20 Prill, si për t’i vënë vulën përdorimit masiv që po i bëhej dokumenteve të pronësisë (leje legalizimi, certifikata pronësie etj.), u publikua një audiopërgjim i drejtorit të përgjithshëm të Kadastrës, Artan Lame, i cili u kërkonte vartësve të tij të pezullonin procedurat për 100.000 kërkesa për leje legalizimi, të cilat do të refuzoheshin për shkak se mund të votonin partinë kundërshtare. Ndërkohë për 60.000 kërkesa të tjera, drejtori Lame kërkon përshpejtimin e procedurës, në mënyrë që kjo të përkthehej në mbështetje për Partinë Socialiste. Përdorimi i lejeve për legalizim në këmbim të votave në favor të PS-së u evidentua edhe në Raportin e OSBE/ODIHR (shih fq. 13).

202. Nga të dhënat e mësipërme, kuptohet se bëhet fjalë për një numër shumë të madh kërkesash për leje legalizimi, rreth 160.000, të cilat aktualisht po trajtohen nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për të gjithë vendin. Kjo do të thotë që impakti që ka ky proces në jetën e qytetarëve është shumë i madh. Ai lidhet me një nga të drejtat themelore që ka cdo qytetar, e drejta e pronës. Në këtë kuptim, përdorim i lejeve të legalizimit, qoftë dhënia e tyre apo shtyrja në kohë për t'ua refuzuar kërkesën eventualisht, përbën një shkelje skandaloze të ligjit. Kjo porosi e ardhur nga drejtuesi më i lartë i Agjencisë së Kadastrës dhe më pas e shpërndarë në mënyrë kapilare te drejtuesit vendorë, tregon për përmasat reale që ka pasur ky fenomen përgjatë zgjedhjeve të 25 Prillit. Por, jo vetëm ministria Balluku apo drejtori Lame, u përfshi në skandalin me legalizimet apo certifikatat e pronësisë, ministria Manastirliu dhe deputeti Ulsi Manja ngritën skema të mirëfillta korruptive dhe të paligjshme të premtim-shpërndarjes së lejeve të legalizimit. Të gjitha këto fenomene, të faktuara katërcipërisht, u kallëzuan nga PD në SPAK, me shpresën e një reagimi efektiv, i cili fatkeqësisht akoma nuk ka ardhur.
203. Numri i lejeve të legalizimit të shpërndara në Qarkun Tiranë përgjatë periudhës zgjedhore, do të dalë nga provat e marra gjatë hetimit administrativ, por edhe me provat që ne kemi në dispozicion deri më tani provohet qartësisht se kjo veprimtari e paligjshme ka cënuar rëndë procesin zgjedhor, duke diktuar vullnetin e qytetarëve, e për pasojë rezultatin e zgjedhjeve dhe ndarjen e mandateve. Ashtu, si shkeljet e tjera të analizuara më lart, edhe këto shkelje, duhen vlerësuar në tërësinë e tyre për pasojat e rënda që kanë sjellë mbi procesin zgjedhor, të cilat për nga ndikimi i tyre, e bëjnë procesin në tërësi të pavlefshëm dhe diktojnë përsëritjen e zgjedhjeve në kushte të ligjshme dhe të barabarta për të gjitha palët.
204. **Së gjashti**, përdorimi i shtetit dhe mekanizmave të tij në funksion të një partie politike nuk nënkupton vetëm trajtimin “me dashuri”, sic shprehet këshilltarja e Ministres Balluku, Laureta Omeri, shpeshherë këto mekanizma përdoren edhe si formë represive apo arbitrare ndaj qytetarëve, bizneseve, mediave etj. Konkretisht, qeveria përdori inspektimet apo kontrollet, deri në gjoba për të ushtruar presion ndaj bizneseve, e vecanërisht ndaj atyre që mbështesnin Partinë Demokratike. Nga ana tjetër, oficerë policie përdorën pozicionet e tyre zyrtare për të kërcënuar personat me procedime apo arrestime, vetëm e vetëm për të penguar ushtrimin e të drejtës së votës në mënyrë të lirë. Në raste të tjera, sic kemi përshkruar në pjesën e fakteve persona publikë dhe privatë, u bënë bashkë, duke ushtruar presion, kërcënime e deri në dhunë ndaj mbështetësve të Partisë Demokratike, me qëllimin e vetëm për të mos i lejuar të angazhohen lirisht në mbështetje të këtij subjekti zgjedhor. Ushtrimi i pushtetit në mënyrë

arbitrare dhe represive, me qëllim ndikimin e zgjedhësve është në kundërshtim të hapur me nenin 45 të Kushtetutës, nenin 3 të Prokollit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 3 të Vendimit Nr. 9/2020 të KQZ-së, cka cënon rëndë procesin zgjedhor, deri në masën sa ndikon në ndarjen e mandateve, e për rrjedhojë sjell pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve.

205. **Së shtati**, një nga rastet më flagrante të abuzimit me burimet shtetërore ka të bëjë me rastet kur institucionet shtetërore dhe zyrat partiake shkrihen në një të vetme, ku të parat i lejojnë të dytave të përvetësojnë kompetencat e tyre kushtetuese dhe ligjore. Konkretisht, skema e ngritur nga Erion Veliaj dhe Blerina Gjylameti në Yzberisht, ku në zyrat e Partisë Socialiste mund të bëhej ndryshimi i gjendjes civile përbën një rast të paprecedentë. PS, jo vetëm mori nga shteti të dhënat personale të qytetarëve për qëllime zgjedhore, në kundërshtim me nenin 35 të Kushtetutës, nenin 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, por filloi të përdorë sistemet e institucioneve shtetërore i.e. gjendja civile për qëllimet e saj elektorale. Vetëm në zonën e Yzberishtit, në një periudhë 4-mujore, popullsia u rrit nga 8.000 në 22.000 mijë banorë. 14 mijë banorë të rinj vetëm në një zonë sigurisht ka një ndikim të konsiderueshëm mbi rezultatin zgjedhor, e për rrjedhojë në ndarjen e mandateve.

206. **Konkluzion**: Nga sa më sipër, është e qartë se parimi i barazisë ndërmjet palëve garuese në zgjedhje u cënua rëndë pasi Shteti dhe Partia në pushtet (PS) u shkrinë në një. Zyrat elektorale të Partisë Socialiste u kthyen në “institucione shtetërore” ku qytetarët duhet të paraqiteshin për t’u punësuar, për të marrë leje legalizimi, për të marrë dëmshpërblimin nga tërmeti, celësat apo dokumentet e shtëpisë së ndërtuar, për të transferuar gjendjen civile etj. Shteti dhe Partia Socialiste, në koordinim dhe bashkëpunim me njëra-tjetrën i vendosën të gjithë mekanizmat shtetërorë në funksion të manipulimit të vullnetit të zgjedhësve. Projektet dhe investimet publike, shtëpitë e ndërtuara apo rindërtuara pas tërmetit, punonjësit e administratës, punësimet e reja në administratë, lejet e legalizimit, certifikatat e pronësisë, inspektoriatet, gjendja civile u vunë në dispozicion të plotë të Partisë, kryeministrit, ministrave dhe deputetëve, me qëllim për të fituar me cdo kusht zgjedhjet (shih fq. 2, 3 dhe 12 të Raportit Paraprak të OSBE/ODIHR; shih Deklaratën e Misionit të SHBA në OSBE). Ky përdorim masiv i burimeve shtetërore, përveçse një veprimtari e paligjshme, e cila duhet hetuar dhe dënuar nga organet e drejtësisë, është në shkelje flagrante të neneve 78, 91, 92 të Kodit Zgjedhor dhe neneve 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së,

cka ka cënuar rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në vullnetin e zgjedhësve, rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve dhe ndarjen e mandateve në Qarkun e Tiranës.

207. Paligjshmëria e ngritur në sistem nga institucione, drejtues institucionesh, zyrtarë të lartë, përfaqësues të pushtetit qendror dhe vendor, në bashkëpunim me elementë të krimit të organizuar, dikton domosdoshmërisht shpalljen e pavlefshmërisë së këtyre zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre në kushte normale në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, ku palët garojnë në mënyrë të ndershme dhe të barabartë, ndërsa qytetarët mund të zgjedhin me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Shqipërisë.

A.3 Shkeljet ligjore lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale:

208. Neni 35 i Kushtetutës parashikon se mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Neni 8 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut parashikon se “Cdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.”. Ndërsa, neni 6 i ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” parashikon se të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin, dhe neni 7 përcakton se ndalohet përpunimi i të dhënave sensitive ku përfshihen edhe mendimet politike, me përjashtim të rastit kur këtë e kërkon interesi publik.
209. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i të dhënave personale të 910 mijë votuesve, ku përfshihen të dhëna tejet personale si numri ID, vendbanimi, numri i telefonit, bindja politike, vendi i punës është në shkelje flagrante të dispozitave të sipërcituara. Origjina etnike, bindjet, anësia politike, ose pjesëmarrja në shoqata apo sindikata parashikohen edhe si të dhëna sensitive nga neni 3 § 2 i ligjit 9887 (shih edhe *Catt k. Mbretërisë së Bashkuar* § 112, dhe *S. and Marper k. Mbretërisë së Bashkuar* § 66). Këto shkelje të rënda të ligjit janë kryer nga drejtues, zyrtarë, përfaqësues dhe mbështetës të Partisë Socialiste, të ashtuquajturit “patronazhistë”, të cilët kryeministri në mënyrë të përsëritur i ka falënderuar për fitoren. Madje, pavarësisht se kjo skemë u zbulua plotësisht vetëm në Tiranë, kryetari i PS-së, Edi Rama dhe sekretari i përgjithshëm, Taulant Balla kanë pranuar se një skemë e tillë përdoret në të gjithë vendin nga strukturat e PS-së. Ky fakt u provua edhe nga denoncimi i bërë nga kryetarja e LSI, Znj. Monika Kryemadhi për qarkun e Durrësit ku dolën në pah të dhënat personale për 350 mijë

zgjedhës. Posedimi në mënyrë të paligjshme i të dhënave personale të qytetarëve, të marrë nga serverat shtetërorë, i bëri zgjedhësit vulnerabël përballë pushtetit, duke i dhënë mundësi PS të ushtronte kontroll mbi këta zgjedhës (shih fq. 2 dhe 12 të Raportit Paraprak të OSBE/ODIHR).

210. **Konkluzion:** Nga sa më sipër, është e qartë se Partia Socialiste, drejtuesit, përfaqësuesit, strukturat, shtabet qendrore, zyrat elektorale morën nga serverat shtetërorë të dhënat personale të qytetarëve me qëllim përdorimin e tyre për t'i bërë qytetarët më vulnerabël dhe eventualisht për të kontrolluar vullnetin e tyre gjatë fushatës zgjedhore dhe në ditën e votimit. Ky krim i shumëfishtë, me përmasa ndërkombëtare, përbën një rast flagrant se si shteti i vë në dispozicion Partisë infrastrukturën e tij për të fituar zgjedhjet. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i të dhënave të 910 mijë qytetarëve në Tiranë dhe 350 mijë qytetarëve në Durrës, për të cilat askush deri më sot nuk ka dalë të thotë që ka dhënë pëlqimin e tij për mbledhjen, përpunimin apo publikimin e tyre (shih *Radu v. Moldavia, 2014*), pra në mënyrë krejtësisht të kundërligjshme, cënoi rëndë procesin zgjedhor të 25 Prillit.
211. Duke qenë se Shteti dhe Partia ishin të pajisur me informacion për secilin zgjedhës, përfshirë edhe bindjet e tyre politike, kjo i bëri më vulnerabël përballë pushtetit dhe më lehtësisht viktimë e presioneve apo mjeteve të tjera të kundërligjshme për të ndaluar të shprehin vullnetin e tyre lirisht. Disa nga këto forma që përdori Partia-Shtet ishte blerja e votuesve që mbështesnin opozitën, marrja e kartave të identitetit për të mos votuar, kërcënimi për të mos dalë në fushatë, kërcënime për largime nga puna të zgjedhësit apo të afërmit të tij, inspektime dhe paralajmërime për mbyllje biznesi apo dërgimi i mesazheve të personalizuar, sic kemi përshkruar në rastin e Spartak Brahos. Të gjitha këto shkelje të rënda të Kushtetutës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kodit Zgjedhor, ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, cënuan rëndë procesin zgjedhor të 25 prillit, duke ndikuar drejtpërdrejtë mbi rezultatin e zgjedhjeve dhe ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore, në shkelje flagrante të nenit 160 të Kodit Zgjedhor. Për këtë shkak, i vetmi mjet ligjor për të garantuar rikthyer besimin e qytetarve te sistemi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme është përsëritja e tyre në këtë zonë zgjedhore.

A.4 Shkeljet ligjore lidhur me mohimin e të drejtës për të votuar të emigrantëve:

212. E drejta e cdo qytetari shqiptar për të votuar është e sanksionuar në nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e cila citon se *“1. Cdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.”* Ndërkaq ajo është edhe një nga të drejtat themelore të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut përkatësisht e parashikuar në nenin 3, Protokolli 1 i cili citon se: *“Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjet e organit ligjvënës.”*
213. Ashtu sic kemi përmendur edhe në rrethanat e çështjes të këtij ankimi, në datën 19 Prill 2021, me anë të Urdhërit nr. 219 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Civile kjo e fundit urdhëroi të gjithë shtetasit që hyjnë në Shqipëri përmesë rrugëve ajërore, tokësore dhe detare nga këto dy shtete të vetëkarantinohen në mënyrë të detyrueshme nga data 20 Prill 2021 deri në datën 03.05.2021. Pra vetëm 6 ditë përpara organizimit të zgjedhjeve, shtetasit shqiptar të cilët vendbanojnë në Maqedoni dhe Greqi u ndaluan nga marrja pjesë në zgjedhje. Në total, sipas të dhënave të institutit për vitin 2020, në Greqi dhe Maqedoni banojnë rreth rreth 500,000 votues (pra të moshave mbi 18 vjeç).
214. Praktika gjyqësore e GJEDNJ, përkatësisht vendimet si *Hirst v. Mbretëria e Bashkuar, Aziz v. Qipro, Tanase v. Moldavia, Libita v. Italy, Sitaropoulos dhe të tjerë v. Greqi*, etj, në lidhje me votimin e emigrantëve jashtë kufijve ka vendosur dy parime kryesore si vijon: (i) E drejta e emigrantëve për të votuar në vendin e tyre të rezidencës nuk është një detyrim që lind nga neni 3 i Protokollit 1 të Konventës por ky i fundit mund të jetë i aplikueshëm vetëm nëse ka një detyrim mbi shtetin që buron nga ligji i brendshëm (ii) Gjykata është në vecanti e vëmendëshme për rastet kur është mohuar e drejta e votës në tërësi. Ky kufizim absolut duhet të arrijë një qëllim të ligjshëm (legitimate aim) por gjithashtu të kalojë testin e proporcionalitetit (stringent proportionality test)."
215. Në rastin e Shqipërisë, në shtesë të nenit 45 të Kushtetutës, neni 24 dhe 25 i Kodit Zgjedhor, sipas ndryshimeve të fundit të datës 23.07.2020, ka parashikuar shprehimisht të drejtën e votimit për emigrantët shqiptar në vendin e tyre të rezidencës. Kështu, garantimi i kësaj të drejte për të gjithë emigrantët është një detyrim, i cili buron nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor dhe për rrjedhojë në referim të parimit të parë relatuar më sipër, mohimi i të drejtës së emigrantëve për të votuar në vendin e tyre të rezidencës është një shkelje e nenit 45 të Kushtetutës, neneve 24, 25 të Kodit Zgjedhor dhe rrejdhimisht edhe e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Nga ana tjetër, përsa i parimit të dytë të gjyktës në çështjen *Sitaropoulos dhe të tjerë*, kjo e fundit

argumentoi se kufizimi që emigrantët të votonin në Greqi dhe jo nga vendi i tyre i residencës ishte një kufizim proporcional dhe e drejta e tyre nuk u mohua në tërësinë e saj.

216. **Konkluzion:** Në zgjedhjet parlamentare të 25 Prill 2021, është e qartë se jo vetëm nuk lejohen shtetasit shqiptar me residencë jashtë Shqipërisë që të votojnë në vendbanimin e tyre (detyrim ky ligjor sic e kemi analizuar edhe më sipër), por efektivisht e drejta për të votuar të shtetasve shqiptar resident në Greqi dhe Maqedoni është mohuar në tërësinë e saj pasi këta të fundit për shkak të karantinimit të detyruar nuk u lejuan që të votonin as duke u kthyer përkohësisht në Shqipëri. Kështu, një masë e tillë është tërësisht jo proporcionale dhe në shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1. Këto shkelje të Kushtetutës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që sollën mohimin e të drejtës për të votuar të mbi 500 mijë qytetarëve me të drejtë vote. Diferenca në përqindje ndërmjet subjekteve zgjedhore është shumë herë më e ulët se përqindja e votuesve që jetojnë jashtë vendit apo vecanërisht në Greqi/Maqedoni të Veriut, të cilëve iu mohua e drejta për të votuar. Kjo çënoi rëndë procesin zgjedhor në tërësinë e tij, dhe sigurisht me një impakt të drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve, pasi mbi 500 mijë zgjedhës potencialë, mund të kishin përcaktuar jo vetëm rezultatin në zonën zgjedhore të Qarkut Tiranë, por në të gjithë Shqipërinë.

A.5 Shkeljet ligjore lidhur me mohimin e të drejtës për të votuar të infektuarve me COVID-19:

217. Ashtu sic është shpjeguar më lart, neni 45 i Kushtetutës dhe neni 3, Protokolli 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut garantojnë të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur të cdo shtetasi që ka mbushur moshën madhore. Rastet e vetme përjashtimore nga kjo e drejtë janë parashikuar shprehimisht nga neni 45 i Kushtetutës, përkatësisht shtetasit e deklaruar të paaftë, shtetasit e dënuar me burgim për një kategori krimesh, shtetasit e dëbuar për një krim ose cënim shumë të rëndë të sigurisë publike. Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor nuk parashikon përjashtime të tjera nga e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.
218. Në rastin konkret, personave të infektuar me COVID-19 iu mohua e drejta për të votuar për shkak të detyrimit për të qëndruar të karantinuara. Asnjë mundësi alternative nuk u parashikua për këta persona, qoftë nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve apo Ministria e Shëndetësisë, duke sjellë kështu cënimin e të drejtës së tyre. Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së

Shëndetësisë, numri i personave të infektuar me COVID-19 në ditën e zgjedhjeve ishte 22.431 persona ku vetëm në Qarkun e Tiranës 17297 raste të tilla.¹

219. **Konkluzion:** Mohimi kategorikisht i të drejtës për të votuar i personave të infektuar me COVID-19 përbën efektivisht shkelje të së drejtës së tyre. Sic ka konkluduar Misioni i OSBE/ODIHR në raportin e tij paraprak kjo praktikë bie ndesh përkatësisht me dispozitat për drejtat e votimit dhe barazinë e votës të parashikuar në nenin 45 të Kushtetutës dhe me paragrafin 7.2 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 të OSBE-së (shih fq. 8 të Raportit paraprak të OSBE/ODIHR). Ashtu si edhe në rastin e emigrantëve është e qartë se këto cënime të rënda të procesit zgjedhor mund të ndreqen vetëm me një vendimarrje pavarëshmërie dhe përsëritjen e zgjedhjeve. Tej atyre parashikimeve që përmban Kushtetuta dhe ligji, askujt tjetër nuk mund t'i mohohet e drejta thelbësore për çdo shoqëri demokratike, për të zgjedhur përfaqësuesit e tij/saj. Numri total i zgjedhësve në Qarkun e Tiranës, të infektuar me COVID-19, në ditën e zgjedhjeve, është më shumë se numri i votave të kërkuara për një mandate deputeti, për pasojë mohimi tërësisht i të drejtës së këtyre qytetarëve për të votuar përbën një shkelje të rëndë të ligjit, e cila në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, ka ndikim në rezultatin e zgjedhjeve dhe në ndarjen e mandateve. Për rrjedhojë, zgjedhjet në këtë zonë zgjedhore duhet të shpallën të pavlefshme dhe të përsëriten.

A.6 Shkeljet ligjore lidhur me pavarëshmërinë e fletëve të votimit dhe diskriminimin e kandidatëve:

220. **Së pari,** neni 98 i Kodit Zgjedhor parashikon se fleta e votimit duhet të respektojë kushtin që fleta e votimit të mos jetë tejet e ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer. Ndërsa, pika 27 e Kodit të Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias parashikon se zgjedhësit duhet të kenë mundësi të hedhin votat e tyre për listat e regjistruara ose për kandidatët, gjë që do të thotë se atyre duhet t'u vihen në dispozicion fletët e votimit me emrat e kandidatëve, dhe ata duhet të kenë mundësi të hedhin fletët e votimit në kutitë e votimit.
221. Në fakt, ashtu sic kemi relatuar në pjesën e fakteve, në datën 31 Mars, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi fletën e votimit me emrat e kandidatëve për deputetë, në përpunje me

¹ [https://ëëë.ishp.gov.al/komunikimi-i-perditshem-per-koronavirusin-25-prill-2021/;](https://ëëë.ishp.gov.al/komunikimi-i-perditshem-per-koronavirusin-25-prill-2021/)

parimet e nenit 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikës 27 të Kodit të Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore për të mundësuar orientimin sa më të lehtë të votuesve për të votuar subjektin zgjedhor që dëshironin dhe kandidatin e preferuar. Por, ky vendim u ndryshua nga KAS-i dhe Kolegji Zgjedhor, cka solli që numri i fletëve të votimit të pavlefshme të arrinte në 83.028 vota ose 5% e numrit total të votuesve dhe ku vetëm në Tiranë një numër prej 18.399 vota të pavlefshme. Ky fakt u evidentua edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR sipas të cilit konfigurimi i fletës së votimit kontribuoi në krijimin e një konfuzioni në ditën e zgjedhjeve (shih fq. 7). Por, edhe në deklaratën e datës 28 Prill, Komisioneri Shtetëror pranoi se fleta e votimit kishte ndikuar në një numër shumë të lartë fletësh të pavlefshme.

222. **Së dyti**, neni 18 parashikon se të gjithë janë të drejtë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet pa një shkak të përligjur. Ndërsa, neni 45 garanton në mënyrë të barabartë të drejtën për t'u zgjedhur të cdo shtetasi të Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuptim, dhënia të drejtë vetëm e kryetarëve të partive për të kandiduar në katër zona zgjedhore, përbën një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues, në kuptim të dispozitave ligjore të sipërcituara. Ky fakt është konstatuar me të drejtë edhe nga raporti paraprak i OSBE/ODHIR, i cili shprehhet se ligji u lejon vetëm kryetarëve të partive, por asnjë kandidati tjetër, që të kandidojnë deri në katër zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta (shih fq. 2).
223. **Konkluzion**: Nga sa më lart, është e qartë se miratimi i një flete votimi në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga neni 98 i Kodit Zgjedhor dhe pika 27 e Kodit të Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore, solli një numër tejet të lart të fletëve të votimit, të cilat nëse do të ishin përkthyer në mandate mund të ndryshonin rezultatin nga 5 – 8 mandate në të gjithë Shqipërinë. Këto mandate mund të sillnin jo vetëm ndryshimin e rezultatit në qarqe të caktuara, ku diferenca ndërmjet palëve është e ngushtë, por edhe në rang kombëtar, kur dihet se partia e parë sipas rezultateve paraprake ka vetëm katër mandate më shumë se shumica e kërkuar për formimin e qeverisë. Nga ana tjetër, lejimi vetëm i kryetarëve të partive për kandiduar në katër zona zgjedhore, të cilat në lista janë të barabartë si të gjithë kandidatët e tjerë, përbën një diskriminim në të drejtën për t'u zgjedhur, në kuptim të neneve 18 dhe 45 të Kushtetutës.
224. Në tërësinë e tyre këto shkelje të ligjit shqiptar dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Në këto kushte, është e qartë se vendimet e marra në kundërshtim me nenin 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore, cënuan rëndë procesin

zgjedhor, duke diktuar një rezultat në shpërputhje me vullnetin e zgjedhësve, e për rrjedhojë edhe ndarjen e mandateve, dhe për rrjedhojë në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, ky proces zgjedhor në Qarkun Tiranë duhet të shpallet i pavlefshëm dhe të urdhërohet përsëritja e zgjedhjeve në këtë qark.

A.7 Shkeljet ligjore lidhur me votimin e dyfishtë, votimin për të tretët apo votimin familjar:

225. Sic kemi relatuar në kapitullin e rrethanave të çështjes (shih paragrafët 52 – 54), futja e identifikimit elektronik në Kodin Zgjedhor dhe aplikimi për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në 25 prill 2021 kishte si qëllime të qarta eliminimin e votimit të dyfishtë, votimit për të tretët apo votimin familjar. Votimi i dyfishtë nënkupton se i njëjti zgjedhës voton më shumë se një herë në të njëjtën qendër votimi apo qendra votimi të ndryshme. Votimi për të tretët, në kuptim të nenit 2, pika 29 e Kodit Zgjedhor, nënkupton rastet kur një zgjedhës voton në emër dhe për llogari të një zgjedhësi tjetër, i pranishëm ose jo në qendrën e votimit. Ndërsa, votimi familjar, sipas nenit 2, pika 30 e Kodit Zgjedhor, nënkupton rastet kur një pjesëtar i familjes, voton në emër dhe për llogari të pjesëtarëve të tjerë.
226. Të vetmet raste kur votimi për të tjerë është i lejuar, qofshin familjarë ose jo, janë ato të parashikuara nga neni 108 i Kodit Zgjedhor, kur zgjedhësi vetë është në pamundësi fizike për të ushtruar të drejtën e votës. Në këtë rast, ky zgjedhës mund të asistohet nga një familjar ose zgjedhës tjetër, votues në të njëjtën qendër votimi, për të votuar, duke nënshkruar një deklaratë të posacme. Pra, rastet kur një zgjedhës voton në emër të një zgjedhësi tjetër, në kushtet e nenit 108 sipërcituar, dokumentohen dhe mund të provohen lehtësisht. Në të gjitha rastet e tjera, votimi i dyfishtë, për të tretët apo familjarët, përveçse në kundërshtim flagrant me nenin 3, pika 4 që parashikon të drejtën e çdo zgjedhësi vetëm për një votë, përbën edhe vepër penale, të parashikuara nga neni 327/a të Kodit Penal.
227. Megjithatë, ashtu sic kemi parashtruar në pjesën e fakteve (shih paragrafin 53), nga informacionet e marra në terren nga strukturat e PD-së rezulton se persona të ndryshëm kanë votuar më shumë se një herë, qoftë për të tretë apo familjarë të tyre, duke shkelur kështu drejtpërdrejtë Kodin Zgjedhor. Nga ana tjetër, ekzistenca e këtij problemi u pranua edhe nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili në datën 6 maj njoftoi fillimin e procesit të kryqëzimit të dhënave për të konstatuar rastet e votimit më shumë se një herë në një qendër votimi apo qendra të ndryshme. Përmasat reale në numër zgjedhësish në zonën zgjedhore të

Qarkut të Tiranës do të dalin nga provat e kërkuara gjatë hetimit administrativ nga ana jonë. Thënë këtë, votimi i dyfishtë, votimi për të tretët ose familjarët, përbën shkelje të rëndë të ligjit, duke cënuar procesin zgjedhor në atë masë sa që mund të ndikojë në ndarjen e mandateve. Votimi i një personi në emër të tretëve apo familjarëve i bën zgjedhjet e pavlefshme. Votimi i një personi për të tjerët cënon parimin e votës vetjake, parashikuar në nenin 45/4 të Kushtetutës (shih Vendimin nr. 169, datë 26.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese). Nëse gjatë hetimit administrativ rezulton se ky problem ekziston në një masë të gjërë apo minimalisht mbi 136 raste, atëherë KAS-it nuk i mbetet tjetër, vecse shpallja e pavlefshmërisë dhe urdhërimi i përsëritjes së zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku i Tiranës.

B. Në lidhje me provat që kërkojmë të merren:

228. Pjesa X, nenet 124 – 144 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë procedurën që ndjek Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve për shqyrtimin e një ankimi administrativ. Neni 136, pika 1, gërma “c” parashikon se palët kanë të drejtë të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre. Ndërsa, pika 3 përcakton se kërkesa për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së dhe kur këto prova administrohen vetëm nga KQZ-ja, pranohet menjëherë pa iu nënshtuar debatit ose votimit në KQZ. KQZ-ja është e detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara. Neni 137 përcakton detyrimin që kanë organet e tjera të administratës publike për të vënë në dispozicion informacione, dokumente dhe cdo provë tjetër që kërkohet ose cmohet e nevojshme për hetimin administrativ. Ndërsa, neni 138 përcakton se KQZ-ja, kur pranon kërkesën e palëve sipas nenit 136, pika 3 të Kodit, këqyr materialet zgjedhore në kutitë e materialeve të votimit dhe kutitë e fletëve të votimit. Nëse kërkohet nga një anëtar i KQZ-së, kjo e fundit është e detyruar të kryejë rinumërimin dhe rivlerësimin e fletëve të votimit.

229. **Në rastin konkret, për të provuar pretendimet e parashtruara më lart lidhur me tërësinë e shkeljeve ligjore që cojnë në pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Tiranë, në vijim do të parashtrojmë kërkesat tona për marrjen e provave në përputhje me nenet 136, 137 dhe 138 të Kodit Zgjedhor, si më poshtë:**

- (i) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Prokuroria Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për numrin e procedimeve penale lidhur me krimet zgjedhore dhe fazën e tyre;
- (ii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Prokuroria e Përgjithshme për numrin e procedimeve penale lidhur me krimet zgjedhore në prokuroritë e rretheve dhe fazën e tyre;
- (iii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për numrin e shtetasve të ndaluar, të arrestuar dhe numrin e rasteve të referuara për krime zgjedhore;
- (iv) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit mbi gjendjen e rezervave të shtetit në depozitat qendrore dhe lokale për cdo muaj nga Dhjetor – Maj 2021;
- (v) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Inspektoriati Qëndror dhe të gjitha inspektoriatet që veprojnë në Shqipëri për numrin e inspektimeve të kryera në periudhën 24 Dhjetor 2020 – 1 Maj 2021; për numrin e gjobave dhe sanksioneve të vendosura; numrin e sanksioneve/gjobave të revokuara me vendim administrativ/vendim gjyqësor;
- (vi) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Agjencia e Prokurimeve Publike për numrin e tenderave, koncesioneve, PPP-ve të shpallur rishtazi apo për të cilat janë shpallur fituesit në periudhën 24 Dhjetor 2020 – 1 Maj 2021;
- (vii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Këshilli Kombëtar i Teritorit për numrin e lejeve të ndërtimit të dhëna në periudhën 24 Dhjetor 2020 – 1 Maj 2021;
- (viii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Agjencia Shtetëror e Kadastrës për numrin e lejeve të legalizimit të dhëna sipas qarqeve në periudhën 24 Dhjetor 2020 – 1 Maj 2021;
- (ix) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Ministri i Shtetit për Rindërtimin për numrin e banesave të ndërtuara/rindërtuara, për të cilat janë dhënë celësat e banesave në periudhën 24 Dhjetor 2020 – 1 Maj 2021;
- (x) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile mbi numrin e shtetasve shqiptarë që ndryshuan adresat e banimit në periudhën 1 Janar 2020 – 1 Maj 2021;

- (xi) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Departamenti i Administratës Publike për numrin e punonjësve të institucione publike, vendore apo qëndrore, dhe si ka ndryshuar, sipas qarqeve, për periudhën 1 Janar 2020 – 1 Maj 2021;
- (xii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga 61 bashkitë e vendit, agjencitë e varësisë dhe shoqëritë në pronësi të shtetit apo bashkive, për numrin e punonjësve të institucioneve publike, vendore apo qëndrore, dhe si ka ndryshuar, për periudhën 1 Janar 2020 – 1 Maj 2021;
- (xiii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe 61 bashkitë e vendit lidhur me numrin e familjeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike dhe ndryshimin e masës ekonomike, në periudhën 1 Janar 2020 – 1 Maj 2021;
- (xiv) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe bashkitë Durrës, Tiranë, Kavajë, Lezhë, Rrogozhinë, Vorë, Krujë, Lac dhe Mirditë për shpërblimet e dhëna familjeve të prekura nga tërmeti, në periudhën 1 Janar 2020 – 1 Maj 2021;
- (xv) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Prokuroria e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar lidhur me fazën e hetimeve lidhur me bërjen publike të të dhënave të 910 mijë qytetarëve të Tiranës;
- (xvi) Marrjen e një informacioni zyrtar nga INSTAT mbi numrin e shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë; numrin e shqiptarëve që jetojnë në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut; dhe numrin e këtyre shtetasve mbi moshën 18-vjeç;
- (xvii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Ministria e Shëndetësisë mbi numrin e personave të infektuar me COVID-19 në datën 25.04.2021 sipas qarqeve;
- (xviii) Marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit mbi numrin e shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në Shqipëri në periudhën 19.04.2021 – 25.04.2021 nga Republika e Greqisë dhe Maqedonia e Veriut; listën e plotë të këtyre personave;
- (xix) Marrjen e një informacioni zyrtar nga OSHEE mbi të gjitha shpërblimet që u janë punonjësve të kësaj kompanie shtetërore, sipas qarqeve, në periudhën 1 Janar 2020 – 1 Maj 2021;
- (xx) Marrjen e të dhënave të kryqëzuara ndërmjet pajisjeve të identifikimit elektronik PEI për zonën zgjedhore Qarku i Tiranës.

IV. KONKLUZIONI

230. Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, si dhe:

- (i) Neni 130 i Kodit Zgjedhor përcakton se KQZ merr vendim për pranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon: a) kompetencën e KQZ-së; b) legjitimitimin e ankuesit; dhe c) respektimin e afateve ligjore. Duke qenë se sic kemi shpjeguar më lart, ankimi i paraqitur nga PD-ja përmbush të tre kriteret procedurale (legjitimitimin, kompetencën dhe afatin ligjor), kërkojmë pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve;
- (ii) Ndërtimi i një skeme kriminale, e shtrirë në mënyrë kapilare në të gjithë Qarkun e Tiranës për blerjen e votës, nëpërmjet përfshirjes të personave me rekorde të tmerrshme kriminale, përbën shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor, duke cënuar rëndë procesin zgjedhor, e për rrjedhojë duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Nga ana tjetër, skema e shpërndarjes së parave mbi 2.500 familjeve të prekura nga tërmeti nga Bashkia Rrogozhinë përgjatë periudhës zgjedhore, e cila ka ndikuar minimalisht **mbi 10.000 qytetarë**, dhënia e një page shtesë për 13 mijë punonjës të OSHEE-së, dhënia e ndihmave ushqimore, grante e fonde të posacme, lejimi për të ndërtuar pa leje etj., të gjitha në shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të tij, kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor. Dhënia e përfitimeve në të holla apo të mira materiale nga buxheti i shtetit apo nëpërmjet burimeve të paligjshme ka synuar manipulimin e vullnetit të zgjedhësve në favor të PS-së. Megjithëse, përmasat reale të numrit të zgjedhësve që kanë përfituar nga skemat e paligjshme të ngritura nga institucionet publike, qendrore apo vendore, do të zbulohen gjatë hetimit administrativ, në cdo rast është e qartë se shkeljet flagrante të ligjit, dhe në vecanti të neneve 78 dhe 91 të Kodit Zgjedhor, të kryer nga zyrtarë të lartë drejtues të PS-së kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor, duke sjellë edhe ndryshimin e rezultateve zgjedhore dhe ndarjen e mandateve në Qarkun e Tiranës, cka në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, sjell detyrimisht pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore.
- (iii) Parimi i barazisë ndërmjet palëve garuese në zgjedhje u cënua rëndë pasi Shteti dhe Partia në pushtet (PS) u shkrinë në një. Zyrrat elektorale të Partisë Socialiste u kthyen

në “institucione shtetërore” ku qytetarët duhet të paraqiteshin për t’u punësuar, për të marrë leje legalizimi, për të marrë dëmshpërblimin nga tërmeti, celësat apo dokumentet e shtëpisë së ndërtuar, për të transferuar gjendjen civile etj. Shteti dhe Partia Socialiste, në koordinim dhe bashkëpunim me njëra-tjetrën i vendosën të gjithë mekanizmat shtetërorë në funksion të manipulimit të vullnetit të zgjedhësve. Projektet dhe investimet publike, shtëpitë e ndërtuara apo rindërtuara pas tërmetit, punonjësit e administratës, punësimet e reja në administratë, lejet e legalizimit, certifikatat e pronësisë, inspektoriatet, gjendja civile u vunë në dispozicion të plotë të Partisë, kryeministrit, ministrave dhe deputetëve, me qëllim për të fituar me çdo kusht zgjedhjet (shih fq. 2, 3 dhe 12 të Raportit Paraprak të OSBE/ODIHR; shih Deklaratën e Misionit të SHBA në OSBE). Ky përdorim masiv i burimeve shtetërore, përveçse një veprimtari e paligjshme, e cila duhet hetuar dhe dënuar nga organet e drejtësisë, është në shkelje flagrante të neneve 78, 91, 92 të Kodit Zgjedhor dhe neneve 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, cka ka cënuar rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në vullnetin e zgjedhësve, rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve dhe ndarjen e mandateve në Qarkun e Tiranës.

- (iv) Partia Socialiste, drejtuesit, përfaqësuesit, strukturat, shtabet qëndrore, zyrat elektorale morën nga serverat shtetërorë të dhënat personale të qytetarëve me qëllim përdorimin e tyre për t’i bërë qytetarët më vulnerabël dhe eventualisht për të kontrolluar vullnetin e tyre gjatë fushatës zgjedhore dhe në ditën e votimit. Ky krim i shumëfishtë, me përmasa ndërkombëtare, përbën një rast flagrant se si shteti i vë në dispozicion Partisë infrastrukturën e tij për të fituar zgjedhjet. Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i të dhënave të 910 mijë qytetarëve në Tiranë dhe 350 mijë qytetarëve në Durrës, për të cilat askush deri më sot nuk ka dalë të thotë që ka dhënë pëlqimin e tij për mbledhjen, përpunimin apo publikimin e tyre (shih *Radu v. Moldavia*, 2014), pra në mënyrë krejtësisht të kundërligjshme, cënoi rëndë procesin zgjedhor të 25 Prillit.
- (v) Duke qenë se Shteti dhe Partia ishin të pajisur me informacion për secilin zgjedhës, përfshirë edhe bindjet e tyre politike, kjo i bëri më vulnerabël përballë pushtetit dhe më lehtësisht viktimë e presioneve apo mjeteve të tjera të kundërligjshme për të ndaluar të shprehin vullnetin e tyre lirisht. Disa nga këto forma që përdori Partia-Shtet ishte blerja e votuesve që mbështesnin opozitën, marrja e kartave të identitetit për të mos votuar, kërcënimi për të mos dalë në fushatë, kërcënime për largime nga puna të

zgjedhësit apo të afërmit të tij, inspektime dhe paralajmërime për mbyllje biznesi apo dërgimi i mesazheve të personalizuar, sic kemi përshkruar në rastin e Spartak Brahos. Të gjitha këto shkelje të rënda të Kushtetutës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kodit Zgjedhor, ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, cënuan rëndë procesin zgjedhor të 25 prillit, duke ndikuar drejtpërdrejtë mbi rezultatin e zgjedhjeve dhe ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore, në shkelje flagrante të nenit 160 të Kodit Zgjedhor. Për këtë shkak, i vetmi mjet ligjor për të garantuar rikthyer besimin e qytetarve te sistemi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme është përsëritja e tyre në këtë zonë zgjedhore.

- (vi) Në zgjedhjet parlamentare të 25 Prill 2021, është e qartë se jo vetëm nuk lejohen shtetasit shqiptar me residencë jashtë Shqipërisë që të votojnë në vendbanimin e tyre (detyrim ky ligjor sic e kemi analizuar edhe më sipër), por efektivisht e drejta për të votuar të shtetasve shqiptar resident në Greqi dhe Maqedoni është mohuar në tërësinë e saj pasi këta të fundit për shkak të karantinimit të detyruar nuk u lejuan që të votonin as duke u kthyer përkohësisht në Shqipëri. Kështu, një masë e tillë është tërësisht jo proporcionale dhe në shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1. Këto shkelje të Kushtetutës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që sollën mohimin e të drejtës për të votuar të mbi 500 mijë qytetarëve me të drejtë vote. Diferenca në përqindje ndërmjet subjekteve zgjedhore është shumë herë më e ulët se përqindja e votuesve që jetojnë jashtë vendit apo vecanërisht në Greqi/Maqedoni të Veriut, të cilëve iu mohua e drejta për të votuar. Kjo çënoi rëndë procesin zgjedhor në tërësinë e tij, dhe sigurisht me një impakt të drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve, pasi mbi 500 mijë zgjedhës potencialë, mund të kishin përcaktuar jo vetëm rezultatin në zonën zgjedhore të Qarkut Tiranë, por në të gjithë Shqipërinë.
- (vii) Mohimi kategorikisht i të drejtës për të votuar i personave të infektuar me COVID-19 përbën efektivisht shkelje të së drejtës së tyre. Sic ka konkluduar Misioni i OSBE/ODIHR në raportin e tij paraprak kjo praktikë bie ndesh përkatësisht me dispozitat për drejtat e votimit dhe barazinë e votës të parashikuar në nenin 45 të Kushtetutës dhe me paragrafin 7.2 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 të OSBE-së (shih fq. 8 të Raportit paraprak të OSBE/ODIHR). Ashtu si edhe në rastin e emigrantëve është e qartë se këto cënime të rënda të procesit zgjedhor mund të ndreqen vetëm me një vendimarrje pavlefshmërie dhe përsëritjen e zgjedhjeve. Tej

atyre parashikimeve që përmban Kushtetuta dhe ligji, askujt tjetër nuk mund t'i mohohet e drejta thelbësore për çdo shoqëri demokratike, për të zgjedhur përfaqësuesit e tij/saj. Numri total i zgjedhësve në Qarkun e Tiranës, të infektuar me COVID-19, në ditën e zgjedhjeve, është më shumë se numri i votave të kërkuara për një mandate deputeti, për pasojë mohimi tërësisht i të drejtës së këtyre qytetarëve për të votuar përbën një shkelje të rëndë të ligjit, e cila në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, ka ndikim në rezultatin e zgjedhjeve dhe në ndarjen e mandateve. Për rrjedhojë, zgjedhjet në këtë zonë zgjedhore duhet të shpallën të pavlefshme dhe të përsëriten.

- (viii) Miratimi i një flete votimi në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga neni 98 i Kodit Zgjedhor dhe pika 27 e Kodit të Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore, solli një numër tejet të lart të fletëve të votimit, të cilat nëse do të ishin përkthyer në mandate mund të ndryshonin rezultatin nga 5 – 8 mandate në të gjithë Shqipërinë. Këto mandate mund të sillnin jo vetëm ndryshimin e rezultatit në qarqe të caktuara, ku diferenca ndërmjet palëve është e ngushtë, por edhe në rang kombëtar, kur dihet se partia e parë sipas rezultateve paraprake ka vetëm katër mandate më shumë se shumica e kërkuar për formimin e qeverisë. Nga ana tjetër, lejimi vetëm i kryetarëve të partive për kandiduar në katër zona zgjedhore, të cilat në lista janë të barabartë si të gjithë kandidatët e tjerë, përbën një diskriminim në të drejtën për t'u zgjedhur, në kuptim të neneve 18 dhe 45 të Kushtetutës.
- (ix) Në tërësinë e tyre këto shkelje të ligjit shqiptar dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Në këto kushte, është e qartë se vendimet e marra në kundërshtim me nenin 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore, cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke diktuar një rezultat në shpërputhje me vullnetin e zgjedhësve, e për rrjedhojë edhe ndarjen e mandateve, dhe për rrjedhojë në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, ky proces zgjedhor në Qarkun Tiranë duhet të shpallet i pavlefshëm dhe të urdhërohet përsëritja e zgjedhjeve në këtë qark.
- (x) **Në tërësinë e tyre këto shkelje flagrante të ligjit – shitblerja e votës, përdorimi i personave me precedentë kriminalë, përdorimi i paligjshëm i administratës, vjedhja dhe përdorimi kriminal i të dhënave personale të shtetasve nga PS,**

përdorimi i paligjshëm, masiv dhe sistematik i parave të buxhetit të shtetit për tjetërsimin e vullnetit të qytetarëve, përdorimi i lejeve të legalizimit për vota dhe transferimi i gjendjes civile – cënuan rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore Qarku Tiranë. Këto shkelje dhe pasojat e tyre përmbushin kriteret e kërkuara nga nenet 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Qarkun e Tiranës.

231. Bazuar në nenin 45 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenin 3, Protokollin 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Cështjet Zgjedhore dhe nenet 143, 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor, përfundimisht,

KËRKOJMË:

1. Pranimin e ankimit për kundërshtimin e Vendimit Nr. 343, datë 04.05.2021 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në zonën zgjedhore Qarku Tiranë.
3. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Tiranë, në periudhën më të afërt zgjedhore.

Me konsideratë,

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

Ivi KASO

(_____)

- **Bashkëlidhur gjeni provat:**

- (i) Prova Nr. 1 – Kallëzimi penal i Partisë Demokratike, datë 04.04.2021
- (ii) Prova Nr. 2 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 06.04.2021
- (iii) Prova Nr. 3 – Public designation of Albanian MP Doshi for significant corruption
- (iv) Prova Nr. 4 – Deklaratë e Amb.Amerikane për Tom Doshin
- (v) Prova Nr. 5 – RENEA arreston për të tretën herë Filip Gjelošajn, nën akuzë për kultivim droge
- (vi) Prova Nr. 6 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 07.04.2021
- (vii) Prova Nr. 7 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, në datën 07.04.2021
- (viii) Prova Nr. 8 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 12.04.2021
- (ix) Prova Nr. 9 – Foto nga grupi në whatsapp “Grupi i Matjeve Kombinuar” dhe materiale të tjera
- (x) Prova Nr. 10 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 15.04.2021
- (xi) Prova Nr. 11 – Skandali me fondet e tërmetit, paratë janë shpërndarë edhe tek personat jashtë vendit
- (xii) Prova Nr. 12 – “Miqësisht Erion Veliaj”/Kryetar i Bashkisë fut 50-shen në zarfin lejla, qytetari DENONCON: Iu është shpërndarë familjeve afër teleferikut
- (xiii) Prova Nr. 13 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 18.04.2021
- (xiv) Prova Nr. 14 – Ndërtimi pa leje i Ervin Duda
- (xv) Prova Nr. 15 – Ndërtimi pa leje Naim Isteri
- (xvi) Prova Nr. 16 – Deklaratë e SHBA në OSBE, datë 07.05.2021
- (xvii) Prova Nr. 17 – Dhënia e parave familjeve të prekura nga tërmeti
- (xviii) Prova Nr. 18 – Shpërndarja e ndihmave ushqimore nga eksponentët e PS
- (xix) Prova Nr. 20 – Shpërndarja e ushqimeve në Kombinuar, mesazhi whatsapp
- (xx) Prova Nr. 21 – Pagë shtesë për 13 mijë punonjës të OSHEE
- (xxi) Prova Nr. 22 – Numri i telefonit që janë kontaktuar emigrantët shqiptarë
- (xxii) Prova Nr. 23 – VKM Nr. 1044/2020
- (xxiii) Prova Nr. 24 – VKM 1076/2020
- (xxiv) Prova Nr. 25 – VKM 1102/2020
- (xxv) Prova Nr. 26 - Vendimi nr. 101, date 15.12.2020 “Autorizim për dhënie të ndihmës shtetërore
- (xxvi) Prova Nr. 27 – Kallëzimi penal i Partisë Demokratike, datë 16.04.2021

- (xxvii) Prova Nr. 28 – Foto nga magazinimi i ushqimeve në bibliotekën “Petro Zheji”
- (xxviii) Prova Nr. 29 – VKM Nr. 1185/2020
- (xxix) Prova Nr. 30 – Të dhënat nga APP/Thesari
- (xxx) Prova Nr. 31 – Të dhënat nga APP/Thesari
- (xxxi) Prova Nr. 32 – Shtëpitë e padëmtuara të Hamdi Pepa dhe Muharrem Troka
- (xxxii) Prova Nr. 33 – Foto të rrugëve Haxhi Alija; Hamide Dalipi; Hajredin Fratari, Haki Glina
- (xxxiii) Prova Nr. 34 – Foto të rrugëve Hajdar Hidi, Branko Kadia, Artitekt Sinani
- (xxxiv) Prova Nr. 35 – Denoncimi i Kreut të FRPD: Në Unazën e Re po hidhet asfalt elektoral, punimet bëhen natën. SPAK të hetojë
- (xxxv) Prova Nr. 36 – Foto të rrugës afër zonës së depos së ujit, Liqeni i Farkës
- (xxxvi) Prova Nr. 37 – Foto të shtrimit të rrugës “Danish Jukniu”
- (xxxvii) Prova Nr. 38 – Video e fillimit të punimeve në Bulqesh, Kamëz
- (xxxviii) Prova Nr. 39 – Kallëzimi penal i Partisë Demokratike, datë 15.04.2021
- (xxxix) Prova Nr. 40 – Foto nga investimi në rrugën “Ali Visha”
- (xl) Prova Nr. 41 – Kallëzimi penal i Partisë Demokratike, datë 18.04.2021
- (xli) Prova Nr. 42 – Foto si përfitues Muharrem Troka dhe shtëpia e padëmtuar
- (xlii) Prova Nr. 43 – Foto si përfitues Fatmir Haska dhe shtëpia e padëmtuar
- (xliii) Prova Nr. 44 – Foto si përfitues Shefit Thartori dhe shtëpia e padëmtuar
- (xliv) Prova Nr. 45 – Skandali: Asfalt pa prokurim në vigjilje të votës, dhe në shërbim të saj! SPAK ka një indicia të forte
- (xlv) Prova Nr. 46 – Drejtoresha e ISSH-së kërcënon punonjësit
- (xlvi) Prova Nr. 47 – KPK shkarkon nga detyra prokurorin Kol Hysenaj
- (xlvii) Prova Nr. 48 – Lista e zgjedhësve, Bledar Doracaj i bën thirrje kryedemokratit: Rinovo kartën e identitetit, ka dy vite që të ka skaduar
- (xlviii) Prova Nr. 49 – Dallëndyshe Bici mbledh drejtorët e shkollave në Paskuqan
- (xlix) Prova Nr. 50 – Denoncimi/Fatmir Cibaku, drejtori i Ndërmarrjes Shtetërore të Transportit “Misto Mame” shpërndan ndihma dhe mbledh karta identiteti për vota
- (l) Prova Nr. 51 – Foto Rozafat Sopaj në zyrën e tij, drejtor i banesave sociale Tiranë
- (li) Prova Nr. 52 – Ermal Kapllani, drejtor i akuzuar për korrupsion në listën e zezë të Ramës
- (lii) Prova Nr. 53 – Foto e publikuar nga “JOQ Albania”

- (liii) Prova Nr. 54 – Makinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave pranë zyrës elektorale të PS Tiranë
- (liv) Prova Nr. 55 – Policët bashkiakë shpërndajnë posterin e kandidatit të PS për deputet Xhemal Qefalia
- (lv) Prova 56 – Shefi i Emergjencave Rrogozhinë shpërndan ndihma ushqimore
- (lvi) Prova Nr. 57 – Raporti i INSTAT
- (lvii) Prova Nr. 59 – Rritja e numrit të punonjësve në Bashkinë Kamëz
- (lviii) Prova Nr. 60 – Foto nga email-i i Ogerta Manastirliu
- (lix) Prova Nr. 61 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 19.04.2021
- (lx) Prova Nr. 62 - Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 19.04.2021
- (lxi) Prova Nr. 63 – Fatmir Xhafaj shpërndan leje legalizimi
- (lxii) Prova Nr. 64 – Shoqëruesit e Etilda Gjonaj shpërndajnë leje legalizimi
- (lxiii) Prova Nr. 65 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 07.04.2021
- (lxiv) Prova Nr. 66 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 08.04.2021
- (lxv) Prova Nr. 67 – Audiopërgjimi i Drejtorit të përgjithshëm Artan Lame
- (lxvi) Prova Nr. 68 – Këllici hap “pakon e iftarit” që kapi në Vaqarr, gjen legalizimet e PS për vota
- (lxvii) Prova Nr. 69 – Kryetar i KZAZ-së Nr. 32, Tiranë
- (lxviii) Prova Nr. 70 – Dhunohet aktivisti i Unazës së Re, ishin njerëzit e Arben Ahmetaj, ja emrat
- (lxix) Prova Nr. 71 – Dhunohet zyra elektorale e PD-së në njësinë Nr. 7, Tiranë
- (lxx) Prova Nr. 72 – Kallëzimi penal i Partisë Demokratike, datë 07.04.2021
- (lxxi) Prova Nr. 73 – Foto e Redian Krali me Ndricim Jonuzi
- (lxxii) Prova Nr. 74 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, 23.03.2021
- (lxxiii) Prova Nr. 75 – Skandali/Zyrat elektorale të PS-së transferojnë votuesit në Tiranë me 1 telefonatë, dalin “jashtë loje” njësitë bashkiake
- (lxxiv) Prova Nr. 76 – Eskluzive/Si na monitoron Rilindja nr. e telefonit, nr. ID, vendet e punës, të dhënat konfidenciale për 910 mijë votues
- (lxxv) Prova Nr. 77 – Zbërthehet burimi i Lapsi.al/Si e përdorin Drejtuesit Politikë të PS programin me të dhënat për 3.5 milion shqiptarë
- (lxxvi) Prova Nr. 78 – Mesazhet e Spartak Brahos
- (lxxvii) Prova Nr. 79 – Kallëzim penal i Partisë Demokratike, datë 14.04.2021

- (lxxviii) Prova Nr. 80 – Vendimi i Komitetit Teknik të Ekspertëve për karantinën e emigrantëve
- (lxxix) Prova Nr. 81 – Shfuqizohet vendimi i Komitetit Teknik të Ekspertëve
- (lxxx) Prova Nr. 82 – Vendimi i Komisionerit për fletët e votimit, datë 31.03.2021
- (lxxxi) Prova Nr. 83 – Vendimi i KAS, 03.04.2021
- (lxxxii) Prova Nr. 84 – Vendimi i Kolegjit Zgjedhor, datë 04.04.2021
- (lxxxiii) Prova Nr. 85 – Letra e kompanisë Celtics
- (lxxxiv) Prova Nr. 86 – Faqja zyrtare e KQZ-së
- (lxxxv) Prova Nr. 87 – Ana Kekezi bën të pavlefshme fletët e votimit
- (lxxxvi) Prova Nr. 88 – Deklarata e Komisionerit Shtetëror Celibashi, dt. 28.04.2021.